
بسم الله الرحمن الرحيم

Imam Sejid Ali Khamenei *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*

KUR'ANI - LIBRI I JETËS

Tiranë, 2026

Titulli: Kur'ani - Libri i jetës

Autori: Imam Sejid Ali Khamenei *(Allahu e mëshiroftë!)*

Përgatitur nga: Qendra Botërore e Informacionit e Ehli Bejtit / Kumi i shenjtë

E përktheu nga arabishtja: Ma. Isra MERJA

E redaktoi: Liseda RAMAJ

E korrektoi: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie FEZA

Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata "Flladi" - Tiranë, 2026

Me emrin e Allahut, Gjithësisht-Mëshiruesit, Veçanërisht-Mëshirëplotit!

Kryerja e detyrave të mëdha kërkon gjithmonë mbështetje tek Allahu i Madhëruar dhe një besim të përgjithshëm nga ana e popullit. Pasuria, armët e përparuara dhe metodat politike mbeten vetëm një mbështetje e dobët për përmbushjen e këtyre detyrave. Allahu i Madhëruar, pasi ia ngarkoi të Dërguarit të Tij fisnik (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) përgjegjësinë më të madhe në historinë e gjatë të njerëzimit, i tha:

﴿هُوَ الَّذِيَ أَيَّدَكَ بِنَصْرِهِ وَبِالْمُؤْمِنِينَ﴾.

"Është Ai që të përkrahu me ndihmën e Tij dhe me besimtarët."[1]

Imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *"Meqenëse njeriu është boshti i gjithçkaje në këtë botë dhe ai zotëron, nga njëra anë, dimensionin shpirtëror e moral, ndërsa nga ana tjetër dimensionin material e trupor; ai ka një anë të jashtme dhe një anë të brendshme. Kur'ani i Shenjtë ka ardhur pikërisht për ta marrë përsipër edukimin e këtij njeriu. Ai edukon të gjitha dimensionet e tij, pra kujdeset për të gjitha nevojat e njeriut, nevojat personale dhe të brendshme, marrëdhënien e tij me Krijuesin e tij, të Lartësuar dhe të Madhëruar, si dhe temat që lidhen me teuhidin (Njëshmërinë e Allahut). Gjithashtu, ai trajton çështjet*

[1] Sure "El-Enfal", ajeti 62.

politike e shoqërore, si edhe çështjen e luftës kundër mohuesve dhe disa grupeve të tjera të njerëzve."

Kur'ani i Shenjtë është pesha më e madhe (الثقل الأكبر), është Libri i jetës dhe kushtetuta e zbritur nga ana e të Madhërishmit dhe të Lartësuarit Allah, që të zbatohet në fushën e edukimit të njeriut dhe në mënyrën e rregullimit dhe organizimit të çështjeve të tij në jetën materiale dhe drejtimin e tyre kah e ardhmja. Më pas, ai tregon mënyrën se si këtyre çështjeve materiale në jetën e tij t'u jepet ngjyra hyjnore dhe shpirtërore, në mënyrë që jeta e tij materiale në këtë botë të bazohet në natyrshmërinë e tij (fitrah) dhe në vullnetin e Allahut të Madhëruar nga njëra anë, ndërsa jeta e tij e përtejme të lidhet nga ana tjetër me kënaqësinë e të Lartësuarit.

Kur'ani është Libër udhëzimi dhe drejtimi për atë që dëshiron të udhëzohet dhe që synon udhëzimin. Ata që kanë zemra të sëmura dhe ata që kanë humbur shpresën nga mëshira e Allahut janë të privuar nga ky udhëzim kur'anor. Kur'ani i udhëzon besimtarët e tij drejt qëllimit të synuar dhe objektivit më të lartë në të gjitha fushat e ndryshme të jetës. Ai nuk pranon që mohuesit, idhujtarët dhe hipokritët të sundojnë mbi besimtarët dhe nuk lejon depërtimin e tyre mes myslimanëve. Ai i mbron besimtarët përballë sulmeve dhe fushatave shejtanore dhe i ruan ata. Vetë fakti që armiqtë e Allahut, gjatë gjithë historisë së Islamit dhe jetës së myslimanëve, kanë sulmuar Kur'anin nga shumë anë të ndryshme, tregon ndikimin e jashtëzakonshëm dhe të mrekullueshëm të Kur'anit në zemrat dhe jetën e myslimanëve.

Ndonjëherë Kur'ani i Shenjtë interpretohet si një libër që sjell dorëzim, plogështi dhe mosangazhim te myslimanët, dhe ky është

një lexim i gabuar. Herë të tjera, disa përpiqen t'i japin ajeteve hyjnore një interpretim materialist, me qëllim që të zhdukin moralin, shpirtëroren dhe prirjen për Botën Tjetër nga jeta e besimtarëve. Të tjerë përpiqen të përhapin idenë se Kur'ani është i errët dhe i pakuptueshëm, se është një libër që nuk i shërben të gjallëve, por vetëm të vdekurve, dhe se vendi i tij është në rafte, duke u mjaftuar vetëm me puthjen dhe shenjtërimin e tij formal. Ndonjëherë gjithashtu i drejtohen atij vetëm në aspektin e jashtëm, si: zëri, melodia dhe recitimi, pa hyrë në meditim, reflektim dhe thellim në kuptimin e tij. Nganjëherë ata pengojnë rrugën e zbatimit të Kur'anit dhe e sulmojnë shenjtërinë e tij, duke krijuar atmosfera armiqësore të lindura nga kokëfortësia, inati dhe armiqësia e fortë ndaj Islamit të pastër në shoqëri.

Zgjimi islam që ka lindur nga Revolucioni Islamik i lavdishëm në Iran, sot e ka bërë Kur'anin bazë të ndikimit, të begatisë së gjerë në jetën individuale, shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore të myslimanëve.

Prandaj, kapja pas Kur'anit, përqafimi i tij dhe shfrytëzimi i tij në të gjitha dimensionet e jetës duhet të jetë në përputhje të plotë, të saktë dhe gjithëpërfshirëse me metodën, jetën dhe interpretimin e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), të cilët janë "pesha tjetër" krahas Kur'anit. Nga kjo pikëpamje, shoqëria islame ecën me hapa të sigurt, të butë dhe të qëndrueshëm, duke kaluar rrugët e vështira dhe të ndërlikuara drejt përsosurisë, mirëqenies dhe lumturisë.

Njohja e njerëzve, veçanërisht e të rinjve dhe e brezave të rinj, me dimensionet e ndryshme të Kur'anit dhe me ndikimet e tij të përjetshme e të bekuara, është një domosdoshmëri. Mbështetja më e mirë ndaj Kur'anit të Shenjtë përballë hedhjes së dyshimeve

dhe sulmeve të brendshme e të jashtme të armiqve është zbatimi i ajeteve dhe i ligjeve të tij hyjnore. Shoqërimi me Kur'anin, meditimi mbi të dhe zbatimi i tij në fushat individuale, shoqërore dhe politike është rruga më e mirë dhe zgjidhja më e përshtatshme për problemet e shoqërisë.

Për këtë arsye, me të drejtë, udhëheqësi i Revolucionit Islamik, imam Khomeini ka thënë: "*Shumë nga nyjet e verbëra dhe problemet e pazgjidhura që po përjetojmë nuk kanë ndodhur veçse për shkak se jemi larguar nga Islami dhe nga dispozitat e tij të shenjta. Sa herë që nyjet janë zgjidhur dhe problemet e vështira janë tejkaluar dhe ymeti ka arritur sukses, kjo nuk ka ndodhur veçse nëpërmjet Islamit të pastër, ndërsa Kur'ani është prezantuesi, thirrësi, simboli dhe burimi themelor i Islamit.*"

Shpresojmë që kjo përmbledhje dhe ky libër të jetë një shtysë për njohjen dhe afrimin me Kur'anin, si dhe për veprimin sipas tij, duke zgjuar një dëshirë dhe vetëdije më të madhe tek të gjithë njerëzit, veçanërisht tek të rinjtë. Kjo përmbledhje është një lexim i thellë i Kur'anit të Shenjtë dhe rezultat i meditimit të thellë dhe zbatimit të saktë të tij nga një person që është çliruar nga çdo lidhje tjetër përveç Allahut të Madhëruar dhe është stolisur me bindje dhe adhurim ndaj Tij. Një fjalë e tillë mund të zërë vend në zemrat e njerëzve, prandaj shpresojmë që të përfshihemi në lutjet e vëllezërve, miqve besnikë dhe dashamirëve të mirë kudo që ndodhen.

Institucioni Kulturor "Kadrul-Uilajeh"

Teheran – 1425 hixhri, 1383 sipas kalendarit iranian, 2004.

Pakujdesia e myslimanëve për shumë vite dhe braktisja e Kur'anit, ka çuar në atë që gishtat e shtrembërimit dhe të margjinalizimit të kenë mundësi të forcojnë fjalë të kota e të pavlera në mendje, të punojnë për mohimin dhe refuzimin e një prej bazave më të forta të fesë, të veshin shirkun me petkun e teuhidit (njëshmërisë) dhe të përpiqen të injorojnë përmbajtjet dhe kuptimet e ajeteve kur'anore pa asnjë frikë apo ngurrim.

Kur'ani e konsideron vendosjen e drejtësisë dhe të barazisë si qëllimin kryesor të dërgimit të të dërguarve:

﴿لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ﴾

"Ne i dërguam të dërguarit Tanë me argumente të qarta dhe zbritëm me ta Librin dhe peshoren, që njerëzit të qëndrojnë në drejtësi"[1]

Po ashtu, Kur'ani i drejtohet të gjithë besimtarëve dhe thotë:

﴿كونوا قوّامين بالقسط، شهداء لله﴾

"Bëhuni të qëndrueshëm në drejtësi dhe dëshmitarë për Allahun ."[2]

Më pas shohim se si ajetet kur'anore i ngarkojnë besimtarët me përgjegjësi të plotë për të luftuar për vendosjen e drejtësisë, ndërsa Libri i Allahut ndalon mbështetjen tek të padrejtët, dhe i drejtohet pasuesve të tij duke thënë:

[1] Sure "El-Hadid", ajeti 25.

[2] Sure "En-Nisa", ajeti 135.

﴿وَلاَ تَرْكَنُواْ إِلَى الَّذِينَ ظَلَمُواْ فَتَمَسَّكُمُ النَّارُ﴾

"Dhe mos u anoni kah ata që kanë bërë padrejtësi, përndryshe ju kap zjarri!"[1]

Ai e konsideron nënshtrimin ndaj tiranisë së tagut-it (tiranit, shtypwsit) si kundërbesim:

﴿أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يَزْعُمُونَ أَنَّهُمْ آمَنُواْ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْكَ وَمَا أُنزِلَ مِن قَبْلِكَ يُرِيدُونَ أَن يَتَحَاكَمُواْ إِلَى الطَّاغُوتِ وَقَدْ أُمِرُواْ أَن يَكْفُرُواْ بِهِ﴾

"A nuk i ke parë ata që pretendojnë se besojnë në atë që të është shpallur ty dhe në atë që është shpallur para teje, e megjithatë duan të gjykohen te taguti, edhe pse janë urdhëruar ta mohojnë atë."[2]

Pastaj e vendos mosbesimin ndaj tagutit përkrah besimit në Allahun:

﴿فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِن بِاللهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىَ لاَ انفِصَامَ لَهَا﴾

"Kush mohon tagutin dhe beson Allahun, ka kapur lidhjen më të fortë që nuk këputet kurrë."[3]

[1] Sure "Hud", ajeti 113.

[2] Sure "En-Nisa", ajeti 60.

[3] Sure "El-Bekare", ajeti 256.

Slogani i parë në Islam është slogani i teuhidit, pra mohimi i të gjitha fuqive materiale e politike dhe i të gjithë idhujve, qofshin gurorë të pajetë apo njerëz të gjallë.

Veprimi i parë që bëri i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) pas hixhretit në Medinë, ishte themelimi i shtetit dhe organizimi politik i shoqërisë. Përveç kësaj, ekzistojnë shumë argumente të qarta që tregojnë lidhjen e fortë mes fesë dhe politikës.

Megjithatë, disa njerëz vazhdojnë të pretendojnë se nuk ka asnjë lidhje mes fesë dhe politikës, dhe më pas u shfaq një grup që e përkrahu këtë mendim në kundërshtim me Islamin.

Politikanët që pretendojnë ndarjen e fesë nga politika dhe që mbështesin këto ide, a kanë menduar ndonjëherë me kujdes mbi ajetet kur'anore, historinë e Islamit dhe ligjet e sheriatit islam? Nëse feja do të ishte vërtet e ndarë nga politika, atëherë pse Kur'ani i lidh të gjitha çështjet politike, si qeverisja, ligji, strukturat shoqërore, lufta dhe paqja, përcaktimi i mikut dhe i armikut dhe format e tjera të politikës, me Allahun, fenë e Tij dhe të dashurit e Tij?

A do të ishin veprat dhe sjelljet politike e shoqërore, që përbëjnë pjesën më të madhe të jetës së njerëzve, pa shpërblim dhe pa ndëshkim? Nëse po, atëherë çfarë kuptimi kanë këto ajete:

﴿وَوَجَدُوا مَا عَمِلُوا حَاضِرًا﴾

"Dhe ata gjetën atë që kishin vepruar të pranishme."[1]

[1] Sure "El-Kehf", ajeti 49.

Dhe:

﴿وُفِّيَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ﴾

"Çdo njeri do të marrë plotësisht atë që ka vepruar."[1]

Si mund të vlerësohen atëherë këto ajete? A mund të thuhet se Islami nuk interesohet për veprat e mira dhe të këqija në jetën e kësaj bote dhe nuk ka vendosur asnjë përgjegjësi për njerëzit, por megjithatë i llogarit të gjithë për veprat dhe fjalët e tyre?

Ju duhet të njiheni me Kur'anin dhe është e domosdoshme që të kuptoni frymëzimet dhe shenjat kur'anore. Duhet të mësoni njohuritë dhe shkencat e thella islame, jo në nivelin e një filozofi apo të një studiuesi të specializuar, por në nivelin e një njeriu të vetëDitur, të zgjuar dhe të ndërgjegjshëm për këto çështje, sepse këto janë pjesë e njohurive. Natyrisht, besimi dhe sinqeriteti nuk janë rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre informacioneve dhe i njohurive; përkundrazi, ato burojnë nga një burim tjetër.

Mos e harroni dhikrin (përmendjen e Allahut) dhe lutjen. Duhet t'i ruani namazet e natës, ashtu siç i kryenit në frontet e luftës gjatë kohës së luftës së imponuar. Duhet të ktheheni dhe t'i kushtoni vëmendje namazeve vullnetare (nafileve). Ruajini ato namaze që i falnit në netët kur fillonin betejat dhe operacionet luftarake, kur mendonit se ajo mund të ishte nata e fundit e jetës suaj. Duhet t'i forconi këto gjendje shpirtërore.

[1] Sure "Ez-Zumer", ajeti 70.

Mos i thoni vetes: 'Njerëzit presin nga ne këtë e atë, prandaj duhet të jemi kështu.' Jo, kjo është një ndjenjë shumë e dobët. Përkundrazi, thuajini vetes kështu: 'Për shkak se përgjegjësia që kemi mbi supe është e rëndë dhe kërkon qëndrueshmëri dhe rezistencë të fortë, prandaj ne i kryejmë këto adhurime.'[1]

Kanë kaluar shekuj dhe shumë myslimanë e kanë harruar Kur'anin e Shenjtë. Gjurmët e tij të qarta dhe ndriçuese në rrjedhën e jetës së njerëzve janë zbehur. Devijimi dhe shtrembërimi kanë ndodhur në forma të ndryshme: ose njerëzit nuk e kanë kuptuar drejt mesazhin, ose edhe kur e kanë kuptuar, nuk kanë pasur guximin e nevojshëm për të zbatuar dispozitat dhe ligjet islame, ose kanë ndërmarrë hapa të mirë dhe kanë arritur rezultate e suksese të vlefshme, por nuk kanë treguar sakrificën dhe qëndresën e nevojshme për t'i ruajtur ato, prandaj ato janë humbur.

Në fillimet e Islamit kishte njerëz që nuk e kuptonin fjalën e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), por nuk guxonin ta kundërshtonin haptazi, sepse frika i kishte pushtuar. Kur'ani i Shenjtë i përmend disa prej tyre:

﴿يَقُولُونَ إِنَّ بُيُوتَنَا عَوْرَةٌ وَمَا هِيَ بِعَوْرَةٍ إِن يُرِيدُونَ إِلَّا فِرَارًا﴾

"Ata thonë: 'Shtëpitë tona janë të pambrojtura, ndërkohë që ato nuk janë aspak të pambrojtura. Ata nuk duan gjë tjetër veçse të ikin.'"[2]

[1] Cituar nga libri "Hadith el-Vilaje", Fjalimet dhe ligjëratat e Udhëheqësit të Madh të Revolucionit Islamik, Imam Khamenei, vëllimet 1, 5 dhe 8.

[2] Sure "El-Ahzab", ajeti 13.

Po ashtu, ata nuk i ruajtën të arriturat që kishin fituar dhe, për këtë arsye, ato shkuan dëm.

Armiqtë, për vite e dekada me radhë, bënë përpjekje të pandërprera për ta shkëputur popullin nga Kur'ani dhe për të krijuar një hendek mes njerëzve dhe Librit të Allahut. Ata u përpoqën me të gjitha mënyrat që ta largonin Kur'anin e Shenjtë nga jeta jonë.

Çfarë do të thotë ta largosh Kur'anin nga jeta? Do të thotë të ndërpresësh lidhjen ndërmjet myslimanëve dhe Islamit. Kur'ani është pishtari i Islamit dhe drita e udhëzimit. Ai që beson në Kur'an dhe jeton në shoqërinë e tij, ndryshon në zemër dhe në vepra nga ai që nuk ka asnjë lidhje e miqësi me të. Po kështu, një popull, zemra e të cilit është e lidhur me Kur'anin, ndryshon rrënjësisht nga një popull që nuk është lidhur me litarin e Kur'anit.

Sot, armiqtë e Islamit shkelin haptazi dispozitat e qarta të Kur'anit, sepse popujt tanë nuk janë lidhur dhe nuk janë mbështetur te Kur'ani i Shenjtë.

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), ka thënë: *"Askush nuk ulet në shoqërinë e këtij Kur'ani, veçse ngrihet prej tij ose me një shtim, ose me një pakësim: me një shtim në udhëzim ose me një pakësim të verbërisë."*[1]

Ata donin të na e rrëmbenin këtë udhëzim. Kështu ndodhi që, në dy dekadat e fundit para fitores së Revolucionit të Lavdishëm Islamik, brezi që u rrit nën regjimin e kalbur dhe të korruptuar monarkik nuk njihej me Kur'anin në shkollat shtetërore.

[1] "Nehxhul-Belaga", hytbja nr. 176.

Një i ri konsiderohej me fat nëse gjente një kurs për leximin e Kur'anit, një mësues që t'ia mësonte atë, një baba të dashur ose një nënë të ditur që e lexonte Kur'anin dhe prej të cilëve të përfitonte diçka. Kjo ishte një mirësi e madhe për të. Përndryshe, nuk ekzistonte pothuajse asgjë me emrin "mësim i Kur'anit" apo "arsim kur'anor".

Pastaj erdhi Revolucioni Islamik dhe e bashkoi sërish Kur'anin me zemrat e njerëzve.

Falënderojmë Allahun e Madhëruar që sot myslimanët dhe popujt islamë e njohin dhe janë të lidhur me Kur'anin e Shenjtë. Prandaj, është detyrë e popujve dhe qeverive islame, e intelektualëve myslimanë, e politikanëve myslimanë dhe e rinisë së vendeve islame që, sipas mundësive dhe kapaciteteve të tyre, të krijojnë kushtet e përshtatshme për popujt e tyre dhe të përgatisin rrugën praktike në jetën e tyre, në mënyrë që shoqëritë myslimane t'i rikthehen jetës kur'anore dhe të ecin në rrugën e dinjitetit, të krenarisë dhe të lavdisë.

Ky është ilaçi më i mirë për popujt myslimanë. Pikërisht këtë e kundërshtojnë teoricienët armiqësorë ndaj Islamit, të cilët i frikësohen ndikimit të tij. Edhe sot nuk kalon asnjë ditë pa u përpjekur që ta pengojnë dhe ta largojnë Kur'anin nga shoqëritë islame. Nëse shikoni historinë e kolonializmit, do të vini re se që nga hyrja e kolonialistëve në vendet islame, ata kanë përsëritur vazhdimisht të njëjtën parrullë: "Ndarja e fesë nga politika." Qëllimi i tyre ishte që feja dhe Islami të mbeteshin të izoluar nga jeta e njerëzve dhe të mos kishin rol në drejtimin e shoqërisë.

Kur'ani i Shenjtë e prezanton vetveten me shprehje të ndryshme. Për shembull, Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِنَّ هَذَا الْقُرْآنَ يَهْدِي لِلَّتِي هِيَ أَقْوَمُ﴾

"Me të vërtetë, ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e drejta dhe më e përkryera."[1]

Kjo do të thotë se Kur'ani e udhëzon njeriun drejt rrugës më të mirë, veprave më të mira, sistemit më të drejtë, metodës më të përsosur, moralit më të lartë dhe mënyrës më të denjë për organizimin e jetës së individit dhe të shoqërisë.[2]

Sot, shoqëritë njerëzore, edhe në skajet më të largëta të botës, nuk ndiejnë lumturi dhe qetësi, megjithëse kanë arritur përparim të madh material, shkencor dhe teknologjik. Pse? Sepse janë larguar nga vlerat shpirtërore, nga e vërteta njerëzore, nga morali fisnik dhe, mbi të gjitha, janë larguar nga Allahu i Madhëruar.

A nuk është njeriu i sotëm më i pasur dhe më i ditur se në të kaluarën? A nuk zotëron ai mjete dhe teknologji që ia lehtësojnë jetën? Atëherë, përse jeta është bërë kaq e hidhur? Përse ekziston gjithë ky konflikt dhe përplasje në botë? Përse vazhdojnë luftërat? Përse ka kaq shumë armiqësi ndaj popujve? Përse të rinjtë, edhe në vendet më të pasura të botës, nuk ndihen të lumtur? Çfarë i

[1] Sure "El-Isra", ajeti 9.

[2] Nga takimi i Udhëheqësit të Madh të Revolucionit Islamik me përgjegjësit e qeverisë dhe të forcave të armatosura, me rastin e Festës së Fiter Bajramit, më 9/11/1376 sipas kalendarit Iranian, 7 shkurt 1997.

mungon njeriut të sotëm që, megjithëse ka kaq shumë mirësi materiale, nuk arrin ta gjejë lumturinë?

Të dashur, sot fjala që mbizotëron në çështjet më të rëndësishme botërore është fjala e tiranëve amerikanë dhe e atyre që ndjekin të njëjtën rrugë. Shikoni me kujdes se si ata vendosin për çështjet e Lindjes së Mesme, të Afganistanit, të Evropës, të Amerikës Latine, të Afrikës, si edhe për ekonominë dhe naftën. Shumë shtete dhe popuj, pa dëshirën e tyre, detyrohen t'u binden këtyre urdhrave imponues dhe këtij kontrolli diktatorial.

Populli iranian ua ka thënë qartë arrogantëve botërorë: "Jo." Në të gjitha çështjet që lidhen me vendin tonë, në politikën e brendshme, në ekonomi, në politikën e jashtme, në çështjet e Lindjes së Mesme, si edhe në zgjedhjen e miqve dhe armiqve, ne kemi thënë "Jo". Ne e kemi kuptuar mirë se çfarë synojnë arrogantët, ata ndërhyrës që kërkojnë të fusin hundët në punët e brendshme të vendeve të tjera.

Hapi i parë për ta zbatuar plotësisht Kur'anin e Shenjtë është njohja e vetë tekstit të tij. Populli ynë, gjatë sundimit të tagutit (regjimit monarkik pahlevist të rrëzuar), nuk e njihte Kur'anin. Madje edhe ata që e lexonin Kur'anin, shpeshherë me gabime, ishin shumë të paktë. Të rinjtë që ishin rritur në shkollat e regjimit të mëparshëm pahlevist nuk kishin pothuajse asnjë njohje me Kur'anin. Vetëm nëse kishin prindër besimtarë, ata i dërgonin fëmijët në ndonjë vend për të mësuar leximin e Kur'anit dhe, në

këtë mënyrë, ata fitonin njëfarë njohjeje me të; përndryshe, nuk kishin asnjë mundësi.[1]

Falënderojmë dhe lavdërojmë Allahun e Madhëruar, i Cili na ka dhënë suksesin që të shoqërohemi me Kur'anin e Shenjtë. Nëse një popull arrin të lidhet me Kur'anin, ta bëjë atë shok të jetës së tij dhe ta vendosë veten nën ndikimin e atmosferës kur'anore, ai do të jetë në gjendje t'i kapërcejë krizat dhe problemet e tij. Kriza më e madhe e myslimanëve në botën e sotme është largimi dhe shkëputja nga Kur'ani, ndërsa zgjidhja e vetme është rikthimi tek ai.

Kur'ani nuk është shpallur vetëm që të lexohet në qoshe e vende të izoluara. Ai është shpallur që të zbatohet dhe të njihet nga myslimanët. Qëllimi i Kur'anit është që shoqëria islame të njohë detyrat dhe përgjegjësitë e saj, të kuptojë detyrimet e veta dhe të shpëtojë nga hutimi, devijimi dhe errësira. Prandaj, tubimet e Kur'anit, leximi i tij, kujdesi për zërin dhe rregullat e recitimit janë vetëm hyrje dhe përgatitje për njohjen e koncepteve dhe të përmbajtjes së tij.

Mangësia më e madhe e jona si myslimanë, është se flasim shumë për Kur'anin, por nuk veprojmë sipas tij. Ne shprehim me fjalë besnikërinë tonë ndaj Allahut të Madhëruar, por nuk e zbatojmë dhe nuk e ndjekim Sheriatin Islam. Allahu i Madhëruar thotë:

[1] Fjalim i Udhëheqësit të Madh të Revolucionit Islamik në ceremoninë përmbyllëse të Edicionit të 15-të të Garave kur'anore, më 1/9/1377 sipas kalendarit Iranian, 29 nëntor 1998.

﴿قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ﴾

"Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë ju."[1]

Nëse dikush pretendon se e do Allahun e Madhëruar, dëshmia e sinqeritetit të këtij pretendimi është ndjekja e rrugës së të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe zbatimi i Kur'anit të Shenjtë.

Të dashur dhe të dashur të zemrës! Populli iranian është afruar drejt kulmit të krenarisë, dinjitetit, shpëtimit, suksesit dhe fitores, në të njëjtën masë që është afruar me Kur'anin e Shenjtë. Rruga e shpëtimit për të gjithë popujt e botës është afrimi me Kur'anin. Edhe çlirimi i Palestinës nga duart e sionistëve kalon pikërisht nëpër këtë rrugë.

Shikoni se si regjimi pushtues dhe uzurpues izraelit është vendosur në tokën palestineze prej më shumë se pesëdhjetë vjetësh. Gjatë gjithë kësaj periudhe pati një luftë dhe qëndresë të gjatë e të ashpër, por luftëtarët palestinezë nuk arritën rezultatet e dëshiruara. Pse? Sepse feja e Allahut, besimi islam dhe dispozitat kur'anore nuk ishin boshti mbi të cilin ndërtohej ajo përpjekje. Sot, populli palestinez lufton dhe qëndron në emër të Islamit, dhe pikërisht për këtë arsye një rezistencë e tillë trondit themelet e entitetit armik.

Nëse myslimanët u japin mbështetje dhe ua zgjasin dorën e ndihmës palestinezëve dhe kjo është një detyrë kur'anore për të

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 31.

gjithë, atëherë agimi i fitores do të jetë i afërt dhe rruga drejt saj do të jetë më e shkurtër. Nëse myslimanët nuk u ofrojnë ndihmë, atëherë populli palestinez do të duhet ta vazhdojë vetë kryengritjen (*Intifadën*) e tij të qëndresës dhe rezistencës, dhe, me dëshirën e Allahut, fitorja do të jetë aleate e tij. Mirëpo, fitorja në vetmi dhe në mungesë të mbështetjes është më e vështirë dhe arrihet me më shumë sakrifica.

Kështu ndodhi edhe me popullin tonë. Ai vazhdoi rezistencën i vetëm dhe u përball me sfidat që vinin si nga kampi lindor, ashtu edhe nga ai perëndimor. Gjatë luftës së imponuar kundër nesh, të gjitha qendrat e mëdha të fuqisë botërore u rreshtuan përballë nesh. Megjithatë, ne i rezistuam armiqve edhe në vetmi, e përballuam barrën e kësaj vetmie, por nuk hoqëm dorë nga qëndresa. Allahu i Madhëruar na dha fitoren.

Edhe populli palestinez po kalon sot të njëjtën përvojë të vështirë. Nëse njerëzimi dëshiron të krijojë një jetë më të mirë dhe një mjedis më të drejtë, atëherë duhet të luftojë dhe duhet t'u japë ndihmë atyre që jetojnë në tokat e pushtuara nga armiku, derisa të krijohen kushtet e përshtatshme për rikthimin e këtyre trojeve të rrëmbyera nga trupi i atdheut dhe i ymetit islam. Një nga shembujt më të qartë të kësaj është të vepruarit sipas Kur'anit të Shenjtë. Nëse myslimanët e ndjekin këtë ligj hyjnor dhe i zbatojnë me përpikëri këto udhëzime, atëherë shumica e çështjeve do të përmirësohen dhe do të vendoset reforma në shoqëri.

Shkollat filozofike dhe teoritë bashkëkohore të dijes sot kanë dështuar në trajtimin e problemeve themelore të njeriut. Jini të bindur se edhe teoritë dhe shkollat shoqërore moderne kanë përjetuar një zhgënjim të madh në kuptimin dhe zgjidhjen e

çështjes së njeriut. Ne pamë se marksizmi dështoi dhe u shemb, ndërsa teoritë perëndimore po ecin në të njëjtën rrugë të devijimit.

Shkaku i këtij devijimi dhe dështimi është se Perëndimi zotëron shkencë të përparuar, pasuri të mëdha dhe kontroll mbi fuqitë më të mëdha ushtarake, por, megjithatë, nuk gjen qetësi, lumturi dhe siguri të brendshme. Atij i mungon paqja shpirtërore dhe qetësia e zemrës. Prandaj, mund të thuhet se kjo recetë është një recetë e pafrytshme dhe e dështuar, një recetë që ka përfunduar në falimentim dhe zhgënjim.

Kur'ani dhe teoria islame i japin njeriut njëkohësisht dijen, mirëqenien, dinjitetin dhe qetësinë shpirtërore. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿هُوَ الَّذِي أَنْزَلَ السَّكِينَةَ فِي قُلُوبِ الْمُؤْمِنِينَ﴾

"Ai është që zbriti qetësinë në zemrat e besimtarëve..."[1]

Islami dhe Kur'ani, krahas begative të kësaj bote, mirëqenies materiale dhe zhvillimit shkencor, i dhurojnë njeriut edhe qetësinë, prehjen dhe sigurinë e zemrës. Kjo është provuar në historinë e Islamit. Edhe sot kjo mund të provohet. Ne, në Iranin islam, kemi arritur të hedhim një hap, sado modest, në këtë drejtim, dhe tashmë mund të shohim rezultatet, arritjet dhe frytet e tij. Sa më shumë të ecim përpara në këtë rrugë, aq më tepër do të shtohen begatitë dhe mirësitë e Allahut.

[1] Sure "El-Fet'h", ajeti 4.

Kjo është receta e vetme e suksesshme për ymetin islam. Kur'ani është hyrja drejt saj dhe është rruga e drejtë që e çon drejt shpëtimit.

Nëse dëshirojmë ta përhapim dhe ta bëjmë Kur'anin e Shenjtë pjesë të çdo shtëpie, ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve, grave dhe burrave, atëherë duhet t'i nderojmë lexuesit e Kur'anit, sepse ata janë heronj. Ata e bartin Kur'anin me vete kudo që shkojnë. Prandaj, ne i duam dhe i respektojmë. Ata janë njerëz të nderuar dhe gjuhët e tyre janë të nderuara. Po, gjuhët dhe zemrat e tyre janë të shtrenjta për ne, sepse janë të lidhura ngushtë me Kur'anin. Shpirtrat tanë qofshin flijim për Kur'anin!

Edukojini fëmijët tuaj sipas mësimeve të Kur'anit, ashtu siç vepruan të parët. O të rinj të dashur! Dijeni se zemrat tuaja janë të pastra, të ndriçuara dhe të lidhura me Kur'anin. Vlerësojini këto ndjenja. Ata që Allahu i ka nderuar me suksesin për të mësuar përmendsh ajetet e Kur'anit, duhet t'i çmojnë ato, sepse ato kanë një vlerë të jashtëzakonshme dhe janë një thesar i çmuar. Nëse i vlerësoni këto mirësi, rrugëtimi juaj do të vazhdojë dhe udha drejt dritës dhe burimit të pashtershëm kur'anor nuk do të marrë fund. Atëherë ymeti islam, me ndihmën e Kur'anit, do ta rifitojë pozitën e tij të lartë dhe dinjitetin që kishte dikur.[1]

Kur'ani duhet të mbizotërojë në atmosferën e jetës sonë, në mënyrë që t'i ndiejmë begatitë e tij kudo. Nën hijen e Kur'anit do të jemi në gjendje ta mishërojmë në praktikë vetëdijen, largpamësinë,

[1] Fjalim i Udhëheqësit të Madh të Revolucionit Islamik në ceremoninë përmbyllëse të Edicionit të 15-të të Garave kur'anore, më 1/9/1377 sipas kalendarit Iranian, 22 nëntor 1998.

guximin dhe trimërinë për të cilat flasim. Atëherë do të ecim drejt synimeve të drejta dhe të vërteta.

Kur'ani u drejtohet besimtarëve duke thënë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَجِيبُوا لِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُمْ لِمَا يُحْيِيكُمْ﴾

"O ju që besuat! Përgjigjjuni Allahut dhe të Dërguarit, kur ai ju thërret në atë që ju jep jetë."[1]

Cila është kjo jetë në të cilën na thërrasin Allahu dhe i Dërguari i Tij? Me një fjalë, ajo është jeta ideale, e denjë për njeriun, jeta e vërtetë që i jep kuptim ekzistencës së tij.[2]

Në errësirën e thellë të botës së sotme, nën peshën e arrogancës botërore, të padrejtësisë dhe shtypjes, Islami dhe Kur'ani janë streha e vetme që mund t'i shpëtojë popujt dhe shoqëritë. Pikërisht për këtë arsye, fuqitë shtypëse që sundojnë botën e luftojnë Islamin me të gjitha mjetet dhe mundësitë e tyre dhe përpiqen ta pengojnë vendosjen dhe sundimin e tij.

Republika Islamike e Iranit ishte përvoja e parë e suksesshme e fitores së Islamit dhe e themelimit të qeverisjes së tij. Për këtë arsye, armiqësia dhe urrejtja e këtyre fuqive sunduese ndaj kësaj përvoje është shtuar dita-ditës. Prandaj, ato zhvillojnë kundër saj një luftë të pandërprerë, si në mënyrë të hapur, ashtu edhe në fshehtësi.

[1] Sure "El-Enfal", ajeti 24.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëllimi 7, f. 122–123.

Ne jemi të lumtur për vizitën e vëllezërve tanë këtu. Në të vërtetë, ju keni ardhur në tokën e Kur'anit. Populli iranian e do sinqerisht Kur'anin. Falënderojmë Allahun e Madhëruar që populli ynë nuk mjaftohet vetëm me leximin e jashtëm të Kur'anit, por përpiqet ta zbatojë atë në jetën e tij. Po ashtu, ligjet në vendin tonë janë hartuar mbi bazën e mësimeve të Kur'anit. Dijeni se ne ju duam me gjithë zemër, o vëllezër lexues të Kur'anit. Me mall e dashuri dëgjojmë zërat tuaj dhe kënaqemi duke i dëgjuar recitimet tuaja.

Para fitores së Revolucionit Islamik, ne ishim pothuajse tërësisht të privuar nga këto mirësi dhe begati. Natyrisht, kishte disa grupe shumë të vogla që mblidheshin diku për të lexuar Kur'anin e Shenjtë, por kjo rritje e madhe dhe ky entuziazëm i jashtëzakonshëm për Kur'anin u bë i mundur falë interesimit të të rinjve, adoleshentëve dhe fëmijëve pas fitores së Revolucionit Islamik.

Nganjëherë ndonjë recitues i njohur vizitonte Iranin, por njerëzit pothuajse nuk merrnin vesh asgjë për këtë. Nuk e dinin as kur kishin ardhur e as kur ishin larguar. Për shembull, më kujtohet se Shejkh Ebu El-Ajnejn erdhi në qytetin e shenjtë të Meshhedit me ftesë të Organizatës së Vakëfeve gjatë regjimit të Shahut.

Unë vetë i kisha dëgjuar shumë regjistrimet e tij dhe e admiroja jashtëzakonisht leximin e tij, por vetëm nga larg. Meqë ne e kishim ndërprerë plotësisht çdo lidhje me institucionin që e kishte ftuar, megjithëse kishim dëshirë të madhe ta dëgjonim drejtpërdrejt zërin e tij, nuk shkonim në ato tubime që organizoheshin për të. Në xhaminë "Goharshad", në Meshhed, ishte caktuar një vend i veçantë ku uleshin dhe recitonin lexuesit e Kur'anit. Megjithatë,

numri i të pranishmëve nuk i kalonte njëqind vetat. Ata formonin një rreth përreth vendit dhe dëgjonin recitimin ulur.

Atëherë ishte dimër dhe moti ishte tepër i ftohtë. Djali im, Muxhteba, ishte ende i vogël dhe e mora me vete. Meqenëse nuk dëshiroja të hyja në ato tubime, u detyrova të ulesha në një dhomë jashtë xhamisë, në të ftohtin e madh, vetëm që ta dëgjoja zërin e recituesit përmes altoparlantëve. Po, në atë kohë nuk kishte as njëqind të pranishëm, ndërsa sot, kur ju hyni në një qytet apo në një vend, i gjithë qyteti gjallërohet dhe lëkundet nga prania juaj.

Po, ne jetojmë falë dashurisë sonë për Kur'anin dhe me bekimin e Kur'anit ne marrim jetë.

Lusim Allahun e Madhëruar që të mos na ndajë kurrë nga Kur'ani i Shenjtë, as në këtë botë e as në Botën Tjetër![1]

Transmetohet se imam Aliu, Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!), i tha një njeriu që kishte kryer vjedhje dhe ishte sjellë para tij: "*Sa pjesë të Kur'anit di përmendsh?*" Njeriu recitoi një ajet nga Surja El-Bekare. Atëherë imam Aliu i tha: "*Ta fala dorën për hir të Sures "El-Bekare".*"

Ky nuk ishte një favorizim i padrejtë apo i papërshtatshëm. Përkundrazi, ishte një veprim i veçantë që mbështetej në pozitën dhe madhështinë e Sures "El-Bekare" dhe kishte për qëllim nderimin e Kur'anit të Shenjtë. Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) nuk bënte kurrë kompromis në çështjet e parimeve, vlerave dhe normave hyjnore. Ai zbatonte pa hezitim dënimet e përcaktuara nga Sheriati ndaj atyre që kryenin gjynahe dhe shthurje, pa marrë

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëllimi 6, f. 231–232.

parasysh interesa personale apo përfitime vetjake. Megjithatë, në këtë rast të ngjashëm, për hir të Kur'anit, ai hoqi dorë nga zbatimi i dënimit të vjedhjes ndaj fajtorit. Ky është Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!). Ai vepronte gjithmonë mbi bazën e vlerave hyjnore dhe nuk merrte parasysh asgjë tjetër. Kjo është drejtësia e Ali ibn Ebi Talibit (Paqja qoftë mbi të!).[1]

Shoqërimi i vazhdueshëm me Kur'anin e Shenjtë e forcon dhe e thellon njohjen islame në mendjet tona. Mjerimi dhe fatkeqësia që kanë goditur shoqëritë islame janë rezultat i largimit nga Kur'ani, të vërtetat dhe mësimet e tij të shumta. Ata myslimanë që nuk i kuptojnë domethëniet dhe konceptet e thella të Kur'anit dhe nuk janë të lidhur me të, gjendja e tyre është e dukshme për të gjithë.

Edhe ata që e lexojnë Kur'anin, madje edhe nëse janë arabë dhe flasin gjuhën e tij, por nuk meditojnë mbi ajetet e tij, nuk i kanë njohur të vërtetat kur'anore dhe nuk janë shoqëruar me to. Për shembull, të gjithë e dinë se në vendet arabe lexohet ky ajet dhe recitohet nga vetë arabët:

﴿لَن يَجْعَلَ اللَّهُ لِلْكَافِرِينَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ سَبِيلًا﴾

"Allahu kurrë nuk do t'u japë jobesimtarëve rrugë për të sunduar mbi besimtarët."[2]

[1] Nga takimi i Udhëheqësit (Allahu e mëshiroftë!) me grupe të ndryshme të popullit, me rastin e përvjetorit të lindjes së Imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), më 5/9/1375 sipas kalendarit iranian, 26 nëntor 1996.

[2] Sure "En-Nisa", ajeti 141.

Kjo do të thotë se Allahu i Madhëruar nuk dëshiron që besimtarët të bien nën sundimin dhe dominimin e mohuesve e të poshtërohen prej tyre. Mirëpo problemi është se ata nuk e zbatojnë këtë ajet fisnik, sepse nuk ndalen për të mediuar mbi të. Për këtë arsye, prapambetja vazhdon të rëndojë mbi vendet dhe shoqëritë islame.

Islami duhet të kuptohet ashtu siç është në të vërtetë dhe në mënyrë të drejtë, ashtu siç pasqyrohet në tekstet autentike islame. Duhet ta njohim Islamin, të mësojmë Kur'anin dhe të përfitojmë sa më shumë nga udhëzimi dhe rruga e tij, sepse Kur'ani është:

﴿تِبْيَانًا لِكُلِّ شَيْءٍ﴾

"...shpjegim i qartë për çdo gjë."[1]

Kur'ani është udhëzim i qartë, argument i ndritshëm dhe rrugë e drejtë. Megjithatë, në shoqëritë islame ekzistojnë faktorë dhe rryma që u mësojnë mendimtarëve dhe intelektualëve se Islami duhet të njihet përmes metodave, mekanizmave dhe shkencave perëndimore. Ky orientim nuk është gjë tjetër veçse vazhdim i dominimit intelektual të Perëndimit dhe i pushtimit kulturor perëndimor, i cili ka frikë nga përhapja e ideologjisë islame në botë.

Natyrisht, të gjitha këto shkenca dhe njohuri mund ta bëjnë myslimanin më të vetëDitur dhe t'i japin një kuptim më të gjerë të botës. Por vetë Islami duhet të merret dhe të nxirret nga burimet e tij autentike. Të vërtetat islame duhet të zbulohen nga tekstet origjinale islame dhe Islami duhet të njihet me terminologjinë e vet

[1] Sure "En-Nahl", ajeti 89.

islame. Vetëm atëherë do ta kuptojmë Islamin ashtu siç është, e më pas do të jemi në gjendje ta zbatojmë dhe të jetojmë sipas tij.

O të rinj dhe të reja të dashur! O ju që mësoni Kur'anin! Dijeni se keni siguruar për veten tuaj një thesar të pashtershëm për të menduar, për të studiuar dhe për të hulumtuar. Ky është një bekim shumë i madh dhe me vlerë të jashtëzakonshme.

Ndoshta në vitet e rinisë nuk do të arrini t'i nxirrni plotësisht kuptimet dhe njohuritë e thella të ajeteve të Kur'anit. Mund të mos i kuptoni ende drejt shumë prej tyre dhe ndoshta nga Kur'ani do të përfitoni vetëm disa kuptime të thjeshta e të jashtme. Mirëpo, sa më shumë të rritet niveli juaj i dijes dhe përparimit shkencor, aq më tepër do të përfitoni nga ajetet që kanë mbetur të ruajtura në kujtesën dhe mendjen tuaj. Vetë prania e Kur'anit në kujtesën e njeriut është një mirësi shumë e madhe.

Ka një ndryshim të madh ndërmjet atij që, kur i nevojitet një temë, fillon të shfletojë Kur'anin ose treguesit e tij për të parë nëse ekziston ndonjë ajet që lidhet me atë çështje, dhe atij që ajetet i ka të pranishme në mendje e në zemër. Ky i fundit, kur i duhet një udhëzim, i kujton menjëherë ajetet, i mediton ato dhe prej tyre nxjerr atë që i nevojitet në çdo fushë të njohurive islame. Ai është në gjendje të reflektojë thellë mbi to dhe të përfitojë vazhdimisht prej tyre.

Po, shoqërimi me Kur'anin që nga fëmijëria, pastaj gjatë adoleshencës dhe rinisë, është një mirësi e paçmueshme.

Natyrisht, njohja fillestare e fjalëve dhe kuptimeve të dukshme të Kur'anit është hapi i parë dhe është në vetvete i

domosdoshëm. Nëse studentët e hauzave (shkollave islame shiite) dhe ata që merren me studimin e Kur'anit nuk e hedhin këtë hap të parë, hapat e tjerë do të bëhen shumë të vështirë, madje ndonjëherë edhe të pamundur.

Sot shohim njerëz që flasin për Islamin, mbajnë ligjërata këtu e atje dhe pretendojnë shumë gjëra që nuk kanë asnjë lidhje me Islamin. Pse? Sepse nuk i kanë njohur mësimet autentike islame, tekstin e Kur'anit dhe Sunetin. Njeriu duhet ta njohë tekstin e Kur'anit të Shenjtë dhe Sunetin, pra hadithet e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe fjalët e imamëve të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!), në mënyrë që t'i kuptojë drejt mësimet fetare, sidomos nëse dëshiron të thellohet në to. Ky është hapi i parë dhe njëkohësisht hapi më i domosdoshëm në këtë rrugë.

Nëse meditoni dhe reflektoni mbi ajetet e Kur'anit, atëherë vullneti juaj do të forcohet dhe qëndrueshmëria juaj do të rritet edhe më shumë se sa është sot. Janë pikërisht këto ajete kur'anore që, në të kaluarën, edukuan njerëz të cilët u përballën me bllokun botëror të kufrit, padrejtësisë dhe errësirës. Janë këto mësime që e frymëzuan dhe e përgatitën popullin tonë të madh për t'u përballur me një botë të përparuar teknologjikisht, por të zhytur në errësirë morale. Kjo është injoranca moderne, xhahilijeti i shekullit të njëzetë. Ne shpresojmë që populli ynë, ditë pas dite, të afrohet gjithnjë e më shumë me Kur'anin dhe me të vërtetën.

Ky muaj, muaji i Ramazanit, është muaji i agjërimit; muaji i zbritjes së Kur'anit dhe i shoqërimit me të; muaji i adhurimit, i lutjes dhe i përgjërimit ndaj Allahut, sepse lutja është thelbi dhe shpirti i adhurimit. Ai është muaji i istigfarit (kërkimit të faljes), i pendimit

dhe i largimit nga rrugët që Allahu i Madhëruar i ka refuzuar; muaji i devotshmërisë hyjnore.

Ramazani është edhe muaji i xhihadit. Beteja e Bedrit ndodhi në këtë muaj të bekuar, në vitin e dytë pas Hixhretit. Po ashtu, Çlirimi i Mekës ndodhi në vitin e tetë pas Hixhretit dhe në të njëjtin vit filloi edhe Beteja e Hunejnit. Prandaj, ky është muaji i luftës kundër vetvetes, i luftës kundër shejtanit dhe i xhihadit kundër armiqve të Allahut.

Ky është muaji i përgatitjes dhe i grumbullimit të devotshmërisë; muaji i mbajtjes së lidhjeve farefisnore; muaji i sinqeritetit dhe i mirësisë ndaj vëllezërve në besim; muaji i njohjes së shkencave fetare dhe i meditimit mbi Kur'anin. Me pak fjalë, ky është muaji në të cilin besimtari përgatit kapitalin shpirtëror për tërë vitin.

Shpresojmë që ditët që kanë kaluar prej këtij muaji t'i kemi kaluar me vepra që përputhen me frymën e tij, ndërsa ditët që kanë mbetur t'i vlerësojmë edhe më shumë. Duhet të marrim një vendim të prerë për ta luftuar egon që urdhëron për të keqen, për t'iu bindur urdhrave të Allahut, për të përmirësuar sjelljen tonë me njerëzit, për të medituar mbi Kur'anin e Shenjtë dhe për të qenë të vendosur në përpjekjen kundër vetvetes.

Njeriu duhet të jetë i vetëDitur, si në jetën e tij individuale ashtu edhe në atë shoqërore, për mjetet që Allahu i Madhëruar i ka vënë në dispozicion, në mënyrë që përmes tyre të zhvillojë personalitetin e tij dhe të afrohet drejt qëllimit të lartë. Ai duhet t'i shfrytëzojë mundësitë që Allahu ua ka dhënë besimtarëve për të arritur synimin e dëshiruar.

Qëllimi i devotshmërisë (tekvasë) është që njeriu të jetë vazhdimisht vigjilent ndaj këtyre çështjeve. Siç e keni dëgjuar shumë herë, një nga synimet më të rëndësishme të muajit të Ramazanit është fitimi i devotshmërisë. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ﴾

"…që të bëheni të devotshëm."[1]

Kur unë shoh veprat, të cilave Sheriati i Shenjtë u ka kushtuar rëndësi të veçantë në muajin e Ramazanit, si: agjërimi, leximi i Kur'anit të Shenjtë, lutjet e transmetuara nga të pagabueshmit, përgjërimet me të cilat kërkojmë kujdesin dhe mëshirën e Allahut, si dhe istigfari, ndiej se pikërisht kjo është një nga çështjet më të rëndësishme për ne.

Istigfar do të thotë t'i kërkosh falje Allahut, Zotit të botëve, për gabimet që kemi bërë nga padituria dhe mangësia, si dhe, Allahu na ruajtë, për gjynahet që mund t'i kemi kryer me vetëdije dhe nga neglizhenca.[2]

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, sepse në historinë e Iranit nuk ka pasur asnjë ditë si kjo periudhë dhe kjo epokë për stabilitetin e qeverisë islame; ku flamuri i Kur'anit është valëvitur mbi këtë tokë. Po ashtu, zbatimi i dispozitave islame konsiderohet nga vlerat dhe virtytet më të larta, dhe ligjet e vendit

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 183.

[2] Fjalim i Udhëheqësit të Madh të Revolucionit Islamik në dy hytbet e namazit të xhumasë në Teheran, më 26/10/1376 sipas kalendarit iranian, 1997.

janë nxjerrë nga Islami dhe Kur'ani. Çfarë mund të dëshirojmë ne pas gjithë kësaj?

Cila është ajo mirësi më e madhe dhe më e lartë se kjo mirësi? Çfarë kërkese mund t'i bëjmë Allahut pas gjithë kësaj? Duhet të bëjmë përpjekjen maksimale që të ruajmë këtë begati të çmuar, këtë dhuratë të jashtëzakonshme dhe të pashoqe, në mënyrë që ajo të mbetet një thesar për këtë popull. Kjo nuk mund të arrihet veçse përmes përpjekjes dhe këmbënguljes së sinqertë.[1]

Allahu e njeh këtë popull dhe i di veçoritë e tij; prandaj i ka ngarkuar atij përgjegjësinë më të madhe dhe më të rëndë, që është ringjallja e Islamit, Kur'anit dhe vlerave islame në një fazë të re.[2] Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar për suksesin e këtij populli në këtë mision dhe rrugë. Megjithatë, ne ende jemi në gjysmë të rrugës dhe duhet të përpiqemi edhe më shumë.[3]

Armiqtë kanë bërë përpjekje të shumta për të krijuar trazira dhe konfuzion në shoqërinë iraniane dhe mendonin se Islami në Iran ishte dobësuar dhe ishte zbehur, deri në atë pikë sa myslimani nuk guxonte të krenohej me Islamin e tij. Por shikoni çfarë ka ndodhur sot: kudo që mblidhen disa myslimanë, edhe nëse janë pak, ata e ngrenë Kur'anin lart, e shpallin me zë të lartë dhe me krenari se "ne jemi myslimanë". Kjo është një nga rezultatet e

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilajeh", vëll. 5, f. 42.

[2] Iranianët kanë kontribuar gjerësisht në pasurimin dhe thellimin e lëvizjes shkencore, letrare dhe fetare në Islam, pas hyrjes së tij në Iran për herë të parë.

[3] Cituar nga libri "Hadithul-Uilajeh", vëll. 5, f. 99.

Revolucionit Islamik që ju e keni realizuar dhe që e ka udhëhequr imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!).[1]

Republika Islamike e ngriti flamurin e Islamit dhe Kur'anit. Që në fillim, Revolucioni, imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!) dhe populli deklaruan se nuk jemi nga ata që e ndajnë dynjanë nga Ahireti, siç propagandonin armiqtë e fesë. Ata pretendonin se dynjaja dhe Ahireti janë të ndara dhe të shkëputura nga njëra-tjetra. Por jo! Dynjaja dhe Ahireti janë të lidhura dhe nuk mund të ndahen. Edhe vetë jeta e kësaj bote është një detyrim fetar. Kjo është ajo që Islami, Revolucioni Islamik dhe populli mysliman i Iranit e kanë theksuar që në fillim.[2]

Këta të rinj që po i shihni tani, të cilët e duan Kur'anin dhe jeta e tyre është e ndërthurur me Kur'anin, nuk kanë qenë të tillë në kohën e regjimit të Shahut. Përkundrazi, atëherë ishin të pavëmendshëm ndaj Kur'anit. Prandaj mund të thuhet se ata kanë bërë një rrugë të madhe në jetën e tyre dhe kanë arritur në këtë gjendje që janë sot. Ne do të përpiqemi, me dëshirën e Allahut, që ta ruajmë Kur'anin, dhe u kam theksuar vazhdimisht përgjegjësve që ta kenë këtë çështje gjithmonë para syve.[3]

Populli iranian dhe të gjithë myslimanët në botë duhet t'i kushtojnë vëmendje një çështjeje shumë të rëndësishme: armiqësia dhe urrejtja e bllokut të fuqive arrogante ndaj Iranit Islam nuk është për asgjë tjetër veçse për shkak të Islamit. Ata e kundërshtojnë Islamin dhe për këtë arsye ushtrojnë presion mbi Republikën

[1] Po i njëjti burim, vëll. 6, f. 221.

[2] Po i njëjti burim, vëll. 7, f. 64.

[3] Po i njëjti burim, f. 82.

Islamike. Ata janë kundër ringjalljes së Kur'anit të Shenjtë dhe, nga ky këndvështrim, janë armiq edhe të popullit iranian të guximshëm. Detyrë e të gjithë popujve myslimanë që dëshirojnë sakrificë dhe lëvizje është të përgatiten për përballjen me sfidat e armiqve të Islamit.

Ne si popull mysliman në Iran krenohemi me faktin se jemi bërë objekt i armiqësisë së arrogantëve dhe tiranëve të botës, për shkak se kemi ecur në rrugën e Allahut, Islamit dhe Kur'anit. Të rinjtë tanë krenohen sepse kanë qenë në frontet e luftës së imponuar, kanë luftuar kundër armikut dhe kanë përballuar vështirësi e vuajtje për Islamin. Çdo mundim dhe çdo fatkeqësi, nëse është në rrugën e Allahut dhe në mbrojtje të vlerave islame dhe Kur'anit, konsiderohet vepër e mirë. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ لَا يُصِيبُهُمْ ظَمَأٌ وَلَا نَصَبٌ وَلَا مَخْمَصَةٌ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا يَطَأُونَ مَوْطِئًا يَغِيظُ الْكُفَّارَ وَلَا يَنَالُونَ مِنْ عَدُوٍّ نَّيْلًا إِلَّا كُتِبَ لَهُم بِهِ عَمَلٌ صَالِحٌ﴾

"Kjo ndodh sepse ata nuk i godet as etja, as lodhja, as uria në rrugën e Allahut; dhe nuk shkelin në ndonjë vend që i zemëron mohuesit, dhe nuk arrijnë ndonjë fitore ndaj armikut, veçse u shkruhet për të një vepër e mirë."[1]

Po, ky është slogani ynë. Çdo vuajtje që ka përjetuar populli iranian në këtë rrugë nuk ka qenë për asgjë tjetër veçse për Allahun e Madhëruar, prandaj ne krenohemi me këto vështirësi dhe sprova.

[1] Sure "Et-Teube", ajeti 120.

E vërteta e dytë e qartë është se rruga e Allahut është ajo që çon drejt suksesit, shpëtimit dhe fitores së sigurt. Historia na e ka vërtetuar këtë, dhe edhe përvoja bashkëkohore e ka dëshmuar të njëjtën gjë. Ne durojmë, qëndrojmë dhe rezistojmë në rrugën e Allahut dhe e dimë se fitorja vjen pas këtij durimi dhe qëndrese, me dëshirën e Allahut:

﴿وَلَيَنصُرَنَّ اللَّهُ مَن يَنصُرُهُ﴾

"Allahu me siguri do ta ndihmojë atë që e ndihmon Atë."[1]

Ka një dashuri dhe mall të madh për Kur'anin në çdo pjesë të vendit tonë. Falënderimi i takon Allahut! Ne e falënderojmë Allahun sepse të rinjtë, fëmijët dhe i gjithë populli ynë e duan Kur'anin me gjithë zemrën e tyre dhe janë të lidhur me të në lexim, në texhvid, në kuptim dhe në fikh.

Nuk ka dyshim se interesat afatgjata të shoqërisë islame nuk mund të realizohen pa Islamin dhe Kur'anin. Vetëm Islami dhe Kur'ani janë të aftë të garantojnë interesat e vërteta të myslimanëve, duke vendosur drejtësi, barazi dhe duke përmbushur nevojat reale të tyre. Asnjë sistem tjetër nuk mund ta realizojë këtë detyrë, sepse përmbushja e vërtetë e jetës njerëzore mund të arrihet vetëm përmes ligjeve të Allahut të Madhëruar dhe sundimit të vlerave islame.

Revolucioni Islamik erdhi për t'i dhënë popullit iranian një jetë të mirë, po, atë "jetë të mirë"[2] që e përmend edhe Kur'ani i

[1] Sure "El-Haxh", ajeti 40.

[2] "Hadithul Uilajeh", f. 136–137.

Shenjtë. Kjo jetë e mirë është rezultati i dëshiruar dhe qëllimi përfundimtar i këtij revolucioni të bekuar. Jeta e mirë do të thotë që njerëzit të gëzojnë mirëqenie materiale, jetën e përditshme të qetë, sigurinë dhe stabilitetin, përparimin në dije, arsim dhe edukim, si dhe dinjitet politik, pavarësi ekonomike dhe zhvillim financiar e ekonomik.

Nga ana shpirtërore dhe morale pritet që njeriu në këtë shoqëri model të rritet në rrugën e besimit, të përkushtimit ndaj urdhrave të Allahut, të ruajtjes së devotshmërisë dhe të moralit të lartë hyjnor. Kjo është jeta e mirë.[1]

Të dashur vëllezër dhe motra! Nëse një popull dëshiron të jetojë i lirë dhe i pavarur, dhe nëse dëshiron një jetë që e kërkon Kur'ani dhe Islami dhe e konsideron të denjë për njeriun besimtar, atëherë ai duhet të përpiqet dhe të sakrifikojë shumë. Nuk është e mundur që një vend të ndërtohet dhe zhvillohet në mënyrë të denjë për një popull të madh pa përpjekje serioze. Po ashtu nuk është e mundur të edukohet një shoqëri sipas asaj që kërkon Allahu i Madhëruar, Islami dhe kultura kur'anore përmes përtacisë, dështimit, dobësisë, nënshtrimit, ose përmes mbështetjes në besëtytni, ide të dobëta dhe indiferencë ndaj vlerave të larta islame.[2]

A e keni vënë re se si Imam Khomeini i madh (Allahu e mëshiroftë!) zgjodhi një rrugë dhe metodë të ngjashme me atë të profetëve dhe njerëzve të devotshëm që janë të lidhur me botën e

[1] Në ditën e parë të vizitës së Udhëheqësit të Revolucionit Islamik në qytetin Sari, më 22/7/1374 sipas kalendarit Iranian, 14/9/1995.

[2] Fjalim i Udhëheqësit në një tubim të madh në sheshin e mauzoleut të imam Khomeinit (Allahu e mëshiroftë!), më 14/3/1376 sipas kalendarit Iranian, 4/4/1997.

fshehtë, në formësimin e këtij revolucioni dhe në ndërtimin e sistemit politik të vendit mbi bazën e tij, pra në themelimin e qeverisë dhe të Republikës Islamike, me ndihmën e Allahut të Madhëruar dhe udhëzimeve hyjnore.

E gjithë kjo ndodhi sepse Imami (r.a.) e donte Kur'anin, ishte nxënës i shkollës së Kur'anit, ishte i lidhur me të, dhe e merrte mendimin e tij nga Kur'ani. Për të, Kur'ani ishte program jete. Prandaj Revolucioni Islamik është një nga rezultatet më të mëdha dhe më të rëndësishme që doli nga kjo e vërtetë e çmuar.[1]

Në ato ditë, disa përdornin termin "demokraci" krahas "republikës". Kjo është një fjalë e huaj që bart kuptime të dyfishta. Perëndimorët pretendonin demokraci, dhe gjithashtu edhe shtetet socialiste dhe Europa Lindore e përdornin këtë term. Në atë kohë "demokracia" ishte bërë si një modë botërore për emërtimin e shteteve dhe sistemeve politike.

Në Iran, pas fitores së Revolucionit, disa grupe këmbëngulnin që të shtohej fjala "demokraci" pranë "Republikës Islamike". Por çështja nuk ishte thjesht një fjalë e shtuar; pas saj fshiheshin shumë tema dhe zhvillime që do të shfaqeshin më vonë në skenë. Prandaj Imam Khomeini i shihte të gjitha këto me vizionin e tij të thellë dhe largpamës.[2]

Islami i ndritshëm ju ka ndriçuar rrugën me ajetet e Kur'anit të Shenjtë, të cilat janë si drita të fuqishme udhëzuese për të ecur në

Më lejoni t'i referohem historisë dhe t'ju paraqes dy shembuj, që ta kuptoni më mirë se si konceptet e paqarta dhe me kuptime të dyfishta mund ta përçajnë dhe ta copëtojnë një shoqëri.

Shembulli i parë lidhet me Betejën e Siffinit. Kur ushtria e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ishte pranë fitores dhe kishte vënë Muavijen në pozitë të vështirë, armiqtë ngritën mus'hafët (Kur'anët) mbi majat e heshtave. Sapo disa prej shokëve të imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) panë Kur'anët e ngritur, në radhët e tyre u përhap përçarja dhe mosmarrëveshja.

Ky veprim nënkuptonte: Le të jetë Kur'ani gjykues mes nesh dhe jush.

Disa nga shokët u tronditën dhe thanë: 'Nuk është e drejtë të luftojmë kundër Kur'anit!'

Por një grup tjetër u përgjigj: 'Ne pikërisht për këtë arsye po luftojmë kundër tyre, sepse ata janë në luftë me Kur'anin.'

Ata kishin ngritur vetëm lëkurën dhe formën e jashtme të Kur'anit, ndërsa në realitet po luftonin kundër shpirtit të Kur'anit, që ishte imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), Prijësi i besimtarëve.

Megjithatë, përçarja ndodhi. Në ushtrinë e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) u krijua ndarje dhe përçarje e thellë, e cila e tronditi rëndë atë ushtri. Kjo ishte një nga planet dhe komplotet e armikut.

Shembulli tjetër ndodhi po në të njëjtën luftë të Siffinit, pasi u imponua çështja e arbitrazhit (tahkimit) mbi imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!). Një grup brenda kampit të imam Aliut, të cilët ishin

nga shokët dhe të afërmit e tij dhe jo armiq apo të huaj, ngritën sloganin:

﴿لَا حُكْمَ إِلَّا لِلَّهِ﴾

"Nuk ka gjykim, përveçse për Allahun."

Po, kjo është e vërtetë, edhe Kur'ani i Shenjtë e përmend këtë kuptim se "nuk ka gjykim përveç Allahut". Por çfarë donin ata me këtë slogan?

Ata donin që me këtë parullë ta rrëzonin imam Aliun (Paqja qoftë mbi të!) nga pushteti. Mirëpo Imami ua demaskoi planin dhe e zbuloi komplotin e tyre, duke thënë: "Po, gjykimi dhe sundimi i përkasin vetëm Allahut të Madhëruar, por këta nuk po e kërkojnë këtë me të vërtetë; përkundrazi, besimi i tyre i vërtetë është: 'Nuk ka udhëheqje përveçse për Allahun', dhe sipas pretendimit të tyre, Allahu (Zoti na ruajtë!), duhej të mishërohej dhe vetë të drejtonte çështjet e shoqërisë! Pra, sipas tyre, Aliu (Paqja qoftë mbi të!) duhej të jepte dorëheqje nga qeverisja!"

Kështu, ky slogan çoi në daljen e një grupi myslimanësh nga kampi i imam Aliut dhe bashkimin e tyre me një grup tjetër të devijuar, injorant, sipërfaqësor dhe ndonjëherë me qëllime të këqija. Në fund, kjo çoi në shfaqjen e sektit të khavarixhëve.[1]

Haxhaxh ibn Jusuf Eth-Thekafij ishte një njeri shumë i gojëtarisë dhe ndër oratorët më të aftë të arabëve. Fjalimet që

[1] Cituar nga hytbet e namazit të xhumasë në Teheran, të Udhëheqësit të Revolucionit Islamik, më 26/1/1379 sipas kalendarit Iranian, 15 mars 2000.

mbante nga minberi konsiderohen shumë elokuente dhe të fuqishme, aq sa Xhahidhi i ka transmetuar në librin e tij "*El-Bejan uet-Tejbin*". Në të njëjtën kohë, ai ishte edhe hafiz i Kur'anit, por ishte një njeri i lig dhe i keq, që armiqësohej me drejtësinë dhe kundërshtonte Ehli Bejtin e Profetit (Paqja qoftë mbi ta!).

Ai ishte një figurë e çuditshme dhe një qenie shumë komplekse.

Një herë, një nga khauarixhët u soll te Haxhaxhi dhe ai e pyeti, pasi kishte marrë vesh se ai e dinte Kur'anin përmendsh: 'A e ke mbledhur Kur'anin?'

Me këtë ai donte të thoshte: 'A e ke mësuar Kur'anin përmendsh?'

Vini re përgjigjen e ashpër dhe sfiduese të këtij khavarixhi, nga e cila mund të kuptoni natyrën e tyre:

Ai u përgjigj: 'A ishte i shpërndarë që ta mblidhja?'

Natyrisht, ai e kuptonte çfarë donte të thoshte Haxhaxhi, por ai zgjodhi të mos i përgjigjej drejtpërdrejt.

Është e vërtetë që Haxhaxhi ishte një njeri gjakatar dhe shumë i ashpër, por në këtë rast ai u tregua i durueshëm dhe i përmbajtur. Ai e pyeti: A e ke ruajtur atë (e ke mësuar përmendsh Kur'anin)?

Khauarixhi iu përgjigj: Mos vallë kisha frikë se do të ikte, që ta ruaja?

Ishte një përgjigje e pahijshme, provokuese dhe fyese.

Kur Haxhaxhi e kuptoi se ai nuk kishte ndërmend t'u përgjigjej pyetjeve seriozisht, e pyeti për herë të fundit: Çfarë mendon për Prijësin e besimtarëve, khalifin Abdulmelik?, duke pasur për qëllim Abdulmelik ibn Mervanin, khalifin emevit.

Khauarixhi iu përgjigj: Allahu e mallkoftë atë dhe të mallkoftë edhe ty bashkë me të!

Shikoni sa haptazi dhe me sa ashpërsi i shprehnin bindjet e tyre.

Atëherë Haxhaxhi, me gjakftohtësi, i tha: Ti do të vritesh. Më thuaj, si do ta takosh Allahun?

Khauarixhi u përgjigj: Unë do ta takoj Allahun me veprat e mia, ndërsa ti do ta takosh Atë me gjakun tim!

Vëreni sa e madhe ishte kokëfortësia dhe fanatizmi i tyre. Pikërisht nga kjo kuptohet se përballja me këtë grup nuk ishte aspak e lehtë.

Megjithatë, njerëzit e thjeshtë shpesh mbeteshin të mahnitur nga figura të tilla pasi i takonin. Ata që nuk kishin fituar vetëdije dhe largpamësi, kur shihnin një person me këtë lloj vendosmërie dhe pamjeje fetare, magjepseshin prej tij. Kjo ndodhi realisht edhe në kohën e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).[1]

Ajo që më kujton gjithmonë, o lexues të nderuar të Kur'anit, dhe që për mua ka rëndësi shumë të madhe, është se ju keni mundësi t'ua drejtoni vëmendjen dëgjuesve drejt kuptimit dhe përmbajtjes së Kur'anit. Ju luani rolin kryesor në këtë fushë.

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 7, f. 49–50.

Në të vërtetë, ajo për të cilën njerëzit kanë më shumë nevojë sot në lidhje me Kur'anin është që ta kuptojnë dhe ta përvetësojnë atë. Kjo mund të arrihet nëpërmjet mënyrës se si ju e përcillni dhe e lexoni atë. Sa e bukur dhe e nevojshme është që disa ajete të Kur'anit të përsëriten shpesh, sepse ato përputhen plotësisht me gjendjen dhe rrethanat në të cilat ndodhet sot ymeti islam."

Natyrisht, njerëzit kanë nevojë për të gjitha ajetet e Kur'anit, por disa prej tyre sot duhet të marrin vëmendje të veçantë dhe të jenë vazhdimisht në qendër të kujdesit të njerëzve. Këto janë ajetet që flasin për mbështetjen tek Allahu, mosfrikësimin nga armiqtë e Allahut, xhihadin në rrugën e Tij, shpresën në mirësinë dhe ndihmën hyjnore, si dhe, veçanërisht, çështjen e unitetit të myslimanëve.

Falë Allahut, Kur'ani i Shenjtë përmban shumë tema dhe kuptime të larta. Nëse ju i lexoni këto ajete në tubime dhe mbledhje, njerëzit do të afrohen me këto kuptime dhe mësime kur'anore. Në këtë mënyrë do të keni bërë një shërbim shumë të madh.

Madje, nëse një ajet i vetëm lexohet bukur dhe me ndikim, ndonjëherë ai ka më shumë vlerë dhe lë gjurmë më të thella sesa një ligjëratë e tërë njëorëshe mbi po atë ajet. Kjo sepse një lexim (*tilavet*) i tillë, në të vërtetë, sjell një revolucion në shpirtin e njeriut.

Falënderimi për një mirësi do të thotë ta përdorësh atë në vendin dhe mënyrën e duhur. Falënderimi për këtë zë të bukur, për këtë frymëmarrje të fuqishme dhe për njohjen e sekreteve të një

leximi (*tilaveti*) të bukur është që njeriu ta kryejë detyrën e tij dhe ta përdorë këtë dhunti ashtu siç duhet."[1]

Është e vërtetë se të gjitha ajetet e Kur'anit të Shenjtë janë dritë, por rinia jonë sot ka nevojë të veçantë për një grup të caktuar ajetesh. Pikërisht ato që udhëzojnë drejt krenarisë islame, lartësimit të shoqërive islame dhe unitetit praktik ndërmjet popujve dhe komuniteteve myslimane në mbarë botën.

Të rinjtë myslimanë, kudo në botën islame, duhet t'i mësojnë përmendsh këto ajete, t'i lexojnë vazhdimisht dhe të nxjerrin prej tyre mësimet dhe udhëzimet e nevojshme për jetën.

Madje, një herë ua sugjerova imamëve të xhamive në disa vende arabe dhe islame, të cilët zgjidhnin ajete të caktuara për t'i lexuar në namazet e përditshme, që të përzgjidhnin ato ajete të Kur'anit që kanë ndikim të veçantë në fatin dhe të ardhmen e popujve islamë.

Natyrisht, ne u kërkojmë njerëzve t'i lexojnë dhe t'i mësojnë të gjitha ajetet e Kur'anit dhe jemi të bindur se ata, pa dyshim, do t'i mësojnë ato. Mirëpo, dua të theksoj se ekzistojnë disa koncepte kur'anore nga të cilat kolonializmi i ka mbajtur larg myslimanët dhe armiqtë i kanë privuar masat myslimane në mbarë botën nga njohja e tyre.

Po, ata na kanë larguar nga koncepti i xhihadit, nga ajetet që theksojnë se jobesimtarët nuk duhet të kenë sundim mbi

[1] Po aty, vëll. 3, f. 308–309.

myslimanët dhe nga ajetet që nxisin unitetin, solidaritetin dhe bashkimin e myslimanëve.

Për shembull, ajeti që u lexua pak më parë:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَا مِن رَّسُولٍ إِلَّا لِيُطَاعَ بِإِذْنِ اللَّهِ﴾

"Ne nuk kemi dërguar asnjë të Dërguar veçse që t'i bindet atij (populli), me lejen e Allahut."[1]

Po ashtu edhe ajetet që, në kuptimin dhe përmbajtjen e tyre, flasin për epërsinë udhëzuese të Islamit në tokë dhe për drejtimin e shoqërive sipas mësimeve të tij. Është detyrë e çdo myslimani që t'i mësojë këto ajete dhe t'i zbatojë ato në jetën praktike.[2]

Një çështje shumë e rëndësishme është se përdorimi i artit, ashtu si çdo mjet tjetër që bart një ide dhe një mesazh, duhet të ketë një synim të qartë, të saktë dhe të drejtë. Nëse mungon ky synim, rruga e së ardhmes do të devijojë dhe do të largohet nga udha e drejtë.

Po, i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) përdorte të gjitha mjetet dhe mundësitë e disponueshme, madje edhe artin, për ta përcjellë mesazhin e Allahut në formën më të bukur dhe më madhështore të mundshme. Kjo formë ishte vetë Kur'ani i Shenjtë.

Në të vërtetë, Kur'ani mbart në vetvete një pasuri të jashtëzakonshme artistike dhe një bukuri të pafundme, të cilën nuk

[1] Sure "En-Nisa", ajeti 64.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 7, f. 141.

mund ta përfytyrojmë plotësisht. Nëse e studioni me kujdes të gjithë Kur'anin, nga fillimi deri në fund, si edhe hadithet e Profetit të nderuar (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), do të shihni se tema e teuhidit (njëshmërisë së Allahut), lufta kundër shirkut, idhujtarisë dhe shejtanit, si simbol i së keqes, mjerimit dhe ligësisë, është e pranishme në të gjitha pjesët e Kur'anit me një pasuri të jashtëzakonshme.

Po kështu, në shumicën e ajeteve mbizotërojnë thirrja për përpjekje dhe punë të pandërprerë, dashuria për njerëzit, nderimi i njeriut dhe i njerëzimit. Me fjalë të tjera, parimet themelore të Islamit dhe të gjitha çështjet që përbëjnë bazën dhe shtyllën e revolucionit gjenden me bollëk në të gjithë Kur'anin. Këto parime i gjejmë, gjithashtu, në letërsinë arabe të periudhës së hershme islame, në letërsinë autentike islame përgjatë shekujve, në transmetimet e imamëve të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!) dhe në mësimet e përmbledhura në faqet e "Nehxhul Belagës" të imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!).[1]

Në të vërtetë, imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ishte një artist i jashtëzakonshëm dhe një gjeni i madh. Po ashtu, edhe Profeti i nderuar (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ishte një artist i mrekullueshëm. Ndërsa Kur'ani nuk është thjesht një vepër artistike që tejkalon aftësitë njerëzore, ai është Libër i Allahut.

Islami, që në fillesat e tij, u shfaq përmes artit. Po të mos e kishte Islami Kur'anin, këtë kryevepër të pashoqe gjuhësore dhe

[1] Po aty, vëll. 2, f. 314–315.

artistike, ndoshta në disa drejtime përhapja e tij do të ishte përballur me vështirësi.

Allahu i Madhëruar nuk ka sjellë asgjë pa urtësi dhe pa një qëllim të lartë. Ka ekzistuar një urtësi e thellë që këto koncepte dhe kuptime hyjnore t'u paraqiteshin njerëzve pikërisht përmes këtij arti madhështor dhe me ndikim të jashtëzakonshëm. Kanë kaluar më shumë se 1400 vjet nga zbritja e Kur'anit, e megjithatë ai vazhdon t'i zgjojë njerëzit, t'i nxisë drejt lëvizjes dhe revolucionit shpirtëror.

Kur'ani është mjeti më i fuqishëm që ju zotëroni sot për të frymëzuar jetë, gjallëri dhe lëvizje në shoqëritë islame. Ajetet e tij janë instrumenti më i mirë për këtë mision. Ky është një realitet vërtet mahnitës: Kur'ani nuk është prekur nga vjetërsia e kohës dhe nuk do ta mbulojë kurrë pluhuri apo ndryshku i shekujve.

Prandaj, kudo që të jeni, ju mund ta mbani këtë armë të dobishme dhe këtë mjet me ndikim të madh, për pastrimin e shpirtit, për të ecur në rrugën e xhihadit dhe për të vazhduar përpjekjen me këmbëngulje.[1]

Unë e kam përmendur këtë pikë edhe në librin '*Roli i myslimanëve në lëvizjen çlirimtare të Indisë*'. Në të thuhet se një nga princat trashëgimtarë të Indisë, në vitin 1947, pra para pavarësisë së Indisë dhe në periudhën kur, pas sundimit të Kompanisë së Indisë Lindore, britanikët po planifikonin të merrnin plotësisht kontrollin e qeverisë indiane, kishte deklaruar: 'Problemi ynë

[1] Po aty, vëll. 8, f. 127.

kryesor sot janë myslimanët, dhe objektivi strategjik që synohet është shkatërrimi dhe zhdukja e tyre.'

Po ashtu, ju sigurisht e keni dëgjuar thënien e njohur të Gladstoneit, kur ai tha: 'Ky Kur'an duhet të zhduket.'

Kolonialistët kanë pasur gjithmonë të njëjtën ndjeshmëri dhe frikë ndaj Islamit, dhe kjo ishte pasojë e asaj që kishin parë nga fuqia e Islamit.

Nuk kaloi shumë kohë pas ngjarjeve të Lëvizjes së Duhanit (*Nehdetu't-Tembak*)[1] dhe zhvillimeve të tjera në Indi, Afganistan,

[1] Kur Nasiriddijn Shah, mbreti i dinastisë Kaxhare, udhëtoi për herë të tretë në Angli së bashku me Emijn El-Sultan, ai pati nevojë për disa mjete financiare gjatë atij udhëtimi. Për këtë arsye, politikanët britanikë vendosën t'i jepnin Shahut një hua, në mënyrë që në këmbim të përfitonin favore dhe privilegje për veten e tyre.

Për këtë detyrë u ngarkua Major Talbot, i cili ishte këshilltar dhe i afërt me (Salisbury), kryeministrin britanik. Ai u angazhua për të siguruar koncesionin e duhanit dhe të tabakut. Në vazhdim të kësaj detyre, Talbot themeloi kompaninë e njohur "Gray", dhe në vitin 1890 (përkatësisht 1307 h. hixhri kameri dhe 1267 sipas kalendarit Iranian, u nënshkrua marrëveshja midis Shahut të Iranit dhe qeverisë britanike. Teksti i saj ishte: 'Ne i kemi dorëzuar procesin e shitjes, blerjes dhe prodhimit të duhanit dhe tabakut iranian brenda dhe jashtë Iranit ekskluzivisht kompanisë së Major Talbot dhe ortakëve të tij, për një periudhë pesëdhjetë vjeçare nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.'

Shahu i Iranit Nasiriddijn Shah Kaxhar

E drejta e koncesionit në këtë marrëveshje ishte 15,000 lira sterlina në vit për 50 vjet, dhe askush nuk kishte të drejtë të merrej me tregtinë e duhanit dhe produkteve të tij pa lejen dhe autorizimin e kompanisë "Gray" dhe themeluesit të saj, Major Talbot.

Iran, Egjipt e vende të tjera, saqë arroganca dhe kolonializmi botëror filluan ta nënvlerësonin fuqinë e Islamit. Arsyeja ishte se për një periudhë të gjatë ata nuk kishin parë ndonjë lëvizje ose ringjallje të fuqishme islame; prandaj ranë në neglizhencë dhe iluzion.

Mirëpo, pas kalimit të disa dekadave në këtë gjendje, Revolucioni ynë triumfoi. Me këtë fitore, të gjitha analizat, njohuritë dhe strategjitë kolonialiste, të mbledhura gjatë shumë viteve, u përmbysën dhe u shkatërruan, sepse papritur panë se Islami kishte hyrë përsëri në skenë me të njëjtën forcë, madhështi dhe autoritet që dikur i kishte frikësuar, duke u shfaqur me vendosmëri të palëkundur dhe me një fuqi të jashtëzakonshme."[1]

Duhet të dënohen dhe të kundërshtohen me vendosmëri planet dhe komplotet e vjetra e të reja kolonialiste, të cilat armiqtë tanë i promovojnë për të ndarë fenë nga politika. Qëllimi i tyre është ta izolojnë Islamin dhe Kur'anin nga jeta e shoqërisë.

Për këtë arsye, Ajatullahu i Madh, Haxh Mirza Muhamed Hasan Shirazi, i njohur si "Mirza Sherazi i Madh" (ndërroi jetë në vitin 1312 h. kameri), autoriteti fetar kryesor i shiitëve në atë kohë që jetonte në Samarra (Irak), lëshoi fetvanë e tij të famshme në gjysmën e parë të muajit Xhumada El-Ula të vitit 1309 hixhri (muaji i nëntë i vitit 1270 sipas kalendarit iranian/ 1891). Teksti i saj ishte: 'Me emrin e Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Përdorimi i duhanit dhe tabakut, në çdo formë që të jetë, sot është i ndaluar dhe konsiderohet si luftë kundër Imamit të kohës (Huxhet ibn El-Hasan El-Askari (Paqja qoftë mbi të!).'

Pas kësaj fetvaje nga Mirza Shirazi i Madh dhe kundërshtimit të fortë të dijetarëve të mëdhenj në Iran, Nasiriddijn Shah u detyrua ta ndërpriste dhe anulonte marrëveshjen e përmendur me kolonialistët anglezë.

[1] I njëjti burim, "Hadithul-Uilajeh", vëll. 3, f. 50–51.

Prandaj, prania e fesë duhet të forcohet në të gjitha shoqëritë islame, në mënyrë që të përballet me politikat kolonialiste dhe arrogante. Kjo duhet të shërbejë si një mësim i përgjithshëm për të gjithë popujt myslimanë në përballjen me këto plane dhe komplote.[1]

Vëreni se si në Iran është ngritur një shtet i mbështetur mbi bazat e Kur'anit. Administrimi i tij mbështetet në një kushtetutë të frymëzuar nga Kur'ani, ndërsa të gjitha ligjet e tij krahasohen vazhdimisht me Sheriatin islam, pa asnjë përjashtim. Drejtimi i shoqërisë është në duart e dijetarëve dhe udhëheqësve fetarë. Ky shtet ecën përpara në rrugën e rezistencës, përpjekjes dhe rindërtimit dhe sfidon arrogancën botërore.

Ka pasur një periudhë kur ai përballej njëkohësisht me të dy blloqet, atë lindor dhe atë perëndimor, dhe arriti të përballojë tetë vite të Luftës së Imponuar. Prandaj, vetë ekzistenca e një shteti të tillë është e mjaftueshme për të ngjallur frikë te fuqitë arrogante të botës. Kështu kuptojmë arsyet pse armiqtë mbajnë qëndrime kaq armiqësore dhe organizojnë komplote të vazhdueshme kundër Revolucionit Islamik.[2]

Ju e keni parë dhe vazhdoni ta shihni se armiqtë hedhin kundër nesh akuza të pabaza, si shkelja e të drejtave të njeriut, kundërshtimi i të drejtave të njeriut, përdorimi i atentateve, terrorizmit dhe akuza të tjera të rreme, të cilat i përhapin ditë e natë, kudo dhe vazhdimisht.

---

[1] I njëjti burim, vëll. 5, f. 17.

[2] Fjalimi i udhëheqësit (Allahu e mëshiroftë!) në takimin e imamëve të xhumasë në vend, 20/6/1374 sipas kalendarit iranian, 9/9/1995.

Të gjitha këto përpjekje dashakeqe dhe kjo armiqësi e pandërprerë kanë vetëm një qëllim: të përpiqen t'i paraqesin këto akuza të pavërteta si të vërteta kundër nesh. Ndërkohë, ata vetë e dinë më mirë se kushdo tjetër se këto janë vetëm shpifje dhe trillime.

I gjithë ky propagandim synon ta largojë opinionin publik botëror nga sistemi i Republikës Islamike dhe të krijojë përçarje mes myslimanëve, në mënyrë që të mos krijohet asnjë lidhje dhe tërheqje ndërmjet kësaj kështjelle të Islamit dhe Kur'anit (në Iran) dhe shoqërive të tjera islame në mbarë botën.

Allahu i Madhëruar ua ka prishur planet dhe ua ka dështuar komplotet:

﴿إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا ۝ وَأَكِيدُ كَيْدًا﴾

"Ata po kurdisin plane, e edhe Unë po kurdis plan."[1]

Po ashtu:

﴿وَمَكَرُوا وَمَكَرَ اللَّهُ﴾

"Ata kurdisën plane, por edhe Allahu kurdisi planin e Tij."[2]

Gjatë gjithë këtyre viteve, Allahu i Madhëruar u ka dalë përballë, duke ua dështuar çdo komplot që kanë hartuar. Megjithatë, armiku vazhdon të na pengojë në rrugën tonë, të na

[1] Sure "Et-Tarik", ajetet 15-16.

[2] Sure "Ali Imran", ajeti 54.

vendosë pengesa, të krijojë kriza dhe vështirësi. Edhe pse shpesh përfundon në turp, dështim dhe poshtërim, ai nuk heq dorë nga veprimet e tij armiqësore.

Në dritën e kësaj përballjeje, myslimanët duhet të bashkohen. Pikërisht këtu kuptohet domethënia e vërtetë e unitetit islam dhe e solidaritetit ndërmjet myslimanëve.

Shikoni sa e rëndësishme dhe sa e ndjeshme është kjo çështje. Mendoni se sa vendimtare është ajo për të ardhmen e botës islame. Nuk është një çështje e thjeshtë që mund të neglizhohet apo të lihet pas dore. Çdokush duhet ta konsiderojë veten të përfshirë në këtë thirrje.

Unë u drejtohem të gjithëve: si myslimanëve sunitë, ashtu edhe shiitëve; shkrimtarëve, poetëve, botuesve, të gjithë atyre që merren me shtyp dhe botime, atyre që kanë ndikim te njerëzit, që flasin para masave dhe kanë dëgjues të shumtë. Të gjithë duhet ta kuptojnë këtë realitet, ta njohin armikun gjithnjë e më mirë dhe të jenë vigjilentë e të kujdesshëm, që armiku të mos depërtojë në radhët e tyre.

Jini të kujdesshëm që të mos detyroheni të sulmoni miqtë në vend të armiqve. Duhet ta njihni kohën në të cilën jetoni, të dini të dalloni armikun nga miku dhe të kuptoni fushën e betejës. Këto janë çështje me rëndësi shumë të madhe."[1]

Prej shumë vitesh ka pasur një luftë të pandërprerë për të penguar përhapjen dhe popullarizimin e Kur'anit në vendin tonë.

[1] Fjalimi i udhëheqësit të madh (Allahu e ruajtë!) me mysafirët e Konferencës së Unitetit Islam në Teheran, 1/5/1376 h. sh (23/7/1997.

Madje imagjinoni se ata kanë arritur deri në atë pikë sa ta bëjnë Kur'anin të braktisur dhe të harruar për vite të tëra. Më pas, qeveritë e mëparshme në Iran e hoqën dhe e fshinë mësimin e Kur'anit nga institucionet arsimore dhe më tej e kufizuan recitimin e Kur'anit në programet e radios dhe televizionit. Kush i bëri vallë këto vepra të ulëta?! Po, ata që kishin marrë pushtetin e vendit përmes forcës dhe ndikimit të të huajve ishin ata që i kryen këto veprime; pra regjimi monarkik Pahlavi, i korruptuar, kriminal dhe i zhytur në ndyrësi e papastërti. Qëllimi i tyre ishte që vendin, me të gjitha burimet njerëzore dhe pasuritë materiale, t'ua dorëzonin me dëshirë fuqive dominuese botërore. Ata ishin ata që planifikonin dhe zbatonin këto veprime, sepse e dinin se mësimet dhe idetë kur'anore dhe edukimi islam nuk i lejon tradhtarët të vazhdojnë veprimet e tyre kriminale pa pengesa dhe probleme; prandaj ata luftuan dhe u përballën me Kur'anin.[1]

Armiqësia e përgjithshme, kundërshtimi i gjerë dhe komplotet e programuara kundër Islamit datojnë që nga fillimi i kolonializmit. Kolonizatorët, në shekujt e fundit, i bënë vendet islame skenë të plaçkitjes, grabitjes, vrasjes dhe agresionit, dhe e shikonin Islamin si një pengesë të fortë që ndalonte ndezjen e trazirave dhe konflikteve.

Dhe nga këtu Islami u vu në shënjestër dhe u bë objekt i fushatave të ashpra politike dhe kulturore. Ata nisën zbatimin e planit të tyre djallëzor për të ndarë myslimanët nga Kur'ani dhe Islami, përmes metodave mashtruese dhe intrigave të holla, duke

[1] Takimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik me një grup hafizësh dhe recituesish të rinj të Kur'anit në vend, 28/6/1380 sipas kalendarit iranian, 19/9/2001.

përfshirë edhe përhapjen e korrupsionit moral, shthurjes dhe imoralitetit.

Pasi vullkani i Revolucionit Islamik ndezi zjarrin në fushat e shpresave dhe të ambicieve të kolonizatorëve dhe solli dritën e optimizmit dhe shpresës në zemrat e myslimanëve, duke paralajmëruar një jetë të re për Islamin në botë, atëherë fuqitë hegjemoniste sulmuan kështjellat e Islamit në mënyrë të përgjithshme, të befasishme dhe të çrregullt. Natyrisht, nuk pritej diçka tjetër përveç asaj që bënë.

Pa dyshim, ligjet e Allahut do të realizohen në lidhje me dështimin dhe poshtërimin e tyre, inshallah, sepse Kur'ani thotë:

﴿وَلاَ يَزَالُ الَّذِينَ كَفَرُواْ تُصِيبُهُم بِمَا صَنَعُواْ قَارِعَةٌ﴾

"Dhe ata që nuk besuan vazhdimisht do t'i godasë një fatkeqësi për atë që kanë bërë…"[1]

Me kusht që besimtarët të jenë të vetëDitur dhe të përkushtuar ndaj detyrave dhe detyrimeve të tyre përballë këtyre komploteve dhe të mos i neglizhojnë ato as edhe për një çast të vetëm.[2]

[1] Sure "Err-Rra'd", ajeti 31.

[2] Cituar nga libri (Hadithul-Uilajeh), vëll. 1, f. 223.

1 - Zyrtarët shtetërorë dhe institucionet e sistemit të Republikës Islamike

Nëse do të vihet theksi mbi mësimin e Kur'anit në shkolla, përmes programeve mësimore dhe gjatë viteve të fëmijërisë, adoleshencës dhe rinisë, atëherë ekziston shpresa që kjo të sjellë një arritje të madhe.

Për shembull, në fushën e mësimit përmendsh të Kur'anit, nëse kjo realizohet duke dhënë pikë pozitive si shpërblim për notat dhe vlerësimet e mira e të ngjashme me to, atëherë në këtë mënyrë mund të ndihmojmë në zhvillimin e brezit të ri në shkolla.

Natyrisht, është më mirë që mësimi përmendsh i Kur'anit të mos bëhet përmes një programi të veçantë ose një kurrikule të shkruar, sepse tashmë ka lëndë që tejkalojnë orët e zakonshme mësimore, dhe për këtë arsye, nëse programi i mësimit të Kur'anit vendoset si një lëndë e strukturuar brenda kurrikulës, mund të krijojë probleme të shumta për nxënësit dhe gjithashtu për ju, pra për ata që janë përgjegjës për mësimin e Kur'anit në Ministrinë e Arsimit."[1]

2 - Dijetarët e hauzave shkencore, klerikët dhe predikuesit

Ne ende jemi larg shoqërisë islame të vërtetë dhe të pastër, e cila garanton lumturinë e njerëzve në këtë botë dhe në Botën Tjetër në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse, përmes zhdukjes dhe

[1] I njëjti burim, vëll. 3, f. 328–329.

rrënjosjes së korrupsionit, devijimit, padrejtësisë dhe degradimit moral.

Në të vërtetë, mes nesh dhe asaj shoqërie ideale ekziston një hendek i madh. Për ta kaluar këtë distancë dhe për ta mbyllur këtë boshllëk, kemi nevojë për vendosmëri të prerë dhe vendim të fortë nga populli, si dhe për përpjekje të vazhdueshme dhe serioze nga ana e përgjegjësve.

Kjo nuk mund të realizohet veçse përmes përhapjes së çështjes së urdhërimit për të mirën dhe ndalimit nga e keqja.

Xhamitë dhe faltoret, si qendra shpirtërore të pastrimit dhe udhëzimit në rrugën e drejtë, duhet të bëhen gjithnjë e më të gjalla dhe më të fuqishme nga dita në ditë.

Gjithashtu, dukuria e besimit, veprave të mira dhe moralit islam duhet të përhapet në të gjitha pjesët e shoqërisë, në qendrat dhe institucionet shtetërore, në universitete, dhe të inkurajojë të gjithë që të ndjekin mësimet ndriçuese të Kur'anit.

Në këtë mënyrë, Libri i Zotit do të zërë vendin e tij të vërtetë mes njerëzve, dhe mësimi, meditimi dhe studimi i tij do të bëhen një praktikë e zakonshme dhe e përhapur për të gjithë, veçanërisht për të rinjtë dhe brezin e ri. Në këtë fushë, përgjegjësia e dijetarëve, intelektualëve, shkrimtarëve, predikuesve dhe mediave publike është jashtëzakonisht e madhe dhe serioze."[1]

Arsyeja e vetme dhe faktori i veçantë që mund ta shpëtojë njerëzimin, dhe forca e madhe dhe gjigante që do të sjellë një

[1] I njëjti burim, vëll. 3, f. 329.

mrekulli në shoqëri për ta çliruar njerëzimin, është Islami i vërtetë dhe i pastër, Kur'ani Famëlartë dhe ligjet e Allahut.

Në të vërtetë, njerëzimi sot është i zhytur mes vështirësive dhe mjerimit, dhe shumica e popujve të botës u janë shkelur të drejtat, ndërsa pjesa më e madhe e të mirave dhe pasurive të tokës është monopolizuar nga të ligjtë dhe padrejtësit, ndërsa drejtësia mungon në sipërfaqen e tokës.

Më e keqja nga të gjitha është moszbatimi i drejtësisë dhe barazisë, si dhe mungesa e vetëdijes dhe ndjeshmërisë për këtë mungesë drejtësie.

Më e rëndësishmja është se nuk ka askush në botë që ta njohë këtë shpëtimtar të njerëzimit të humbur dhe të mjeruar, që është Islami, Kur'ani dhe ligjet e Allahut. Në fakt, Islami, siç kuptohet nga këndvështrimi i Kur'anit dhe nga analiza historike, duhet të jetë shpëtimtari i popujve nga devijimi dhe mjerimi.[1]

Detyra dhe përgjegjësia kryesore e klerikëve është udhëzimi i njerëzve drejt qëllimeve që i ka përcaktuar Kur'ani të Shenjtë dhe profetët gjatë gjithë historisë së profetësisë.

Mjeti efektiv që ata përdornin ishte paralajmërimi (inkurajimi dhe frikësimi nga e vërteta):

﴿لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا﴾

[1] I njëjti burim, vëll. 5, f. 287.

"Që të jetë paralajmërues për botët"[1]

dhe gjithashtu:

﴿أَنْ أَنذِرْ قَوْمَكَ﴾

"Paralajmëro popullin tënd"[2]

dhe po ashtu:

﴿أَنذِرْهُمْ يَوْمَ الْحَسْرَةِ﴾

"Paralajmëroji për Ditën e Pendimit dhe të keqardhjes"[3]

Po, është paralajmërimi dhe frikësimi (nga pasojat e së keqes).

Ne, klerikët, jemi sot në pozitën e atij që dëshiron të ruajë trashëgiminë e lartë dhe të lavdishme të dijetarëve fetarë gjatë mijëvjeçarëve, dhe të vazhdojë udhëzimin e njerëzve.

Prandaj duhet të përpiqemi për të lëvizur zemrat, për të ndriçuar mendjet, për të korrigjuar rrugët, për të pastruar veprat, për të ndryshuar ndërgjegjet dhe shpirtrat e njerëzve, dhe për t'i çuar ata drejt besimit të vërtetë dhe moralit të lartë islam.

Kjo është përgjegjësia jonë kryesore dhe ky është "paralajmërimi", dhe ky qëllim i madh do të realizohet përmes paralajmërimit, inshallah.

---

[1] Sure "El-Furkan", ajeti 1.

[2] Sure "Nuh", ajeti 1.

[3] Sure "Merjem", ajeti 39.

Nëse njerëzit ndryshojnë, edhe bota do të ndryshojë. Nëse ndodh ky ndryshim i madh te masat, atëherë kjo lëvizje dhe kjo ringjallje do të mbetet e përjetshme dhe e vazhdueshme përgjithmonë.

Nëse njerëzit pajisen me moralin islam dhe kur'anor, atëherë do të realizohen të gjitha premtimet e Kur'anit në lidhje me këtë rrugë të drejtë, dhe kjo lëvizje dhe kjo ringjallje hyjnore do të vazhdojë derisa të arrijë qëllimet e saj përfundimtare dhe objektivat e saj të larta. Si dhe me çfarë mund të realizohet kjo vallë?! Po, kjo mund të realizohet me njerëz besimtarë."[1]

Ne nuk duhet t'u lejojmë atyre që nuk dinë asgjë për Islamin, madje janë armiqtë më të ashpër të tij, të flasin pa baza në çështjet e hallallit dhe haramit në fenë e Zotit, si dhe të komentojnë, interpretojnë apo deformojnë parimet islame dhe Kur'anin sipas dëshirave të tyre tokësore dhe interesave personale, në kundërshtim me rrugën madhështore të Islamit dhe Kur'anit.

Nëse e kryejmë këtë detyrë në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe do ta bëjmë, inshallah, dhe nëse përballemi me këta njerëz, atëherë flamuri i Islamit të dashur do të valëvitet për shpëtimin dhe çlirimin e njerëzimit në hapësira të gjera të botës.[2]

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilajeh", vëll. 6, f. 305.

[2] I njëjti burim, vëll. 8, f. 256.

3 - Recituesit e Kur'anit dhe mësuesit në këtë fushë

Ajo që ju po bëni nga përpjekjet dhe angazhimet në fushën e Kur'anit nuk është ende e mjaftueshme. Përpiquni të përfitoni nga mësuesit në këtë drejtim, dhe më pas shtoni bashkëpunimin tuaj me recituesit e vjetër me përvojë. Gjithashtu, duhet t'i kushtoni rëndësi mësimit, kuptimit dhe mësimit përmendsh të Kur'anit për fëmijët dhe brezin e ri."[1]

Të dashurit e mi! Recitues të Kur'anit! O rinia jonë revolucionare dhe o ju me zemra të pastra dhe ndërgjegje të ndritshme! Forconi lidhjen tuaj me Kur'anin gjithnjë e më shumë çdo ditë; shpërndani aromën e Kur'anit në atmosferën e familjeve dhe shtëpive; lexoni dhe lexoni Kur'anin dhe meditojeni atë thellë.

Armiqtë nuk e duan që myslimanët t'i ngrenë ajetet kur'anore si një flamur që valëvitet lart, sepse Kur'ani i zgjidh të gjitha çështjet dhe përcakton të gjitha detyrimet e myslimanëve: detyrën e xhihadit dhe mënyrën e jetës dhe vdekjes islame."[2]

Natyrisht, nëse duam të përhapim dhe të bëjmë të zakonshme një formë apo një traditë në një shoqëri, dhe u bëj thirrje atyre që ende nuk janë bindur plotësisht për urtësinë dhe filozofinë e këtyre recitimeve dhe inkurajimeve, që t'i kushtojnë vëmendje kësaj pike, atëherë duhet të kemi personalitete të shquara dhe individë gjenialë që kanë arritur majat në shoqëri.

Përndryshe, procesi i përhapjes së asaj forme apo zakoni nuk do të plotësohet. Ju nuk mund t'u kërkoni të gjithë njerëzve të bëjnë,

[1] I njëjti burim, vëll. 3, f. 83.

[2] I njëjti burim, vëll. 8, f. 274.

për shembull, ushtrime të lehta fizike për 10 minuta në ditë për fleksibilitetin e trupit, pa e inkurajuar më parë vetë sportin në mënyrë të fuqishme dhe tërheqëse.

E si do të ishte nëse këtë lloj aktiviteti do ta hiqnit plotësisht nga shoqëria? Atëherë nuk mund të pritet as rezultat pozitiv dhe as sukses i rëndësishëm. Njerëzit nuk do të ushtrohen në këtë mënyrë.

Lëvizja e përgjithshme e një kombi nuk mbështetet vetëm mbi argumentin, arsyen dhe sqarimin racional, por ka nevojë edhe për gjëra të tjera: ndjenja, emocione të fuqishme, inkurajim të vazhdueshëm dhe krijim të një atmosfere entuziaste.

Të gjitha këto duhet të jenë të pranishme për të arritur ngritjen dhe ngjitjen drejt majave të larta.

Në këtë bazë, duhet të kemi këto figura të mëdha në fusha të ndryshme, në mënyrë që njerëzit të mund të arrijnë majat.

Edhe në këtë fushë, nëse duam që njerëzit të fluturojnë lart në atmosferën e Kur'anit, duhet të kemi njerëz që vetë e kanë përjetuar këtë ngritje dhe kanë arritur majën.

Edhe ju vetë, disa prej jush kanë recituar këtu, ndërsa të tjerëve nuk u është dhënë mundësia të lexojnë. Falënderojmë Allahun për këtë dhuratë dhe begati. Unë personalisht i njoh nga afër të gjithë vëllezërit këtu, madje edhe ata që nuk kanë recituar, sepse më parë jam njohur me recitimin dhe zërin e tyre.

Falënderojmë Allahun për bollëkun e kësaj mirësie në shoqërinë tonë."[1]

Prandaj, nëse duam që i gjithë ymeti të afrohet me Kur'anin, duhet ta përhapim recitimin e Kur'anit në shoqëri. Pikërisht kjo është arsyeja pse unë gjithmonë theksoj leximin dhe recitimin tuaj, o të dashur recitues, dhe i kushtoj shumë rëndësi kësaj çështjeje.

Secili prej jush është një individ që lexon Kur'anin. Dhe sa më shumë që ky individ përpiqet ta bëjë leximin e tij të bukur e të mirë, apo përkundrazi nuk përpiqet në këtë rrugë, kjo lidhet me të vetë. Por ajo që më shtyn mua të interesohem kaq shumë për këtë çështje është se recituesit e Kur'anit, nëse arrijnë t'i lexojnë ajetet hyjnore me melodi shpirtërore, në mënyrë të saktë, të rrjedhshme dhe të mbushur me bukuri e tërheqje, atëherë zemrat e njerëzve do të anojnë drejt Kur'anit dhe do të ndiejnë afërsi dhe tërheqje më të madhe ndaj tij, dhe lidhja e tyre me Kur'anin do të thellohet.

Sidomos populli ynë është i përgatitur për një afërsi të tillë, sepse është një popull që në këtë fushë dallon nga popujt e tjerë myslimanë. Ka luftuar me sinqeritet dhe përkushtim në rrugën e Kur'anit dhe kjo nuk ka qenë lojë apo shaka, pasi kemi dhënë shumë të rinj si dëshmorë dhe populli ynë ka vuajtur shumë gjatë viteve të gjata, dhe e gjithë kjo ka qenë në emër të Kur'anit dhe Islamit.[2]

Islami ende nuk ka pasur mundësinë të formojë një qeveri islame në mënyrë praktike në shoqëritë myslimane. Domethënë,

[1] I njëjti burim, vëll. 4, f. 70.

[2] I njëjti burim, vëll. 7, f. 33–34.

nuk ka pasur zbatim të vërtetë të dispozitave islame, nuk ka pasur tatime dhe llogaridhënie financiare islame, dhe nuk është zhvilluar një kulturë e vërtetë islame që të përhapet dhe promovohet.

Po ashtu, sundimtarët që ndodhen sot në krye të qeverive nuk janë zgjedhur sipas kritereve islame. Përkundrazi, shumë prej tyre janë të prishur dhe të degjeneruar, të cilët Kur'ani i refuzon.

A thua vallë, popujt e këtyre vendeve e dinë se jetojnë nën një sistem jo-islam? A nuk ka Kur'ani një qëndrim të veçantë për këtë çështje? Kush është përgjegjës për t'ua përcjellë këtë të vërtetë popujve dhe masave myslimane?

Sipas mendimit tim, recituesit e Kur'anit janë ata që duhet të marrin përparësi në shpjegimin dhe paraqitjen e këtyre çështjeve, sepse Allahu i Madhëruar u ka ngarkuar atyre këtë përgjegjësi të madhe dhe këtë nder të madh. Po, kjo është porosia ime për vëllezërit recitues.[1]

4 – Studiuesit, shkrimtarët, predikuesit dhe mediat publike

Pritet nga ju që të mësoni artin sipas kritereve islame, pastaj ta mësoni dhe ta përdorni atë, në mënyrë që të mund të shfaqni dhe paraqisni para njerëzve konceptet dhe vlerat hyjnore dhe islame. Bota e sotme ka një nevojë të madhe për të vërtetat islame. Popujt e botës sot kanë nevojë të shohin atë diell të ndritshëm në hapësirën e koncepteve të Kur'anit dhe njohurive kur'anore.[2]

[1] I njëjti burim, vëll. 7, f. 142.

[2] I njëjti burim, vëll. 8, f. 178.

Rishikimi i Kur'anit fisnik dhe i hadhitheve të shenjta nga studiuesit dhe hulumtuesit është një domosdoshmëri e ngutshme në kuadër të sovranitetit dhe gjithëpërfshirjes së Islamit si fe që thërret drejt një jete më të mirë. Prandaj të gjithë kanë nevojë të madhe për të.[1]

5 – Populli dhe rinia

Porosia ime për të gjitha familjet dhe të gjitha shtresat e popullit, veçanërisht për të rinjtë, është që të kujdesen për namazin, të frekuentojnë xhamitë, të praktikojnë çështjet e adhurimit dhe të marrin pjesë në tubimet kur'anore.

Ajo që kemi fituar sot në këtë vend nga madhështia, krenaria dhe fuqia, në të vërtetë nuk e kemi arritur veçse falë Kur'anit fisnik, nën hijen e gjerë të Islamit dhe përmes përkushtimit në ruajtjen e namazit, adhurimit dhe përmendjes së shpeshtë të Allahut të Madhëruar.

Prandaj, duhet të kujdeseni nga njëra anë për studimin dhe jetën praktike, dhe nga ana tjetër për adhurimin dhe fenë, sepse përkushtimi fetar garanton vazhdimësinë e të gjitha këtyre gjërave. Duhet të krijoni afërsi dhe dashuri me namazin, me xhamitë, me adhurimet dhe me tubimet fetare e kur'anore.[2]

Marrëdhënia juaj me Allahun e Madhëruar duhet të jetë e fortë dhe e veçantë. Falni namazin me vetëdije mendore dhe prani

[1] I njëjti burim, vëll. 4, f. 33.

[2] I njëjti burim, vëll. 8, f. 140.

të zemrës, kujdesuni për namazet nafile dhe përpiquni të lexoni Kur'an sa të mundeni çdo ditë.

Bëni që të mos kalojë asnjë ditë pa e lexuar Kur'anin, qoftë edhe dhjetë apo pesë ajete, me mendim dhe meditim, sepse kjo do t'ju ndriçojë zemrat.

Le t'i lëmë mënjanë ato pritje të gabuara që thonë: nëse falim disa nafile gjatë natës, do të kemi patjetër një fitore të madhe në mëngjes! Jo, çështja nuk është kështu.

Lidhja me Allahun, siç vjen në lutjet tona, është qëllimi përfundimtar dhe një realitet i qëndrueshëm. Allahu i Madhëruar u kushton vëmendje të veçantë atyre që i drejtohen Atij me përulje dhe lutje. Po, përulja dhe lutja përmbajnë këto cilësi dhe veçori.[1]

Siç na ka premtuar Allahu i Madhëruar në Kur'anin e Shenjtë, përderisa besimi i fortë islam i shoqëron njerëzit, populli dhe revolucioni nuk do të përballen me asnjë rrezik apo kërcënim, dhe fuqitë e mëdha nuk do të mund t'i shkaktojnë as goditjen më të vogël apo t'i sjellin ndonjë dëm Republikës Islamike dhe revolucionit islamik të lavdishëm në Iran.[2]

Kujdesuni për ruajtjen e shpirtit të unitetit, entuziazmit dhe ndjenjës së detyrës, sepse Kur'ani u drejtohet myslimanëve dhe thotë:

---

[1] Në një fjalë të Udhëheqësit të Revolucionit (Allahu e mëshiroftë!) gjatë takimit me Presidentin dhe Këshillin e Ministrave me rastin e Javës së Qeverisë, 2/6/1376 sipas kalendarit iranian, 24/8/1997.

[2] Po aty, vëll. 1, f. 234.

﴿وَلاَ تَهِنُوا وَلاَ تَحْزَنُوا وَأَنتُمُ الأَعْلَوْنَ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ﴾

"Mos u dobësoni dhe mos u pikëlloni, ndërsa ju jeni më të lartët nëse jeni besimtarë"[1]

Simboli i besimit është ky entuziazëm, kjo gjallëri, kjo solidaritet dhe kjo prani në arenën shoqërore që ekziston sot mes njerëzve. Armiqtë frikësohen pikërisht nga këto cilësi. Për sa kohë që ju vazhdoni praninë tuaj aktive, të fortë dhe plot entuziazëm, përfshirë do t'ju mbulojnë kujdesi dhe mëshira hyjnore, inshallah.[2]

Të gjitha premtimet e Allahut deri më tani kanë rezultuar të sakta dhe janë realizuar plotësisht. Çdo analizë që është bazuar në ajete të qarta të Kur'anit është realizuar dhe është vërtetuar si e saktë.

Deri më sot kemi parë qartë dhe në mënyrë praktike se një popull besimtar dhe i bindur në Allahun e Madhëruar, nëse reziston dhe duron, nuk do të mposhtet, edhe nëse e gjithë bota i kundërvihet dhe e lufton.

Ne e kemi provuar dhe përjetuar këtë realisht. E thoshim këtë para fitores së revolucionit, në fillimet e tij dhe gjatë dekadës së kaluar, duke e përsëritur gjithmonë këtë premtim kur'anor, por ngjarjet dhe zhvillimet e kanë vërtetuar këtë realitet në mënyrë të prekshme dhe të qartë.[3]

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 139.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 1, f. 256.

[3] Po aty, vëll. 5, f. 162–163.

Allahu i Madhëruar na ka premtuar në shumë ajete të Kur'anit fisnik se do ta ruajë fenë e Tij, fenë e së vërtetës, përballë të gjitha pengesave, armiqësive, zilisë dhe urrejtjeve që armiqtë i planifikojnë gjatë gjithë kohërave.

Ky ajet i bekuar në suren "Es-Saff" është një nga këto premtime në këtë drejtim:

﴿يُرِيدُونَ لِيُطْفِئُوا نُورَ اللَّهِ بِأَفْوَاهِهِمْ وَاللَّهُ مُتِمُّ نُورِهِ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ﴾

"Dëshirojnë ta shuajnë dritën e Allahut me gojët e tyre, por Allahu do ta plotësojë dritën e Tij, edhe nëse jobesimtarët e urrejnë."[1]

Në këtë ajet të bekuar, "rruga e Allahut" dhe "feja e Allahut" janë përshkruar si dritë, madje, si vetë Drita e Allahut të Madhëruar. Po, ajo është Drita e Allahut, sepse i atribuohet Krijuesit të Lartësuar, dhe natyrisht ajo është më e fuqishme se çdo dritë tjetër që njeriu mund ta imagjinojë, si drita e diellit, e planetëve dhe dritat e tjera, edhe nëse do të ishin më të forta se të gjitha këto.

Është një dritë absolute dhe e pakufishme.

Pastaj ajeti e përshkruan kundërshtimin e armiqve si një fryrje që del nga goja, si dikush që përpiqet të shuajë një qiri apo një llambë të vogël.

Kështu, drita e Allahut është më e fortë se çdo dritë që njeriu mund të imagjinojë. Prandaj, nëse dikush pretendon se mund të

[1] Sure "Es-Saff", ajeti 8.

shuajë dritën e diellit me frymën e tij të dobët që del nga goja, një pretendim i tillë do të pritej me tallje dhe përqeshje nga mendja e shëndoshë dhe ai do të konsiderohej i marrë dhe naiv. Atëherë si mund të drejtohet një pretendim i tillë ndaj dritës së Allahut të Madhëruar?

Në pjesën tjetër të këtij ajeti të bekuar thuhet:

﴿هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَلَوْ كَرِهَ الْمُشْرِكُونَ﴾

"Ai është që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhëzim dhe fenë e së vërtetës, për ta bërë atë mbizotëruese mbi të gjitha fetë, edhe nëse idhujtarët e urrejnë."[1]

Pika që dua të theksoj këtu në këtë ajet të shenjtë është se ajeti thotë që Allahu i Madhëruar ka vendosur përhapjen dhe epërsinë e fesë së Tij, fesë së së vërtetës, rrugës së drejtë dhe rrugës hyjnore, mbi të gjitha fetë dhe sistemet e tjera njerëzore, mbi të gjitha shkollat e mendimit që janë në dispozicion të mendjes njerëzore.

Këto sisteme ose janë në rrugë të gabuar dhe devijim, ose kanë qenë të vërteta në një kohë të caktuar, por më pas janë deformuar dhe bërë të pavërteta për shkak të ndërhyrjeve dhe shtrembërimeve.

Në këtë mënyrë, feja e Allahut do të mbizotërojë mbi të gjitha fetë e tjera, pra mbi të gjitha kulturat njerëzore, sistemet ekonomike, sistemet politike dhe mënyrat e jetesës që nuk pranohen.

[1] Sure "Es-Saff", ajeti 9.

Në fund, të gjitha këto fe dhe shkolla njerëzore do të mposhten përballë rrugës së vetme të Allahut.

Le të bëjnë "raunde" sipas kërkesave të përpjekjeve të pasuesve të së pavërtetës dhe dobësisë së pasuesve të së vërtetës, por në fund do të jetë feja e Allahut ajo që do të triumfojë dhe Islami do të përhapet në të gjithë botën, dhe të gjithë njerëzit do të përfitojnë nga kjo fe e vlefshme. Ky është kuptimi i këtij ajeti të shenjtë.

Por pyetja që lind këtu është: Si do të arrihet ky dominim i fesë së Allahut në tokë? A do të realizohet kjo përmes shpatës, forcës dhe pushtetit ushtarak e politik?

Pa dyshim, jo. Nuk është një privilegj i veçantë që një fe ose një sistem mendimi të imponojë sundimin e tij mbi vendet e pushtuara dhe t'i detyrojë njerëzit ta pranojnë atë me forcë. Edhe sistemet e gabuara mund ta bëjnë këtë.

Siç ka ndodhur në disa vende gjatë shekullit të njëzetë, kur ideologjia marksiste dhe mënyra e jetesës komuniste iu imponua shumë popujve dhe u detyruan të ndjekin atë sistem.

Por feja e Allahut nuk e pranon këtë mënyrë imponimi mbi popujt e botës.

Feja e Allahut pushton zemrat, jo me shpatë dhe detyrim, sepse zemra nuk mund të fitohet në këtë mënyrë. Zemra duhet të kuptojë, të perceptojë dhe pastaj të pranojë me vullnet, dëshirë dhe dashuri.

Atëherë njeriu përfiton nga frytet dhe dobitë e kësaj besimi dhe kësaj feje. Natyrisht, kjo nuk arrihet me forcë dhe me shpatë – jo – sepse Islami nuk ka kërkuar kurrë një gjë të tillë.

Armiqtë e Allahut dhe armiqtë e Islamit, gjatë periudhave të ndryshme, kanë thënë shumë gjëra dhe kanë ngritur pretendime të rreme në këtë drejtim. Ne nuk do të ndalemi këtu në ato fjalë të pavërteta.

Disa prej tyre kanë pretenduar se Islami e ka pushtuar botën me forcë dhe me shpatë. Ndërsa një grup tjetër ka ardhur me një teori të kundërt, duke thënë se Islami nuk ka pasur fare forcë dhe shpatë.

Të dyja këto teori janë gabime të rënda, dhe secila prej tyre ka nevojë për studime dhe analiza të thelluara. Unë nuk dua të hyj tani në këtë diskutim.

Por fjala ime në këtë moment përqendrohet në një çështje tjetër, e cila është shumë e rëndësishme për popullin tonë, vendin tonë dhe përgjegjësitë tona.

Prandaj duhet të thuhet se feja e Allahut dhe Islami, nëse pretendon se do të shtrijë ndikimin e tij mbi të gjitha mënyrat e jetesës, mbi të gjitha sistemet politike dhe qeveritare ekzistuese, si dhe mbi të gjitha shkollat shoqërore dhe kulturat e ndryshme të njerëzimit, kjo nuk do të thotë se Islami do t'i pushtojë këto me forcë të shpatës.

Nëse nuk është me shpatë, atëherë me çfarë do të realizohet kjo? Kjo është pika kryesore e pyetjes.

Po, Islami ka dy mjete, përveç shpatës, dhe përmes këtyre dy mjeteve ai mund të fitojë mbi të gjitha fetë dhe shkollat e tjera në botë, dhe të tërheqë zemrat dhe ndjenjat drejt fesë së drejtë, si dhe të rrëzojë argumentet boshe dhe logjikën e rreme.

Cilat janë këto mjete?

Mjeti i parë është se Islami posedon argument të fortë dhe dëshmi bindëse.

Mjeti i dytë është drejtësia, me të gjitha kuptimet e saj, në mënyrë të vërtetë, gjithëpërfshirëse dhe absolute. Këto dy mjete përdoren për suksesin dhe përparimin e Islamit.[1]

Sot, në hytben e parë të namazit, dua t'ju flas shkurtimisht për premtimet e Allahut në pranimin e lutjes (*duas*ë).

Siç e dini, lutja në muajin e Ramazanit është një çështje e theksuar dhe e sigurt. Lutja e afron njeriun me Krijuesin dhe Zotin e tij; ajo ndikon në thellimin dhe forcimin e njohurive fetare në zemër dhe në përforcimin e besimit.

Përveç kësaj, lutja është kërkesë drejtuar Allahut të Madhëruar, dhe, inshaAllah, ajo pranohet dhe realizohen kërkesat e njeriut. Pra, lutja përmban shumë të mira dhe begati nga shumë aspekte.

[1] Fjalim i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik (Allahu e mëshiroftë!), në oborrin e Shenjtë të Mauzoleut të Imam Ridait (Paqja qoftë mbi të!), në qytetin e shenjtë të Meshhedit, 1/1/1376 sipas kalendarit iranian, (21/3/1997).

Prandaj shohim se Kur'ani i Shenjtë i ka trajtuar lutjet që kanë bërë robtë e mirë të Allahut, dhe e gjithë kjo është për të marrë mësim dhe këshillë.

Profetët (Paqja qoftë mbi ta!) në kohë dhe rrethana të vështira i drejtoheshin lutjes dhe kërkonin ndihmën e Allahut të Madhëruar:

﴿فَدَعَا رَبَّهُ أَنِّي مَغْلُوبٌ فَانتَصِرْ﴾

"Dhe ai iu lut Zotit të tij: 'Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!'"[1]

Kjo është thënia e profetit Nuh (Paqja qoftë mbi të!).

Siç është përmendur edhe në rastin e profetit Musa (Paqja qoftë mbi të!):

﴿فَدَعَا رَبَّهُ أَنَّ هَؤُلَاءِ قَوْمٌ مُّجْرِمُونَ﴾

"Dhe ai iu lut Zotit të tij: 'Këta janë një popull kriminel.'"[2]

Ai ia parashtroi gjendjen e tij Allahut të Madhëruar dhe u mbështet tek Ai për ndihmë.

Allahu i Lartësuar ka premtuar në shumë ajete të Kur'anit se do t'u përgjigjet lutjeve të robërve të Tij. Prej tyre është edhe ky ajet i bekuar që thotë:

[1] Sure "El-Kamer", ajeti 10.

[2] Sure "Ed-Duhan", ajeti 22.

﴿وَقَالَ رَبُّكُمُ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ﴾

"Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë do t'ju përgjigjem."[1]

Megjithatë, përgjigjja nuk është gjithmonë e menjëhershme dhe nuk nënkupton realizimin e kërkesës në mënyrë absolute në çdo rast. Ndonjëherë ekzistojnë ligje dhe rregulla në ekzistencë që e bëjnë të pamundur që Allahu i Lartësuar ta plotësojë menjëherë atë nevojë, sepse ka disa ligje natyrore ose shoqërore që e pengojnë realizimin e shpejtë të asaj lutjeje, ose që e bëjnë të pamundur që ajo të plotësohet menjëherë.

Në raste të tjera, përgjithësisht përgjigjja e Allahut është pozitive dhe lutja pranohet dhe nevoja plotësohet. Në këtë kuptim, imam Ali ibn Hysejn Zejnul Abidijn (Paqja qoftë mbi të!), në lutjen e tij të njohur si lutja e Ebu Hamza Themalit, e cila zakonisht lexohet në syfyrët e muajit Ramazan, i referohet pikërisht kësaj çështjeje, duke përmendur këtë ajet:

﴿وَاسْأَلُوا اللهَ مِن فَضْلِهِ إِنَّ اللهَ كَانَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا﴾

"Dhe kërkoni prej Allahut nga mirësia e Tij; vërtet Allahu është i Ditur për çdo gjë."[2]

Është e vërtetë që Allahu i di të gjitha nevojat dhe kërkesat tuaja, por megjithatë ju duhet t'i luteni Atij dhe të kërkoni prej Tij.

[1] Sure "Gafir" (El-Mu'min), ajeti 60.

[2] Sure "En-Nisa", ajeti 32.

Për këtë arsye shohim se Imami (Paqja qoftë mbi të!) e përmend këtë ajet në lutje.

Më pas imami (Paqja qoftë mbi të!) thotë: *"Nuk është prej cilësive të Tua, o Zot, që të urdhërosh të kërkohet dhe pastaj ta ndalosh dhënien."* Kjo do të thotë se bujaria e Allahut, mëshira dhe fuqia e Tij gjithëpërfshirëse kërkojnë përgjigje dhe realizim. Kur Krijuesi i Lartësuar thotë: "Më thirrni", kjo nënkupton se Ai ka dëshiruar që të plotësojë atë nevojë për ty.

Kjo përfaqëson plotësisht premtimet e Allahut që u përmendën në fillim të hytbes dhe e sqarojnë çështjen në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë:

﴿وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ﴾

"Dhe kur robtë e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër; i përgjigjem lutjes së lutësit kur Ai Më lutet."[1]

Po, kushdo që i lutet Allahut, do të marrë përgjigje. Siç thuhet në lutje: "Për çdo kërkesë drejtuar Teje, ka një dëgjim të pranishëm dhe një përgjigje të gatshme."

Pra, për çdo lutje ka një përgjigje të sigurt. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe besimtarët duhet ta vlerësojnë thellësisht këtë mirësi të Allahut. Natyrisht, nga kjo pozitë dhe nga kjo përkujdesje e Allahut nuk përfiton ai që nuk beson në Të, ashtu siç ndodh edhe me shumë mundësi e mirësi të tjera.

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 186.

Premtimet e Allahut janë të vërteta dhe të prera. Ai ka premtuar se do t'u përgjigjet nevojave të robve të Tij, por çdo premtim ka kushtet dhe rrethanat e veta.

Kam nxjerrë shumë ajete që flasin për premtimet e Allahut, por nuk dua të ndalem gjatë në këtë temë. Mjafton të përmend disa prej tyre:

Allahu i Madhëruar premton në shumë fusha të ndryshme. Njëri prej këtyre premtimeve është pranimi i lutjes, për të cilin folëm më sipër. Një premtim tjetër është fjala e Tij:

﴿مَنْ عَمِلَ صَالِحًا فَلِنَفْسِهِ وَمَنْ أَسَاءَ فَعَلَيْهَا﴾

"Kush bën vepra të mira, i bën për dobi të vetes, e kush bën keq, e ka kundër vetes."[1]

Po ashtu Ai thotë:

﴿إِنَّا لَا نُضِيعُ أَجْرَ مَنْ أَحْسَنَ عَمَلًا﴾

"Ne nuk e humbim shpërblimin e atij që vepron mirë."[2]

Njeriu nuk e merr shpërblimin vetëm në këtë botë, por do ta gjejë atë ose në këtë jetë, ose në Jetën Tjetër, e shpeshherë në të dyja.

Një premtim tjetër i Allahut është:

[1] Sure "Fussilet", ajeti 46.

[2] Sure "El-Kehf", ajeti 30.

﴿مَنْ كَانَ يُرِيدُ الْعَاجِلَةَ عَجَّلْنَا لَهُ فِيهَا مَا نَشَاءُ لِمَنْ نُرِيدُ﴾

"Kush dëshiron jetën e kësaj bote, Ne i japim shpejt prej saj çfarë të duam, kujt të duam."[1]

Domethënë, ai që synon vetëm të mirat e kësaj bote dhe e lë mënjanë Ahiretin, Allahu mund t'ia lehtësojë arritjen e synimeve të tij. Natyrisht, edhe kjo ka kushtet e saj: "çfarë të duam, kujt të duam."

Nëse njeriu punon me përkushtim dhe përpiqet seriozisht, ai mund të arrijë qëllimet e veta. Edhe sot shohim se disa popuj, falë punës, durimit, sakrificës dhe jetës së thjeshtë, kanë arritur zhvillim dhe përparim.

Më pas Kur'ani vazhdon:

﴿وَمَنْ أَرَادَ الْآخِرَةَ وَسَعَىٰ لَهَا سَعْيَهَا وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ كَانَ سَعْيُهُمْ مَشْكُورًا ۝ كُلًّا نُمِدُّ هَٰؤُلَاءِ وَهَٰؤُلَاءِ﴾

"E kush synon Botën Tjetër dhe përpiqet për të ashtu siç duhet, duke qenë besimtar, përpjekja e tyre është e pranuar dhe e shpërblyer. Të gjithëve u japim nga dhuntitë e Zotit tënd, edhe këtyre edhe atyre."[2]

Pra, Allahu thotë se ndihmon si ata që kërkojnë të mirat e kësaj bote, ashtu edhe ata që synojnë Botën Tjetër.

[1] Sure "El-Isra", ajeti 18.

[2] Sure "El-Isra", ajeti 19.

Ajo që tërheq vëmendjen është se edhe përpjekjet për çështjet e kësaj bote janë pjesë e ligjit të Allahut në krijim. Prandaj Kur'ani thotë: Ne i ndihmojmë edhe këta, edhe ata.

Ky është ligji i krijimit dhe syneti hyjnor në këtë botë: Nëse njeriu përpiqet me sinqeritet dhe punon me zell, ai do të arrijë rezultate, sepse Allahu nuk e lë pa shpërblim mundin e askujt. Pas çdo përpjekjeje të vërtetë vjen një fryt dhe një rezultat.

Nganjëherë njeriu e di qartë rezultatin që synon dhe e arrin atë. Herë të tjera ai nuk e di se cili do të jetë përfundimi i punës së tij dhe mendon se po synon diçka tjetër, ndërsa vepra e tij sjell natyrshëm rezultatin që Allahu ka caktuar për të.

Prandaj themi se Allahu i Madhëruar nuk e lë kurrë mundin dhe përpjekjen e njeriut pa shpërblim dhe pa fryt.

Një premtim tjetër i Allahut është:

﴿وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا مِنكُمْ وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ﴾

"Allahu u ka premtuar atyre prej jush që besojnë dhe bëjnë vepra të mira se do t'i bëjë mëkëmbës në tokë, ashtu siç i bëri mëkëmbës ata që ishin para tyre…"[1]

Edhe ky është një premtim i prerë dhe i padiskutueshëm. Çdo popull, çdo shoqëri dhe çdo bashkësi që zbukurohet me besim dhe vepra të mira, do të bëhet mëkëmbëse e Allahut në tokë;

[1] Sure "En-Nur", ajeti 55.

domethënë, do të arrijë me siguri në pozitat e fuqisë dhe të ndikimit.

Edhe besimtarët e së kaluarës, të cilët e shoqëruan besimin e tyre me vepra të mira, arritën pikërisht këtë rezultat. Kjo, sipas autorit, u realizua edhe në Iranin Islam dhe në periudha të ndryshme të historisë së tij.

﴿لَيَسْتَخْلِفَنَّهُمْ فِي الْأَرْضِ كَمَا اسْتَخْلَفَ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ وَلَيُمَكِّنَنَّ لَهُمْ دِينَهُمُ الَّذِي ارْتَضَى لَهُمْ﴾

"…Ai me siguri do t'i bëjë mëkëmbës në tokë, ashtu siç i bëri ata që ishin para tyre, dhe do t'ua forcojë fenë e tyre, të cilën Ai e ka pëlqyer për ta…"

Nëse besimi nuk shoqërohet me vepra të mira, atëherë nuk do të ketë mëkëmbësi dhe as pushtet të dhënë nga Allahu, sepse besimi i vetëm, pa u shndërruar në vepër, është i pafrytshëm. Por kur besimi bashkohet me veprën, ai jep frytet e tij dhe premtimi i Allahut realizohet pa dyshim.

Një tjetër premtim i Allahut në Kur'an është:

﴿وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا﴾

"Ata që përpiqen për Ne, Ne me siguri do t'i udhëzojmë në rrugët Tona."[1]

[1] Sure "El-Ankebut", ajeti 69.

Domethënë, kush përpiqet dhe lufton në rrugën e Allahut, Ai do ta udhëzojë në rrugën e drejtë.

Kur ishim të rinj dhe sapo kishim filluar të njiheshim me mësimet islame, i lexonim këto ajete në libra, i përsërisnim dhe besonim në to. E dinim se fjala e Allahut është e vërtetë, por ende nuk i kishim parë këto premtime të realizuara në praktikë.

Sot, megjithatë, këto premtime janë provuar dhe janë bërë realitet.

Në vitet e mëparshme, gjatë periudhës së luftës dhe lëvizjes islame në Iran, një periudhë që të rinjtë e sotëm nuk e mbajnë mend, ndërsa edhe shumë nga brezi i mesëm e kujtojnë vetëm pjesërisht, nëse dikush dëshironte të jetonte një jetë tërësisht islame, sidomos në Teheran, kjo ishte jashtëzakonisht e vështirë. Pengesat, vështirësitë dhe presionet ishin të shumta.

Madje edhe nëse dikush dëshironte vetëm të jetonte vetë sipas Islamit, pa u marrë me edukimin apo udhëzimin e të tjerëve, kjo nuk ishte e lehtë, sepse kishte shumë pengesa të llojeve të ndryshme.

Po të kishte thënë dikush në atë kohë se kjo lëvizje, të cilën e kishte nisur ai Sejid në qytetin e Kumit, rreth të cilit ishin mbledhur vetëm disa studentë të hauzës, të cilët sapo ngrinin një slogan arrestoheshin, burgoseshin, rriheshin dhe torturoheshin, do të tërhiqte një ditë zemrat e të gjitha shtresave të popullit iranian dhe do ta nxirrte mbarë popullin në skenë falë durimit, qëndresës, besimit dhe udhëheqjes së urtë e të drejtë, askush nuk do ta kishte besuar.

Po të thuhej se me pjesëmarrjen e popullit do të ngrihej një qeveri islame, askush nuk do ta besonte.

Por ky ishte premtimi i Allahut të Madhëruar. Ai u realizua, sepse u vu në zbatim dhe u bë realitet në praktikë.

Kur nëna e Musait lindi foshnjën e saj, Musain e vogël, nën sundimin tiranik të Faraonit, ajo e dinte me siguri se ushtarët e atij regjimi të padrejtë do ta vrisnin. Prandaj mbeti e hutuar se çfarë duhej të bënte. Sikur foshnja të kishte qenë vajzë, nuk do të kishte pasur këtë frikë, por ai ishte djalë dhe për këtë arsye zemra e saj ishte e mbushur me shqetësim dhe me një dashuri të madhe për të. Megjithatë, nuk dinte si të vepronte në atë situatë tepër të vështirë.

Atëherë Allahu i Madhëruar i shpalli:

﴿وَأَوْحَيْنَا إِلَى أُمِّ مُوسَى أَنْ أَرْضِعِيهِ ۖ فَإِذَا خِفْتِ عَلَيْهِ فَأَلْقِيهِ فِي الْيَمِّ﴾

"Ne i shpallëm nënës së Musait: 'Jepi gji; e kur të kesh frikë për të, hidhe në lumë…'"[1]

Pra, mos ki frikë! Ushqeje me gji dhe, nëse rreziku bëhet i madh e frikësohesh se armiku do ta marrë, mos lejo që ta rrëmbejnë prej teje, por hidhe në ujë!

Allahu i Madhëruar e ka përmendur këtë ngjarje në disa vende të Kur'anit dhe në secilin prej tyre e rrëfen me një hollësi dhe bukuri të veçantë. Ajo nënë po përjetonte çaste tepër të vështira. Kur e kuptoi se rreziku ishte i pashmangshëm dhe se njerëzit e Faraonit kishin mësyrë shtëpinë e kësaj familjeje izraelite për t'ia

[1] Sure "El-Kasas", ajeti 7.

marrë foshnjën, e kuptoi se, nëse nuk vepronte, do ta humbiste djalin e saj. Prandaj u detyrua ta vendoste në një arkë dhe ta hidhte në lumin Nil.

Kur'ani thotë: **"...hidhe në ujë..."**. Edhe pse fjala *"el-jem"* do të thotë det, nga konteksti i ajeteve kuptohet se këtu është fjala për lumin Nil.

Kjo është një skenë jashtëzakonisht prekëse. Si mund ta përballojë një nënë që ta vendosë foshnjën e saj në një arkë dhe ta lëshojë në një lumë me rrjedhë të fortë, që e çon gjithçka drejt një vendi të panjohur?

Megjithatë, frymëzimi hyjnor i drejtohet kësaj nëne me këto fjalë:

﴿إِنَّا رَادُّوهُ إِلَيْكِ وَجَاعِلُوهُ مِنَ الْمُرْسَلِينَ﴾

"Ne do ta kthejmë atë tek ti dhe do ta bëjmë një prej të dërguarve."[1]

Allahu i Madhëruar i dha kësaj nëne dy premtime:

Premtimi i parë, se do t'ia kthente përsëri djalin e saj.

Premtimi i dytë, se do ta bënte atë një prej të dërguarve të Tij.

Pasi nëna e hodhi djalin e saj në mes të valëve të lumit të rrëmbyeshëm, ajo i tha motrës së Musait:

[1] Sure "El-Kasas", ajeti 7.

﴿وَقَالَتْ لِأُخْتِهِ قُصِّيهِ﴾

"Dhe i tha motrës së tij: 'Ndiqe pas.'"[1] Domethënë: shko pas tij dhe shiko se ku do të përfundojë. Zemra e nënës ishte e mbushur me ankth për foshnjën e saj, e cila ishte vetëm disa ditëshe.

Valët e lumit e çuan arkën deri te pallati i Faraonit, përgjatë lumit Nil.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿فَالْتَقَطَهُ آلُ فِرْعَوْنَ﴾

"Atë e mori familja e Faraonit."[2]

Familja mbretërore e Faraonit e nxori foshnjën nga uji. Allahu hodhi mëshirë në zemrat e tyre që ta mbanin gjallë. Gruaja e Faraonit i tha burrit të saj:

﴿قُرَّتُ عَيْنٍ لِّي وَلَكَ﴾

"Ai do të jetë gëzim për syrin tim dhe për syrin tënd."[3]

Më pas Allahu bëri që Musai të mos pranonte asnjë mëndeshë:

﴿وَحَرَّمْنَا عَلَيْهِ الْمَرَاضِعَ﴾

[1] Sure "El-Kasas", ajeti 11

[2] Sure "El-Kasas", ajeti 8.

[3] Sure "El-Kasas", ajeti 9.

"Ne ia ndaluam atij gjirin e mëndeshave."[1]

Sa herë që i sillnin një grua për ta ushqyer me gji, foshnja nuk pranonte, megjithëse ishte i uritur dhe kishte nevojë për qumësht.

Në atë çast erdhi motra e Musait dhe u tha:

﴿هَلْ أَدُلُّكُمْ عَلَى أَهْلِ بَيْتٍ يَكْفُلُونَهُ لَكُمْ﴾

"A t'ju tregoj një familje që mund të kujdeset për të për ju?"[2] Domethënë: "A doni t'ju gjej një grua që ta ushqejë me gji?"

Shikoni se si Allahu e përgatit rrugën për realizimin e premtimit të Tij. Kur dëshiron të përmbushë premtimin e Vet, Ai krijon edhe shkaqet dhe kushtet e nevojshme. Ai i dha frymëzim kësaj vajze dhe i mbushi zemrën me guxim që të afrohej te njerëzit e Faraonit dhe t'u bënte këtë propozim.

Ata e pranuan. Atëherë vajza shkoi dhe solli nënën e saj, nënën e Musait, duke u thënë: "Kjo grua mund ta ushqejë foshnjën."

Kur Musai i vogël ndjeu aromën e nënës së tij, e pranoi menjëherë gjirin dhe filloi të pinte qumësht. Ky veprim nuk ngjalli asnjë dyshim te njerëzit e Faraonit; atyre as nuk u shkoi ndër mend se kjo grua mund të ishte nëna e vërtetë e foshnjës, sepse Allahu dëshironte të realizonte premtimin e Tij:

[1] Sure "El-Kasas", ajeti 12.

[2] Sure "El-Kasas", ajeti 12.

﴿فَرَدَدْنَاهُ إِلَى أُمِّهِ﴾

"Kështu Ne ia kthyem atë nënës së tij."[1]

Dhe kjo ndodhi:

﴿كَيْ تَقَرَّ عَيْنُهَا وَلَا تَحْزَنَ﴾

"Që t'i qetësohej zemra dhe të mos pikëllohej."[2]

Gjithashtu:

﴿وَلِتَعْلَمَ أَنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ﴾

"Dhe që ajo ta dinte se premtimi i Allahut është i vërtetë."[3]

Nëna e Musait e pa me sytë e saj se premtimi i parë i Allahut u përmbush plotësisht.

Ndërsa premtimi tjetër ishte:

﴿وَجَاعِلُوهُ مِنَ الْمُرْسَلِينَ﴾

"Dhe do ta bëjmë atë një prej të dërguarve."[4]

Në të vërtetë, ky ishte një lajm i hershëm për profetësinë dhe misionin e Musait (paqja qoftë mbi të), që do të ndodhte shumë vite

[1] Sure "El-Kasas", ajeti 13.
[2] Sure "Ta-Ha", ajeti 40.
[3] Sure "El-Kasas", ajeti 13.
[4] Sure "El-Kasas", ajeti 7.

më vonë. Qëllimi ishte që bijtë e Izraelit ta dinin se kjo foshnjë e vogël një ditë do të bëhej profet, i dërguar nga Allahu, dhe do t'i shpëtonte ata nga idhujtaria dhe nga shtypja e familjes së Faraonit.

Nga çasti kur Allahu i tha nënës së Musait: **"...dhe do ta bëjmë atë një prej të dërguarve."** deri në ditën kur Musai mori shpalljen dhe detyrën profetike në malin Tur, e filloi misionin për ta çliruar popullin e tij nga Faraoni, kaluan shumë vite.

Në disa transmetime islame përmendet se kjo periudhë zgjati rreth dyzet vjet. Megjithatë, duke u mbështetur në treguesit e ajeteve kur'anore, mund të kuptohet se ajo ishte afërsisht tridhjetë vjet.

Të dashurit e mi!

Dijeni se Allahu i Madhëruar i përmbush premtimet e Tij në këtë mënyrë. Premtimi hyjnor realizohet pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore. Premtimi i Allahut është që Ai dëshiron t'u japë popujve myslimanë nder, dinjitet dhe krenari. Mirëpo kjo nuk arrihet brenda një nate dhe as nuk realizohet pa përpjekje e punë. Premtimi hyjnor thekson se çdo popull që lufton në rrugën e Allahut dhe i përmbahet besimit të palëkundur, do të triumfojë mbi çdo pengesë që i del përpara.

Ju, bijtë krenarë të popullit iranian, besuat në Allahun e Madhëruar dhe më pas luftuat në rrugën e Tij, prandaj fitorja u bë aleatja juaj. Premtimi i Allahut është se do të përballeni me armiqtë e Tij dhe, pas kësaj përballjeje, do të arrini fitoren. Nëse vazhdoni me durim, qëndrueshmëri dhe rezistencë, do të fitoni edhe në sprova të tjera. Kështu, ekziston një premtim hyjnor për fitoren,

ashtu siç ka premtime të tjera për xhihadin dhe përpjekjen në rrugën e Zotit.

Kur të forcohen themelet e fuqisë hyjnore, të fuqisë së Islamit dhe të Kur'anit, si dhe të fuqisë shpirtërore e virtyteve morale, atëherë flamuri i Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) do të valëvitet lart në atë vend. Pikërisht atëherë do të fillojë armiqësia e atyre që kundërshtojnë vlerat shpirtërore, që përhapin padrejtësi, tirani e prishje në tokë dhe që nuk i durojnë fenë dhe vlerat e saj të larta.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَلَمَّا رَأَى الْمُؤْمِنُونَ الْأَحْزَابَ قَالُوا هَذَا مَا وَعَدَنَا اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَصَدَقَ اللَّهُ وَرَسُولُهُ﴾

"Kur besimtarët i panë ushtritë e bashkuara (aleatët), **thanë: 'Kjo është ajo që na e kishte premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Allahu dhe i Dërguari i Tij thanë të vërtetën.'"**[1]

Në Betejën e Ahzabit (Hendekut), hebrenjtë erdhën nga njëra anë, fisi Thekif nga një anë tjetër dhe shumë fise të tjera u bashkuan, sulmuan Medinën dhe e rrethuan atë.

Në atë situatë tepër të vështirë, njerëzit u ndanë në dy grupe: besimtarët dhe ata që "kishin sëmundje në zemrat e tyre". Ata që kishin sëmundje në zemër thoshin:

﴿مَّا وَعَدَنَا اللَّهُ وَرَسُولُهُ إِلَّا غُرُورًا﴾

[1] Sure "El-Ahzab", ajeti 22.

"Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na premtuan tjetër veçse mashtrim."[1]

Ata pretendonin se ishin mashtruar dhe thoshin se Islami nuk kishte mundur t'u sillte nder, dinjitet, siguri dhe qetësi, e as nuk ishte në gjendje t'i nxirrte nga gjendja e vështirë në të cilën ndodheshin.

Shikoni se si armiqtë i kishin rrethuar dhe izoluar besimtarët. Të gjitha ato aleanca dhe koalicione armiqësore, qofshin lindore apo perëndimore, të majta apo të djathta, të afërta apo të largëta, u bashkuan për të sulmuar me egërsi shtetin e ri islam në Medinë. Ndërsa besimtarët thoshin:

﴿هَذَا مَا وَعَدَنَا اللَّهُ وَرَسُولُهُ﴾

"Kjo është ajo që na e kishte premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij."[2]

Ata nuk çuditeshin nga këto rrethana dhe nga ky përballim, sepse Allahu dhe i Dërguari i Tij ua kishin paralajmëruar më parë. Premtimi i tyre ishte:

﴿الَّذِينَ آمَنُواْ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللهِ وَالَّذِينَ كَفَرُواْ يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ الطَّاغُوتِ﴾

"Ata që besojnë, luftojnë në rrugën e Allahut, ndërsa ata që mohojnë, luftojnë në rrugën e tagutit."[3]

---

[1] Sure "El-Ahzab", ajeti 12.

[2] Sure "El-Ahzab", ajeti 22.

[3] Sure "En-Nisa", ajeti 76.

Po, edhe armiqtë tuaj luftojnë dhe përpiqen për hir të tagutit, por ata janë të dobët. Allahu thotë:

﴿فَقَاتِلُواْ أَوْلِيَاء الشَّيْطَانِ إِنَّ كَيْدَ الشَّيْطَانِ كَانَ ضَعِيفًا﴾

"Prandaj luftoni kundër miqve të shejtanit, sepse vërtet kurthi i shejtanit është i dobët."[1]

Nëse luftoni, përpiqeni, qëndroni të palëkundur, bëni durim dhe nuk ligështoheni e nuk dorëzoheni, atëherë fitorja do të jetë e juaja. Por, nëse e braktisni fushën, ju pushton dobësia, dëshpërimi dhe tërhiqeni nga pozicionet tuaja, atëherë nuk është për t'u çuditur nëse armiku hyn në tokat tuaja dhe ndërmerr sulme të ashpra kundër jush.

Allahu thotë:

﴿هَذَا مَا وَعَدَنَا اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَصَدَقَ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَمَا زَادَهُمْ إِلَّا إِيمَانًا وَتَسْلِيمًا﴾

"Kjo është ajo që na e kishte premtuar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Allahu dhe i Dërguari i Tij thanë të vërtetën; dhe kjo vetëm ua shtoi atyre besimin dhe nënshtrimin."[2]

Prandaj themi se premtimi hyjnor është një e vërtetë e padiskutueshme. Premtimi i Allahut është i sigurt: nëse në xhihad dhe përballje tregoni durim e qëndrueshmëri, do të arrini fitoren. Po kështu, nëse jeni të sinqertë në fjalët dhe qëllimet tuaja, dijeni se

[1] Sure "En-Nisa", ajeti 76.

[2] Sure "El-Ahzab", ajeti 22.

armiqësia, urrejtja dhe zilia e kundërshtarëve ndaj jush do të shtohen patjetër. [1]

Kjo është një ditë madhështore: dita e përkujtimit të lindjes së të Zgjedhurit, Profetit të nderuar Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), si edhe e lindjes së Imam Xha'fer ibn Muhamed Es-Sadik (Paqja qoftë mbi të!). Ajo përbën një nga etapat më të rëndësishme në historinë e njerëzimit.

Në një ditë si kjo, Allahu i Madhëruar solli në këtë botë krijesën e Tij më të zgjedhur dhe amanetin e Tij të shenjtë, personalitetin e bekuar të Profetit të Madh (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Me këtë lindje filloi një etapë vendimtare në historinë e njerëzimit.

Në burimet historike është përmendur se në çastet që paraprinë ose shoqëruan këtë lindje të bekuar ndodhën disa shenja të jashtëzakonshme: një pjesë e pallatit të Kisras[2] u shemb, zjarri i shenjtë Ādhar-Gushasp[3], i cili kishte qenë i ndezur prej shekujsh në Persi, u shua, liqeni i Saveh[4], që në atë kohë konsiderohej i shenjtë nga iranianët, u tha papritur dhe uji i tij u zhduk, ndërsa idhujt që ishin vendosur rreth Qabesë së Shenjtë u rrëzuan.

---

[1] Fjalim i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik (Allahu e mëshroftë!) në dy hytbet e namazit të xhumasë në Teheran, 4/10/1377 sipas kalendarit iranian, 25/12/1999.

[2] Taku i Kisras – rrënojat e të cilit ndodhen sot pranë Bagdadit, në zonën e El-Medainit.

[3] Ādhar-Gushasp – një tempull i lashtë zoroastrian nga periudha sasanide, para Islamit në Iran.

[4] Liqeni Saveh, në Iran, pranë kryeqytetit Teheran.

Të gjitha këto shenja simbolike tregojnë vullnetin e Allahut të Madhëruar dhe ligjet hyjnore të krijimit në sjelljen në ekzistencë të kësaj qenieje madhështore dhe të këtij personaliteti unik.

Të gjitha këto ngjarje simbolike nënkuptojnë se ardhja e këtij të porsalinduri të bekuar do ta tërhiqte qilimin e poshtërimit dhe nënshtrimit nga poshtë këmbëve të njerëzimit. Kjo do të ndodhte duke rrëzuar sundimin e tiranëve dhe despotëve, siç ishte në atë kohë në Persinë paraislame dhe në Perandorinë Romake, si edhe duke zhdukur adhurimin e çdo gjëje tjetër përveç Allahut. E gjithë kjo duhej të largohej nga faqja e tokës.

Përmes kësaj qenieje të bekuar, njeriu do të çlirohej dhe do të shpëtonte nga prangat e padrejtësisë së sundimtarëve tiranë e shtypës, do t'i jepej fund politikës së shtypjes dhe torturës që kishte shoqëruar historinë njerëzore, si edhe do të çlirohej nga zinxhirët e bestytnive dhe besimeve të kota e poshtëruese, të cilat e shtynin njeriun të përulej para krijesave më të ulëta se vetja ose para njerëzve të tjerë të ngjashëm me të. Këto besime e shndërronin njeriun në një qenie të nënshtruar e të përulur, që lavdëronte këtë apo atë pa asnjë meritë.

Prandaj, ajeti fisnik që flet për misionin profetik thotë:

﴿هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَى وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ وَكَفَى بِاللَّهِ شَهِيدًا﴾

"Ai është që e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e së vërtetës, për ta bërë atë të triumfojë mbi çdo fe tjetër; dhe Allahu mjafton si Dëshmitar."[1]

Fjalia: "që ta bëjë atë të triumfojë mbi çdo fe", në këtë ajet nuk është përcaktuar një kohë e caktuar. Për këtë arsye, ai tregon drejtimin dhe synimin përfundimtar: mbarë njerëzimi, nëpërmjet kësaj ngjarjeje madhështore, duhet të ecë drejt lirisë shpirtërore, lirisë shoqërore dhe lirisë së vërtetë, të mbështetur në arsyen dhe ndërgjegjen.

Kjo është një rrugë që tashmë ka filluar dhe realizimi i saj varet nga vetë ne, njerëzit. Edhe kjo është një prej ligjeve të pandryshueshme që Allahu ka vendosur në krijimin e Tij.

Nëse njerëzit e shtojnë përpjekjen, punën dhe vendosmërinë e tyre, duke i vënë të gjitha në shërbim të së vërtetës, atëherë, pa asnjë dyshim, do t'i arrijnë më shpejt dhe në një kohë më të shkurtër synimet hyjnore që Allahu i Madhëruar ka përcaktuar për botën.

Nëse nuk i vënë në shërbim të kësaj rruge të madhe të gjitha aftësitë dhe energjitë e tyre, e përkundrazi bien në dobësi, nënshtrim dhe shpërbërje, atëherë do të mbeten prapa këtij karvani për shumë vite e madje për breza të tërë. Kështu ndodhi edhe me devijimin dhe humbjen e bijve të Izraelit, për të cilët Allahu thotë:

﴿فَإِنَّهَا مُحَرَّمَةٌ عَلَيْهِمْ ۛ أَرْبَعِينَ سَنَةً يَتِيهُونَ فِي الْأَرْضِ﴾

[1] Sure "El-Fet'h", ajeti 28.

"Ajo (Toka e Shenjtë) **u bë e ndaluar për ta për dyzet vjet; gjatë kësaj kohe do të enden të humbur nëpër tokë."**[1]

Për shkak të veprimeve të tyre të pahijshme gjatë rrugëtimit me Profetin Musa (Paqja qoftë mbi të!), bijtë e Izraelit u dënuan me humbje dhe endje në shkretëtirë. Ndërkohë, ata mund t'i kishin shmangur këto vështirësi dhe vuajtje; mund ta kishin shkurtuar kohën e sprovës dhe të mundimeve, por po ashtu, me dobësinë, neglizhencën dhe pakujdesinë e tyre, e zgjatën atë edhe më shumë.

Edhe fati ynë, si dhe fati i mbarë myslimanëve, nuk del jashtë ligjeve hyjnore që Allahu ka vendosur për shoqërinë njerëzore, për misionet profetike dhe për urtësinë e dërgimit të të dërguarve dhe të shpalljes së librave hyjnorë. Allahu i Madhëruar na i ka bërë të qarta këto ligje që më parë. Janë vetë njerëzit ata që, me veprat e tyre, mund ta zgjasin ose ta shkurtojnë këtë rrugë; mund të arrijnë te synimi i dëshiruar në një kohë të shkurtër ose ta vonojnë atë për një periudhë shumë më të gjatë.[2]

[1] Sure "El-Maide", ajeti 26.

[2] Fjalim i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik (Allahu e ruajttë) me përgjegjësit dhe drejtuesit e qeverisë me rastin e ditëlindjes së Profetit të Madh (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), më 17 Rabiul-Evvel 1381, sipas kalendarit Iranian, 30/4/2002.

Marrëdhënia shpirtërore mes njerëzve është nga Allahu i Madhëruar

Kur'ani i Shenjtë i drejtohet të Dërguarit më të Madh (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), duke thënë:

﴿لَوْ أَنفَقْتَ مَا فِي الأَرْضِ جَمِيعًا مَّا أَلَّفْتَ بَيْنَ قُلُوبِهِمْ﴾

"Edhe sikur të shpenzoje gjithçka që gjendet në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre."[1]

Kjo do të thotë se edhe sikur të shpenzoheshin të gjitha pasuritë e kësaj bote, nuk do të ishte e mundur të krijohej një lidhje e tillë zemrash. Burimet e naftës dhe të ardhurat në valutë të huaj nuk janë gjëja thelbësore; madje edhe sikur të shpenzonim të gjitha pasuritë e botës në propagandë, mekanizmat e saj, mediat publike, partitë politike e të ngjashme, nuk do të mund të krijonim këtë lidhje shpirtërore dhe këtë dashuri të ndërsjellë që gëzojmë sot në Iran. Prandaj, lidhja me Allahun e Madhëruar është shkaku kryesor i këtij komunikimi, vëllazërimi dhe afërsie që ekziston mes nesh.[2]

[1] Sure "El-Enfal", 63.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje, vëll. 1, f. 143.

Imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!), mishërim i plotë i ajetit kur'anor

Në agimin e natës kur Imami u largua nga kjo botë për t'u kthyer te Zoti i tij, në çastet e syfyrit, ndërsa isha në një gjendje tronditjeje, dhimbjeje, pikëllimi dhe hutimi, hapa Kur'anin për istihare. M'u shfaq ky ajet fisnik nga Surja "El-Kehf":

﴿وَأَمَّا مَنْ آمَنَ وَعَمِلَ صَالِحًا فَلَهُ جَزَاءُ الْحُسْنَى وَسَنَقُولُ لَهُ مِنْ أَمْرِنَا يُسْرًا﴾

"Ndërsa ai që beson dhe bën vepra të mira, për të është shpërblimi më i mirë dhe Ne do t'i flasim atij me butësi e lehtësi në urdhrat Tanë."[1]

Vura re se ky ajet ishte një tregues i qartë dhe një mishërim i spikatur i personalitetit të Imamit (Allahu e mëshiroftë!). Besimi, veprat e mira dhe shpërblimi i bukur hyjnor përbënin një nga dhuntitë dhe shpërblimet më të larta që Allahu ia kishte dhënë atij.[2]

Shpërblimi i veprës në përpjekjen për dynjanë ose për Ahiretin

Ndonjëherë vëreni se disa kombe nuk besojnë në fe dhe nuk i përmbahen devotshmërisë dhe vlerave morale, megjithatë gëzojnë një jetë materiale të rehatshme dhe, sipas pamjes së jashtme, ideale. Kjo ndodh sepse ata punojnë dhe përpiqen seriozisht për çështjet e kësaj bote. Por një jetë e tillë nuk përfundon me një rezultat të dëshiruar dhe as me një përfundim të

[1] Sure "El-Kehf", ajeti 88.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 1, f. 6.

lavdërueshëm; përkundrazi, ajo shoqërohet me prishje dhe imoralitet, dhe si pasojë çon në shkatërrimin e kombit ose të individëve.

Qytetërimi material bashkëkohor në botë sot ka zgjedhur pikërisht këtë rrugë në jetë. Ndërsa populli besimtar në Iran vazhdon përpjekjen e tij në rrugën e së vërtetës, ashtu siç jeni edhe ju tani. Nuk ka dyshim se Allahu i Madhëruar do ta shpërblejë dhe do ta shpërblejë këtë popull; dhe ky shpërblim nuk do të kufizohet vetëm në Botën Tjetër, por ata do të marrin shpërblimin e tyre edhe në këtë botë. Shpërblimi në këtë botë është se do të arrijnë lumturinë dhe dinjitetin, sipas veprave dhe sjelljeve të tyre, dhe do të çlirohen nga poshtërimi, nënshtrimi, sundimi, detyrimi dhe shtypja.[1]

Surja "El-Ahzab" përshkrim i armiqësisë së njerëzve të ligj

Vëreni se si ishte Islami në Mekë, ku në fillimet e tij u përball me lloje të ndryshme armiqësie, kundërshtimi dhe komplotesh. Të gjithë të ligjtë, kriminelët e egër dhe njerëzit e ulët ishin ngritur kundër Profetit të Nderuar (Paqja qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe Islamit fisnik.

Kur i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) emigroi në Medinë, urrejtjet, ligësitë dhe armiqësitë e përgjakshme të njerëzve të këqij dhe të ulët nuk morën fund. Përkundrazi, këto përballje djallëzore vazhduan deri në atë

[1] Po aty, f. 253–254.

shkallë sa në Kur'an ekziston një sure e quajtur "El-Ahzab", e cila pasqyron këto ngjarje dhe përballje.

Këto grupe ishin koalicione të ndryshme që u bashkuan kundër Islamit dhe udhëheqësit të tij të madh, duke mobilizuar forcat e tyre kundër tij. Midis tyre ishin idhujtarët e Kurejshit, fisi Thekif, disa nga ithtarët e Librit që ishin larguar nga mësimet e tij (hebrenjtë dhe të krishterët), si dhe hipokritët. Ata u bashkuan dhe u bënë një dorë e vetme për të shkatërruar Islamin dhe për të zhdukur myslimanët.

Gjatë sundimit të gjatë të sulltanëve emevitë dhe abasitë, ata përndiqnin ata që vazhdonin të thërrisnin drejt Islamit të vërtetë dhe islamit të pastër muhamedan. Këta njerëz përballeshin me lloje të ndryshme presioni, torture, shtypjeje dhe komplotesh të organizuara kundër tyre.

Jeta e imam Musa ibn Xha'ferr (imami i shtatë i shiitëve), jeta e imamëve të tjerë (Paqja qoftë mbi ta!), si dhe biografitë e dijetarëve dhe muhaddithëve të mëdhenj që vuajtën shumë nga halifët e padrejtë të asaj kohe, të cilët i torturuan, i rrahën me kamxhikë, i futën në burgje dhe qeli dhe derdhën gjakun e tyre të pastër e të bekuar, janë vetëm disa shembuj të këtyre përballjeve të ashpra.[1]

Sistemi Islamik në Iran është një pemë e mirë, ndërsa imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!) është rrënja e saj e palëkundur.

Në të kaluarën ekzistonte Irani, ekzistonte edhe populli iranian, pozita gjeografike e vendit ishte po ajo që është edhe sot, ndërsa fikhu, Sheriati, Kur'ani dhe Nehxhul Belaga ishin po ashtu

[1] Po aty, vëll. 1, f. 287.

të pranishëm. Megjithatë, ne nuk zotëronim asgjë; mbeteshim çdo ditë e më shumë prapa, identiteti ynë goditej dhe shtypej vazhdimisht, ndërsa personaliteti ynë shpërbëhej dhe humbiste dita-ditës.

Imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!) doli në skenë. Ai u bë si vetë ekzistenca, përmes së cilës realitetet marrin jetë dhe bëhen të pranishme; si dielli ndriçues që i shfaq gjërat dhe zbulon të vërtetën e tyre; si shpirti që fryhet në trupat e pajetë dhe u jep atyre jetë e gjallëri.

Po, ai na ringjalli dhe na nxori në arenën e shfaqjes, të veprimit dhe të lëvizjes. Atëherë u zbulua vlera gjeografike dhe historike e Iranit, u shfaq përsëri kultura jonë e lashtë, dolën në pah Kur'ani dhe Nehxhul Belaga, ndërsa populli ynë e jetoi edhe një herë jetën e vërtetë, duke u bërë një element i dobishëm dhe i vlefshëm për shoqërinë njerëzore.[1]

Invalidët e luftës dhe ata që sakrifikuan jetën e tyre në Kur'anin e Shenjtë

Invalidi i luftës dhe ai që sakrifikon jetën në rrugën e Allahut është luftëtari (*muxhahidi*) që ka humbur një pjesë të trupit ose të gjymtyrëve të tij në rrugën e Allahut. Ai mbart me vete një ose më shumë gjymtyrë të flijuara, ndërsa pjesën e mbetur të jetës e kalon duke qenë i përkushtuar ndaj devotshmërisë, falënderues ndaj Allahut të Madhëruar dhe duke bërë vepra të mira.

[1] Po aty, f. 333.

Pikërisht këta të plagosur dhe invalidë të luftës Allahu i përmend në Kur'anin e Shenjtë, duke thënë:

﴿الَّذِينَ اسْتَجَابُواْ لِلَّهِ وَالرَّسُولِ مِن بَعْدِ مَا أَصَابَهُمُ الْقَرْحُ لِلَّذِينَ أَحْسَنُواْ مِنْهُمْ وَاتَّقَواْ أَجْرٌ عَظِيمٌ﴾

"Për ata që iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit, edhe pasi u plagosën, për ata prej tyre që bënë mirë dhe u treguan të devotshëm, ka një shpërblim të madh."[1]

Fjala "عظيم" (i madh) në fund të këtij ajeti fisnik është një shprehje që fton njeriun të ndalet, të meditojë dhe të thellohet në madhështinë e këtij shpërblimi.[2]

Ruajtja e mirësisë dhe e begatisë është më e rëndësishme sesa fitimi i saj

Ka shumë popuj në histori që janë përfshirë nga mirësitë e Allahut, por nuk kanë mundur t'i ruajnë dhe t'i mbajnë ato për veten e tyre. Allahu i Madhëruar, në Kur'anin Famëlartë, u drejtohet bijve të Izraelit duke thënë:

﴿وَأَنِّي فَضَّلْتُكُمْ عَلَى الْعَالَمِينَ﴾

"…dhe se Unë ju kam dalluar mbi të gjithë popujt e botës."[3]

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 172.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 1, f. 337–338.

[3] Sure "El-Bekare", ajeti 47.

Mirëpo, po këta njerëz arritën në një shkallë të tillë humbjeje dhe devijimi, saqë Kur'ani thotë për ta:

﴿ضُرِبَتْ عَلَيْهِمُ الذِّلَّةُ وَالْمَسْكَنَةُ﴾

"Ata u goditën me poshtërim dhe mjerim."[1]

Kjo ndodhi sepse mohuan mirësitë hyjnore, i shpërdoruan begatitë dhe nuk arritën t'i ruanin e t'i mbronin ato. Historia e njerëzimit dhe historia e popujve është e mbushur me shembuj individësh dhe kombesh që fituan begati, por nuk qenë në gjendje t'i ruanin ato.[2]

Metodologjia e edukimit dhe e formimit në Kur'anin e Shenjtë

Nganjëherë mund të shohësh një udhëheqës që i urdhëron ose i këshillon njerëzit për moral të mirë, sakrificë, durim, qëndresë dhe vendosmëri në rrugën e Allahut. Ai u kërkon të mos bëjnë padrejtësi, por të veprojnë me drejtësi dhe paanshmëri. Këtu kemi të bëjmë me këshillimin, urdhërimin dhe mësimdhënien, të cilat janë një domosdoshmëri dhe një nevojë e madhe. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ua mësonte njerëzve mësime të çmuara mbi njohjen dhe jetën.

Megjithatë, nganjëherë çështja është më e madhe dhe më e lartë sesa thjesht mësimdhënia. Mësuesi ose udhëheqësi vepron në

[1] Sure "El-Bekare", 61.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 2, f. 79–80.

atë mënyrë dhe ndjek një sjellje të tillë që këto virtyte morale dhe këto detyra islame të bëhen një realitet i qëndrueshëm dhe një tipar i përhershëm i shoqërisë. Për këtë arsye, ai shpall një luftë të pamëshirshme kundër ideve të gabuara dhe të shtrembëruara. Fillon përballja dhe individi, si edhe shoqëria, përjetojnë një tronditje të fortë shpirtërore. Mirëpo, në raste dhe rrethana të caktuara, duke përdorur mënyrat dhe metodat e përshtatshme, udhëheqësi arrin t'i përvetësojë dhe t'i ngulisë plotësisht këto virtyte morale, këtë metodë të drejtë sjelljeje dhe këtë rrugë të shëndoshë në atmosferën shoqërore dhe në jetën e përditshme të njerëzve.[1]

Çështja e "Ifk-ut" (Shpifjes së madhe) në Kur'anin e Shenjtë

Çështja e *ifk-ut* përmblidhet në faktin se njëra nga bashkëshortet e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), gjatë një prej betejave, mbeti prapa karvanit. Profeti e kishte marrë me vete në atë ekspeditë ushtarake dhe, kur u kthye nga lufta, nuk e gjeti më. Nuk dihet saktësisht se cili ishte shkaku. Ndoshta e kishte zënë gjumi, ose ndoshta ishte larguar për të kryer një nevojë. Sido që të ketë qenë, myslimanët u kthyen nga lufta dhe, papritur, vunë re se bashkëshortja e Profetit nuk ndodhej mes tyre. Më pas, një mysliman e gjeti atë dhe e shoqëroi deri në Medinë.

Kush ishte ajo bashkëshorte e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)? Rreth kësaj çështjeje

[1] Po aty, vëll. 2, f. 241–242.

ka mospajtime ndërmjet transmetimeve të Ehli Sunetit dhe atyre të Shkollës së Ehli Bejtit. Sipas dijetarëve shiitë, ajo ishte Maria El-Kibtijje, ndërsa dijetarët sunitë thonë se ishte Aishja.

Megjithatë, dua të theksoj se përcaktimi i identitetit të bashkëshortes së Profetit nuk është thelbësor. Të përqendrohesh sot vetëm te kjo çështje do të thotë ta largosh vëmendjen nga mesazhi kryesor. Tema nuk është që të këmbëngulim të dimë emrin e bashkëshortes së Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që iu nënshtrua këtij incidenti dhe për të cilën zbritën ajetet lidhur me akuzat që iu drejtuan. Përkundrazi, kjo ngjarje përmban një dimension tjetër, i cili bart një udhëzim shumë të rëndësishëm moral dhe shoqëror. Pasi kjo zonjë fisnike u kthye në Medinë, disa njerëz të papërgjegjshëm, llafazanë dhe përhapës thashethemesh filluan të pëshpërisnin në veshët e njerëzve dhe të përhapnin dyshime e pyetje rreth bashkëshortes së Profetit: "Ku ishte? Pse mbeti prapa karvanit? Kush ishte ai që e solli në Medinë?", dhe kështu nisën të përhapnin shpifje dhe aludime.

Ata i përhapën dhe i shpallën këto thashetheme dhe gënjeshtra mes njerëzve, pa deklaruar hapur ndonjë akuzë të caktuar dhe pa drejtuar ndonjë akuzë të qartë. Më pas, çështja nuk kufizohej vetëm në faktin se kjo zonjë e ndershme ishte bashkëshortja e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ndaj respektimi dhe nderimi i saj ishte detyrë për të gjithë. Përkundrazi, Kur'ani e trajton këtë çështje nga një këndvështrim tjetër.

Ajetet që lidhen me këtë ngjarje në Suren "En-Nur", rreth çështjes së "*ifk-ut*" (Shpifjes së madhe), tregojnë se Kur'ani u

përgjigjet atyre fjalëve të pavërteta dhe shpifjeve që u përhapën nga hipokritët, armiqtë dhe njerëzit me zemra të sëmura. Ajetet vijnë njëri pas tjetrit, duke iu drejtuar besimtarëve me një gjuhë të ashpër qortuese dhe duke i kritikuar: Pse nuk mbajtët një qëndrim të prerë dhe të vendosur kundër atyre që përhapnin këto shpifje, sapo dëgjuat fjalët e tyre të rreme dhe thashethemet e tyre?. Ky është kuptimi që del nga këto ajete. Përse nuk e dënuat, nuk e hodhët poshtë dhe nuk e mohuat këtë shpifje në mënyrë të prerë, të qartë dhe të guximshme?

Në këto ajete fisnike gjejmë dy shprehje që fillojnë me fjalën "لولا" (Sikur… / Përse nuk…). Ata që janë të njohur me gjuhën dhe letërsinë arabe e dinë se përdorimi qortues i "لولا" vjen në një kontekst ku folësi i drejtohet bashkëbiseduesve të tij me një qortim të fortë, duke u thënë: "Pse nuk e kryet detyrën tuaj?"

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿لَوْلَا إِذْ سَمِعْتُمُوهُ ظَنَّ الْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بِأَنفُسِهِمْ خَيْرًا وَقَالُوا هَذَا إِفْكٌ مُّبِينٌ﴾

"Përse, kur e dëgjuat këtë (shpifje)**, besimtarët dhe besimtaret nuk patën mendim të mirë për njëri-tjetrin dhe nuk thanë: 'Kjo është një shpifje e qartë.'?"**[1]

Po i njëjti kuptim dhe e njëjta mënyrë shprehjeje vjen edhe në ajetin tjetër:

[1] Sure "En-Nur", ajeti 12.

﴿وَلَوْلَا إِذْ سَمِعْتُمُوهُ قُلْتُم مَّا يَكُونُ لَنَا أَن نَّتَكَلَّمَ بِهَذَا سُبْحَانَكَ هَذَا بُهْتَانٌ عَظِيمٌ﴾

"Përse, kur e dëgjuat atë, nuk thatë: 'Nuk na takon neve të flasim për këtë. I Lartësuar je Ti, o Allah! Kjo është një shpifje e madhe.'"[1]

Këto dy ajete u drejtohen besimtarëve dhe besimtareve, pra shoqërisë islame të asaj kohe, duke e qortuar dhe kritikuar ashpër:

Përse nuk patët mendim të mirë për njëri-tjetrin kur ju arriti kjo shpifje e rreme? Përse nuk u ngritët menjëherë kundër saj, duke e dënuar dhe duke e cilësuar si një "shpifje të qartë" (إفك مبين)? Përse nuk mbajtët një qëndrim të prerë, duke thënë: "Nuk na lejohet të flasim për këtë çështje, të përfshihemi në këto biseda, të përsërisim këtë trillim dhe t'i japim mundësi që kjo shpifje e rreme të përhapet edhe më tej"? Dhe përse nuk e quajtët këtë akuzë atë që është në të vërtetë: "një shpifje e madhe" (بهتان عظيم)?

Më pas, në fund të këtyre ajeteve, Allahu i Madhëruar thotë:

﴿يَعِظُكُمُ اللَّهُ أَن تَعُودُوا لِمِثْلِهِ أَبَدًا إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ﴾

"Allahu ju këshillon që të mos ktheheni kurrë më në diçka të tillë, nëse jeni besimtarë."[2]

Pra, sipas këtij ajeti, një prej kushteve të besimit të vërtetë në shoqërinë islame është që besimtarët të mos përfshihen kurrë më

[1] Sure "En-Nur", ajeti 16.

[2] Sure "En-Nur", ajeti 17.

në komplote të tilla të ulëta, në përhapjen e shpifjeve dhe të thashethemeve, apo në çdo gjë që cenon nderin dhe dinjitetin e njerëzve.

Dinjiteti dhe krenaria i përkasin Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve

Populli ynë e ka ruajtur dinjitetin dhe krenarinë e tij përballë fuqive botërore. Kjo do të thotë se ai ka realizuar pikërisht atë që kërkon dhe u bën thirrje Kur'ani myslimanëve:

﴿وَلِلَّهِ الْعِزَّةُ وَلِرَسُولِهِ وَلِلْمُؤْمِنِينَ﴾

"Dinjiteti dhe krenaria i përkasin Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve."[1]

Krenaria dhe dinjiteti i përkasin besimtarit, sepse besimtari është i vetmi njeri që lufton dhe i reziston çdo lëvizjeje prej së cilës ndihet era e shejtanit, padrejtësisë dhe korrupsionit. Ai nuk i nënshtrohet askujt tjetër përveç Allahut dhe nuk bëhet rob i askujt tjetër, veçse i Allahut të Madhëruar.

Që nga koha kur populli iranian, përmes fitores së Revolucionit Islamik, arriti ta mishërojë dhe ta ringjallë fenë e Allahut dhe Islamin në kuadrin e një sistemi shoqëror modern dhe të zhvilluar, zemrat e arrogantëve dhe fuqive hegjemoniste u mbushën me frikë dhe ankth nga Islami. Pikërisht për këtë arsye ata filluan të luftojnë sistemin islamik, të shfrytëzojnë mediat

[1] Sure "El-Munafikun", ajeti 8.

masive dhe të shpenzojnë pasuri të mëdha për të vepruar kundër Islamit.[1]

Koncepti i vilajetit dhe i teuhidit në shoqërinë islame

Nëse meditojmë mbi Kur'anin e Shenjtë, shohim se ai thotë:

﴿يَهْدِي بِهِ اللهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلاَمِ﴾

"Me të, Allahu i udhëzon në rrugët e paqes ata që ndjekin kënaqësinë e Tij."[2]

Kjo do të thotë se ata që besojnë në Allahun, Allahu do t'i udhëzojë dhe do t'i prijë në rrugët e paqes dhe të bashkëjetesës paqësore.

Kjo buron nga parimet dhe bazat e teuhidit (njëshmërisë së Allahut) në shoqërinë islame. Edhe vilajeti mbart të njëjtin karakter dhe të njëjtin kuptim. Vilajeti nënkupton lidhje, afërsi, bashkim të fortë dhe solidaritet të vërtetë, i cili nuk pranon shkëputje apo ndarje.

Kur thuhet se shoqëria islame gëzon vilajet, kjo do të thotë se të gjitha pjesët e saj janë në lidhje dhe harmoni të plotë me njëra-tjetrën, si dhe me boshtin dhe qendrën e kësaj shoqërie, pra me Velijjul-Fakihun (autoritetin fetar). Një prej domosdoshmërive të këtij uniteti dhe solidariteti është që shoqëria islame të jetë një e

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 3, f. 13.

[2] Sure "El-Maide", ajeti 16.

vetme dhe e bashkuar në brendësinë e saj. Çdo pjesë e saj duhet të jetë e lidhur dhe e harmonizuar me pjesët e tjera.

Në marrëdhëniet me jashtë, kjo shoqëri përpiqet të tërheqë dhe të afrojë ato elemente që janë të përshtatshme dhe në përputhje me parimet e saj. Sa u përket elementeve armiqësore dhe kundërshtare, ajo i largon dhe i zmbraps, duke ndjekur metodën e përshkruar në fjalën e Allahut:

﴿أَشِدَّاء عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاء بَيْنَهُمْ﴾

"Të ashpër ndaj jobesimtarëve, por të mëshirshëm ndërmjet tyre."[1]

Ky është kushti i vilajetit dhe i teuhidit në shoqërinë islame.[2]

Parimi i urdhërimit për të mirë dhe i ndalimit nga e keqja në sistemin islamik

Duhet ta ngremë veten drejt burimit të Islamit të pastër, që jeta jonë të bëhet vërtet e mirë dhe e begatë. Kur'ani i Shenjtë thotë:

﴿الَّذِينَ إِن مَّكَّنَّاهُمْ فِي الْأَرْضِ أَقَامُوا الصَّلَاةَ وَآتَوُا الزَّكَاةَ وَأَمَرُوا بِالْمَعْرُوفِ وَنَهَوْا عَنِ الْمُنكَرِ﴾

[1] Sure "El-Fet'h", ajeti 29.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 3, f. 85–86.

"(Ata janë) **ata të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, e falin namazin, e japin zekatin, urdhërojnë për të mirën dhe ndalojnë nga e keqja."**[1]

Prandaj, më vjen mirë t'ju kujtoj juve dhe popullit iranian një detyrë të harruar prej detyrave të Islamit, e cila është urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja. Çdo pjesëtar i popullit duhet të marrë përsipër detyrën e nxitjes për vepra të mira e të virtytshme dhe të ndalimit nga veprat e këqija e të ulëta. Kjo është ajo që garanton dhe siguron një jetë të mirë për popullin në sistemin islamik.

Nuk mjafton vetëm të flitet për këtë detyrë; ajo duhet të zbatohet në praktikë, që të shihen frytet dhe arritjet e saj në shoqëri.

Urdhërimi për të mirën përbëhet nga dy faza: faza e fjalës dhe faza e veprimit. Me fazën e veprimit nënkuptohet ndërhyrja me dorë dhe përdorimi i forcës. Kjo fazë, në kohën e sotme, është përgjegjësi e qeverisë dhe duhet të ushtrohet vetëm me autorizimin e shtetit. Ndërsa urdhërimi për të mirën dhe ndalimi nga e keqja me anë të fjalës është një detyrë e detyrueshme për të gjithë dhe secili duhet ta kryejë atë pa kompromis dhe pa turp.

Nëse dikush kryente një mëkat ose një krim gjatë regjimit të mëparshëm monarkik, dhe dikush tjetër ngrihej për ta kundërshtuar, ishte vetë regjimi sundues ai që shtypte dhe zhdukte kundërshtarin. Ne e kemi parë me sytë tanë se në ato ditë ai që kryente krime dhe gjynahe shpërblehej për veprat e tij, ndërsa ai që protestonte dhe kritikonte këto shkelje shtypej dhe ndëshkohej.

[1] Sure "El-Haxh", ajeti 41.

Sot çështja është e kundërta. Nuk po them se në shoqëri nuk ka gjynahe apo krime; jo, ato ekzistojnë. Edhe në kohën e qeverisjes së imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) kishte gjynahe dhe krime. Por ajo që ka rëndësi është se sistemi qeverisës i shoqërisë, drejtuesit e vendit dhe ata që planifikojnë çështjet e shtetit ecin në rrugën e drejtësisë dhe të përmirësimit, si dhe kundërshtojnë mëkatin dhe devijimin nga vlerat dhe virtytet.[1]

Sqarimi dhe përcaktimi i pozitës së gruas nga këndvështrimi i Kur'anit

Nuk ka dallim midis gruas dhe burrit, veçanërisht kur shohim se Allahu i Madhëruar, në Kur'anin Famëlartë, paraqet një shembull dhe model të personalitetit të dëshiruar, duke thënë:

﴿وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا لِّلَّذِينَ آمَنُوا اِمْرَأَتَ فِرْعَوْنَ﴾

"Dhe Allahu u sjell si shembull atyre që besuan gruan e Faraonit."[2]

Në kohën e profetit Musa (Paqja qoftë mbi të!) kishte shumë besimtarë që luftuan dhe sakrifikuan në rrugën e besimit. Megjithatë, Allahu nuk i përmend ata në këtë ajet, por paraqet si model një grua. Cili është vallë shkaku i kësaj zgjedhjeje? A deshi Allahu i Madhëruar të mbrojë pozitën e gruas, apo kjo zgjedhje ka arsye të tjera?

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 3, f. 140–141.

[2] Sure "Et-Tahrim", ajeti 11.

Çështja është se kjo grua, bashkëshortja e Faraonit, në udhëtimin e saj shpirtëror dhe në ngritjen e saj morale arriti në një shkallë aq të lartë, saqë askush tjetër nuk mund ta rivalizonte në atë pozitë.

Ajo jetoi shumë kohë përpara epokës së Fatime Zehrasë (Paqja qoftë mbi të!) dhe të Merjemes së Madhe, nënës së Isait (Paqja qoftë mbi ta!). Ajo i përkiste një periudhe shumë më të hershme historike. Ishte bashkëshortja e Faraonit, nuk ishte profete, nuk ishte bijë e një profeti, nuk ishte bashkëshorte e një profeti dhe as nuk ishte rritur në shtëpinë e një profeti. Përkundrazi, ishte edukimi i saj shpirtëror, pastrimi i brendshëm, udhëzimi hyjnor dhe zhvillimi i saj moral që e ngritën në atë shkallë të lartë të dinjitetit dhe të madhështisë.[1]

Në anën tjetër, Kur'ani paraqet edhe modelin e personalitetit negativ. Në të kundërt, ekziston edhe një model tjetër që simbolizon personalitetin negativ dhe të papëlqyer. Allahu i Madhëruar zgjedh gruan si shembull në të dyja rastet.

Nga njëra anë, Ai sjell si shembull gruan e Faraonit: "Dhe Allahu u sjell si shembull atyre që besuan gruan e Faraonit." si model i një personaliteti pozitiv.

Nga ana tjetër, Allahu thotë:

﴿ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا لِّلَّذِينَ كَفَرُوا امْرَأَتَ نُوحٍ وَامْرَأَتَ لُوطٍ كَانَتَا تَحْتَ عَبْدَيْنِ مِنْ عِبَادِنَا صَالِحَيْنِ فَخَانَتَاهُمَا...﴾

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 8, f. 57–58

"Allahu sjell si shembull për ata që mohuan gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin nën kurorën e dy robërve Tanë të mirë, por i tradhtuan ata…"[1]

Allahu i Madhëruar i përmend ato si dy personalitete negative, fatkëqija, të devijuara dhe të rrëzuara moralisht; si dy gra që dolën nga rruga e drejtë dhe ecën në rrugën e humbjes.

Këtu lind një pyetje e rëndësishme: Përse Allahu i Madhëruar nuk zgjodhi shembuj nga burrat? Përse nuk solli një shembull nga një burrë dhe një grua së bashku?

Jo, nuk ndodhi kështu. Përkundrazi, në këto ajete të Kur'anit, sa herë që Allahu thotë: "Dhe Allahu u sjell si shembull atyre që besuan, ose: "Allahu sjell si shembull për ata që mohuan. Ai sjell si shembull gra. A nuk tregon kjo, sipas këndvështrimit të Kur'anit, se njerëzit kanë gabuar në mënyrën se si e kanë parë gruan? Fatkeqësisht, ky perceptim i gabuar ka vazhduar gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Islami është ai që ngrihet për ta korrigjuar këtë këndvështrim, këtë mënyrë të trajtimit dhe këtë kuptim të shtrembëruar që është ushqyer për pozitën e gruas përgjatë shekujve.[2]

[1] Sure "Et-Tahrim", ajeti 10.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 3, f. 149.

Ndikimi i devotshmërisë (*tekvasë*) në zemrën dhe jetën e njeriut

Devotshmëria (*tekvaja*) është porosia e parë dhe e fundit e të gjithë profetëve. Në Kur'anin e Shenjtë lexojmë se fjalët e para që profetët ua drejtonin njerëzve ishin gjithmonë porosia për takva. Kur ekziston devotshmëria, ekziston edhe udhëzimi hyjnor; ndërsa kur mungon takvaja, njeriu dhe shoqëria nuk mund të përfitojnë plotësisht nga udhëzimi i Allahut.

Agjërimi, për shembull, është një përgatitje për arritjen e devotshmërisë. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ﴾

"Ju është bërë detyrë agjërimi, ashtu siç ishte bërë detyrë edhe atyre që ishin para jush, që të bëheni të devotshëm."[1]

Po ashtu, në ajete të tjera Allahu i Madhëruar tregon se devotshmëria i dhuron dritë zemrës, jetës dhe rrugës së njeriut, në mënyrë që ai të ecë nën dritën e saj dhe të gjejë rrugën e jetës. Njerëzimi nuk mund të ecë në rrugën e drejtë duke qenë në humbje, hutim dhe lëkundje. Pa e njohur destinacionin, qëllimin dhe synimin, nuk është e mundur që kjo karvanë e madhe njerëzore të ecë si duhet.

Për këtë arsye, Kur'ani thotë:

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 183.

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَآمِنُوا بِرَسُولِهِ يُؤْتِكُمْ كِفْلَيْنِ مِن رَّحْمَتِهِ وَيَجْعَل لَّكُمْ نُورًا تَمْشُونَ بِهِ﴾

"O ju që besuat! Bëhuni të devotshëm dhe besoni të Dërguarin e Tij; Ai do t'ju japë dyfish nga mëshira e Tij dhe do t'ju japë një dritë me të cilën do të ecni…"[1] [2]

Surja "En-Neml", një skenë që pasqyron njëkohësisht mendjemadhësinë dhe përulësinë

Egoizmi është ai që e prish njeriun dhe ia shkatërron jetën. Prishja dhe dëmi që shkakton një njeri i tillë bëhen edhe më të mëdha kur ai zotëron fuqi dhe pushtet; sa më e madhe të jetë fuqia e tij, aq më i madh është edhe dëmi që shkakton.

Për këtë arsye, Kur'ani i Shenjtë thotë:

﴿أَلَيْسَ فِي جَهَنَّمَ مَثْوًى لِّلْمُتَكَبِّرِينَ﴾

"A nuk është në Xhehenem vendbanimi i mendjemëdhenjve?"[3]

Zjarri i Xhehennemit është vendstrehimi dhe përfundimi i arrogantëve dhe i mendjemëdhenjve, sepse mëkati, sjellja e shthurur dhe mjerimi i plotë nuk burojnë veçse nga mendjemadhësia dhe krenaria e rreme. Pikërisht kjo

[1] Sure "El-Hadid", ajeti 28.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 4, f. 42.

[3] Sure "Ez-Zumer", ajeti 60.

mendjemadhësi krijon një botë të sunduar nga shejtani, fillimisht në brendësinë dhe zemrën e këtyre njerëzve krenarë, e më pas edhe në mjedisin dhe jetën e tyre shoqërore.

Kam meditуar mbi Suren e bekuar "En-Neml" dhe kam parë se rrëfimi i profetit Sulejman (Paqja qoftë mbi të!), një pjesë e të cilit përmendet në këtë sure, është vërtet i jashtëzakonshëm. Mund të thuhet se pothuajse të gjitha temat e kësaj sureje rrotullohen rreth këtij boshti.

Sureja fillon me historinë e profetit Musa (Paqja qoftë mbi të!) dhe përfundon me përshkrimin e Faraonit, të cilin e paraqet si simbol të arrogancës dhe mendjemadhësisë. Pra, paraqet një njeri që mburrej me fuqinë dhe madhështinë e tij të jashtme deri në atë shkallë, sa pretendonte sikur edhe krijimi i një bote tjetër varej prej tij, ashtu siç ishte krijuar kjo botë.

Më pas, surja kalon te rrëfimet e profetëve Davud dhe Sulejman (Paqja qoftë mbi ta!):

﴿وَلَقَدْ آتَيْنَا دَاوُودَ وَسُلَيْمَانَ﴾

"Ne i dhamë Davudit dhe Sulejmanit…"[1]

Allahu i Madhëruar u dha këtyre profetëve dije, mbretëri dhe fuqi, deri në atë shkallë sa Sulejmani (Paqja qoftë mbi të!) u drejtohej njerëzve përreth tij duke thënë:

[1] Sure "En-Neml", ajei 16.

﴿وَأُوتِينَا مِن كُلِّ شَيْءٍ﴾

"Dhe neve na është dhënë nga çdo gjë."[1]

Allahu i Madhëruar i kishte dhënë atij gjithçka që ishte e nevojshme për një pushtet dhe autoritet të veçantë, të cilin askush nuk mund ta sfidonte. Ai ishte zotëruesi i plotë i çështjeve në të gjitha fushat.

Duhet theksuar se mbretëria dhe qeverisja e profetit Sulejman (Paqja qoftë mbi të!) ishin fryt i përpjekjeve dhe sakrificave shumëvjeçare të bijve të Izraelit, që zgjatën për disa shekuj. E vërteta që solli Musa (Paqja qoftë mbi të!) përballë Faraonit ishte po ajo e vërtetë që u ruajt dhe u mbajt gjallë nga bijtë e Izraelit për shumë vite. Ishte pikërisht kjo fjalë e teuhidit (Njësimit të Allahut) që përgatiti themelimin e qeverisë së drejtë të Davudit (Paqja qoftë mbi të!), e më pas u shfaq qeverisja e mrekullueshme dhe e jashtëzakonshme e Sulejmanit (Paqja qoftë mbi të!).[2]

Buzëqeshja e Sulejmanit (Paqja qoftë mbi të!) **ndaj fjalës së milingonës dhe falënderimi i tij ndaj Zotit për këtë mirësi**

Rreth një shekull më parë, në Indi dhe Egjipt u shfaq një grup komentuesish të Kur'anit dhe intelektualësh të ndikuar nga mendimi materialist. Ata mohonin vlerat shpirtërore dhe morale, sepse ishin njohur me idetë evropiane të shekullit XIX dhe ishin

[1] Sure "En-Neml", ajei 16.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 4, f. 108.

magjepsur prej tyre. Për këtë arsye, ata përpiqeshin t'i shpjegonin të gjitha çështjet shpirtërore me një qasje thjesht materiale.

Mirëpo, nuk ka nevojë për këso lloj interpretimesh dhe justifikimesh materialiste, sepse përparimi shkencor ka zbuluar dhe vërtetuar shumë realitete, të cilat sot na ndihmojnë t'i kuptojmë më mirë temat që paraqet Kur'ani Famëlartë. Prandaj, disa prej tyre filluan të pretendojnë se vetëm tani i kishin kuptuar këto çështje.

Sidoqoftë, Kur'ani është i qartë dhe i prerë; në të nuk ka asnjë dyshim apo mangësi. Ne kemi besim të plotë në të, dhe pikërisht mbi këtë bazë i kuptojmë edhe temat shkencore që ai paraqet.

Pasi Sulejmani (Paqja qoftë mbi të!), i cili zotëronte një fuqi dhe autoritet të jashtëzakonshëm, dëgjoi fjalët e milingonës, ai buzëqeshi:

﴿فَتَبَسَّمَ ضَاحِكًا مِّن قَوْلِهَا﴾

"Dhe ai buzëqeshi duke qeshur nga fjalët e saj."[1]

Ky është një simbol shumë i bukur dhe domethënës. Milingona këtu përfaqëson dobësinë, vogëlsinë dhe pafuqinë, ndërsa Sulejmani (Paqja qoftë mbi të!) mishëron fuqinë njerëzore dhe madhështinë më të lartë. A mund të imagjinohet një fuqi dhe madhështi më e madhe se kjo?[2]

[1] Sure "En-Neml" ajeti 19.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 4, f. 112.

Mendjemadhësia dhe arroganca – ndër fatkeqësitë më të mëdha dhe më të rrezikshme

Gjëja më e rrezikshme për njeriun është të ndiejë se është i vetëmjaftueshëm, të mendojë se nuk ka nevojë për askënd, të mbështetet vetëm në aftësitë e veta dhe t'u besojë vetëm njohurive të tij.

Kur'ani i Shenjtë na sjell në këtë drejtim historinë e Karunit. Njerëzit e urtë e këshillonin, por ai u përgjigjej:

﴿إِنَّمَا أُوتِيتُهُ عَلَى عِلْمٍ﴾

"Kjo (pasuri) **më është dhënë vetëm falë dijes sime."**[1]

Me këtë ai donte të thoshte se pasuritë dhe thesaret që kishte grumbulluar ishin rezultat i dijes dhe aftësive të tij, dhe se ato i përkisnin vetëm atij.

Ky është pikërisht mashtrimi i mendjemadhësisë dhe i arrogancës; kjo është mburrja, kryelartësia dhe mbështetja tek vetja duke e harruar Allahun. Në të vërtetë, ajo që zotëron njeriu është shumë e pakët dhe e kufizuar, por ai e imagjinon si diçka të madhe dhe të jashtëzakonshme. Kjo mbështetje e pavarur te vetja, duke e konsideruar veten të pavarur nga Allahu, është një katastrofë e madhe dhe një fatkeqësi e rëndë për njeriun.[2]

[1] Sure "El-Kasas", ajeti 78.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 4, f. 115.

Edukimi dhe pastrimi i vetvetes – pika kyçe për reformimin e botës

Sipas Islamit dhe Kur'anit të Shenjtë, shtylla themelore dhe pika qendrore për reformimin e botës është reformimi i shpirtit të njeriut, sepse çdo gjë fillon prej këtu.

Prandaj, Kur'ani i drejtohet asaj dore të fuqishme që synon të ndryshojë historinë, duke thënë:

﴿قُوا أَنفُسَكُمْ﴾

"Ruajeni veten tuaj."[1]

Po ashtu thotë:

﴿عَلَيْكُمْ أَنفُسَكُمْ﴾[41]

"Kujdesuni për vetveten."[2]

Domethënë: kushtojini vëmendje vetes suaj, ruajeni atë, përpiquni ta reformoni dhe ta pastroni shpirtin tuaj, sepse Allahu i Madhëruar thotë:

﴿قَدْ أَفْلَحَ مَن زَكَّاهَا﴾[42]

"Me të vërtetë ka shpëtuar ai që e pastron atë (shpirtin)."[3]

---

[1] Sure "Et-Tahrim", ajeti 6.

[2] Sure "El-Maide", ajeti 105.

[3] Sure "Esh-Shems", ajeti 9.

Nëse shoqëria islame në periudhën e parë të Islamit nuk do ta kishte edukuar dhe pastruar vetveten, dhe nëse në atë shoqëri nuk do të kishte njerëz të sinqertë, të dëlirë, me zemër të pastër dhe ndërgjegje të pastër, Islami nuk do të kishte mundur të lindte, të zhvillohej dhe të përhapej. Ai nuk do të kishte arritur të triumfonte mbi sistemet e shirkut në botë dhe historia nuk do të kishte marrë drejtimin e Islamit. Po ashtu, nëse nuk do të kishte personalitete të pastra dhe të edukuar shpirtërisht, nuk do të kishte ekzistuar as xhihadi në rrugën e Allahut.[1]

Mishërimi i ajeteve të xhihadit në Revolucionin Islamik

Kur'ani i Shenjtë thotë se ai që lufton në rrugën e Allahut, në të vërtetë lufton për të mirën e vet:

﴿وَمَن جَاهَدَ فَإِنَّمَا يُجَاهِدُ لِنَفْسِهِ﴾

"E kush lufton (në rrugën e Allahut), **ai lufton vetëm për të mirën e vet."**[2]

Këto janë ajete hyjnore. Ne u besonim atyre edhe më parë, por të besosh është një gjë, ndërsa ta përjetosh dhe ta ndiesh është diçka tjetër.

Sot ne i ndiejmë dhe i përjetojmë këto ajete. Gjatë periudhës së lëvizjes revolucionare, pas fitores së Revolucionit Islamik, gjatë tetë viteve të luftës së imponuar, si dhe gjatë dy viteve pas

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 5, f. 84–85.

[2] Sure "El-Ankebut", ajeti 6.

përfundimit të luftës, pra në tërësi gjatë këtyre njëmbëdhjetë ose dymbëdhjetë viteve që nga lindja e Revolucionit Islamik, më 22 Bahman 1357 sipas kslendarit iranian, që përkon me 11 shkurt 1979, e deri në ditët tona, ne i kemi jetuar dhe i kemi përjetuar këto ajete hap pas hapi. Kjo do të thotë se populli ynë i kupton shumë mirë këto ajete, sepse i ka parë dhe i ka përjetuar ato në praktikë.[1]

Themelimi i shtetit dhe zbatimi i drejtësisë – qëllimi i synuar i feve hyjnore

Nëse dijetarët fetarë dhe ulemaja islame pranojnë se Kur'ani i Shenjtë thekson dhe thotë:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَا مِن رَّسُولٍ إِلَّا لِيُطَاعَ بِإِذْنِ اللَّهِ﴾

"Ne nuk kemi dërguar asnjë të dërguar, veçse që t'i bindet atij me lejen e Allahut."[2]

Kjo do të thotë se misioni i profetëve nuk ishte vetëm të jepnin këshilla dhe udhëzime, ndërsa njerëzit të vazhdonin jetën e tyre të zakonshme duke u treguar atyre vetëm respekt e nderim. Përkundrazi, ata u dërguan që t'u bindej njerëzimi, që ta udhëhiqnin shoqërinë dhe jetën drejt përsosurisë, të themelonin një rend dhe një qeveri, si dhe t'i drejtonin njerëzit drejt synimeve të larta të jetës.

[1] Cituar nga libri "Hadith el-Vilaje", vëll. 5, f. 162.

[2] Sure "En-Nisa", ajeti 64.

Po ashtu, nëse dijetarët e Islamit pranojnë se Kur'ani thotë:

﴿لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ﴾

"Ne i dërguam të dërguarit Tanë me argumente të qarta dhe me ta zbritëm Librin dhe Peshoren, që njerëzit të ngrihen për drejtësi."[1]

Qëllimi i feve hyjnore është vendosja e drejtësisë dhe barazisë, zhdukja e padrejtësisë dhe shtypjes, si dhe ndërtimi i një jete të denjë dhe të shëndoshë për njerëzimin. Prandaj, përpjekja dhe drejtimi duhet të jenë kah vendosja e sundimit të Islamit në qeverisje dhe në administrimin e shoqërisë. Kjo është një synim i mundshëm për vendet dhe shoqëritë islame.[2]

E gjithë bota është skenë dhe prani para Allahut të Madhëruar

Kur njeriu lexon disa ajete në Kur'anin e Shenjtë, ai përjeton një tronditje të fuqishme. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَقِفُوهُمْ إِنَّهُم مَّسْئُولُونَ﴾

"Ndali ata, sepse ata do të pyeten."[3]

Po, ndalini ata, sepse Zoti Madhështor nuk do t'u lejojë këtyre njerëzve të ecin më tej pa dhënë llogari. Në atë skenë të

[1] Sure "El-Hadid", ajeti 25.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 5, f. 244.

[3] Sure "Es-Saffat", ajeti 24.

jashtëzakonshme dhe madhështore, të gjitha veprat, lëvizjet, veprimet, fjalët dhe madje edhe mendimet që kemi pasur në këtë botë do të shfaqen përsëri dhe do të vendosen nën vëzhgimin hyjnor në botën tjetër:

﴿فَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ * وَمَن يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ﴾

"Kush bën një të mirë sa pesha e një thërrmije, do ta shohë atë; dhe kush bën një të keqe sa pesha e një thërrmije, do ta shohë atë."[1]

Domethënë, në Ditën e Kiametit ju do ta shihni të mirën dhe të keqen në realitetin dhe tërësinë e tyre të plotë. Do të shihni të njëjtën vepër që keni bërë, por tashmë të mishëruar dhe të gjallë para jush.

Çdo çast i jetës sonë ndodhet nën mbikëqyrjen e dijes së pakufishme dhe shikimit gjithëpërfshirës të Allahut të Madhëruar. Pikërisht këtë kuptim e ka shprehur edhe ajo figurë e veçantë e njohjes shpirtërore, e cila buronte nga vetëdija dhe shikimi i plotë i atij njeriu hyjnor dhe robit të devotshëm, imam Khomeinit (Allahu e mëshiroftë!), kur tha:

'Dynjaja është skenë dhe prani para Allahut.'

Ne tani jemi në praninë e Zotit tonë dhe Ai i di të gjitha hollësitë dhe anët e fshehta të mendimeve tona. Prandaj, ne që mbajmë përgjegjësi në shtetin islam duhet të jemi të vetëDitur për

[1] Sure "Ez-Zelzeletu", ajetet 7–8.

detyrën tonë në këtë fazë të ndjeshme dhe të përpiqemi me këmbëngulje për të kryer ato përgjegjësi dhe detyra.[1]

Përgatitja dhe vigjilenca në shkallën më të lartë të mundshme

Kjo çështje është përsëritur shumë herë në Kur'anin Famëlartë: domosdoshmëria e detyrës islame e kërkon që myslimani të jetë i vetëDitur, i përgatitur dhe i gatshëm.

Myslimani nuk duhet të zgjedhë heshtjen, qetësinë dhe mosveprimin derisa ta godasë rreziku, e pastaj të ngrihet i hutuar dhe me nxitim për të gjetur një zgjidhje ndaj kësaj apo asaj sfide. Përkundrazi, myslimani i vërtetë, sipas asaj që ka ardhur në Kur'an:

﴿وَأَعِدُّواْ لَهُم مَّا اسْتَطَعْتُم مِّن قُوَّةٍ وَمِن رِّبَاطِ الْخَيْلِ﴾

"Përgatitni kundër tyre sa të mundeni fuqi dhe kuaj të përgatitur për luftë."[2], e përgatit dhe e mobilizon veten në nivele të larta, në mënyrë që të jetë i aftë për t'u përballur paraprakisht me sfidat e mundshme.

Ne duhet ta kuptojmë urdhrin "Përgatituni kundër tyre" në kuptimin e tij të saktë dhe po kështu duhet ta zbatojmë atë praktikisht. Kjo sepse sistemi i Republikës Islamike dhe atdheu ynë i dashur përballen vazhdimisht me kërcënime. Ka sfida të pandërprera që shfaqen rreth nesh. Prandaj, duhet të jemi të

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 6, f. 46.

[2] Sure "El-Enfal", ajeti 60.

përgatitur nga ana ushtarake, së pari, ushtria dhe Gardat e Revolucionit, e më pas të gjitha shtresat e popullit.

Është detyrë e ushtrisë dhe e Gardave të Revolucionit që ta kryejnë këtë mision, i cili bie mbi ta nga aspekti i organizimit dhe strukturimit. Ndërsa mbështetja dhe mbrojtja e ushtrisë dhe e Gardave është detyrë e të gjithëve, veçanërisht e forcave të mobilizimit (Basixh), që nënkupton një trupë të forcave popullore të afta për të mbrojtur atdheun dhe sistemin.[1][53]

Ndjenja e mospasjes nevojë për Allahun – vuajtja dhe tragjedia më e madhe e njerëzimit

Që nga çastet e para të misionit profetik dhe zbritjes së shpalljes mbi të Dërguarin më të Madh (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka pasur një kujdes të veçantë nga ana e Allahut të Madhëruar, në ajetet kur'anore, lidhur me procesin e përmirësimit dhe reformimit të shoqërive njerëzore.

Për këtë mision të rëndësishëm u përgatitën të gjitha shkaqet dhe mjetet e nevojshme. Në Suren e bekuar "El-Alak, pas përmendjes së emrit të Allahut të Madhëruar dhe urdhrit drejtuar Profetit të nderuar (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për të lexuar, ajeti tregon:

﴿خَلَقَ الْإِنسَانَ مِنْ عَلَقٍ﴾

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 6, f. 66–67.

"Ai e krijoi njeriun nga një pikë e ngjitur (embrioni)."[1]

Ky njeri, i cili vuan nga sëmundjet dhe plagët më të mëdha shpirtërore, si egoizmi, rebelimi, mendjemadhësia dhe ndjenja e të qenit i pavarur nga Allahu, Kur'ani e kujton duke i thënë: **"E krijoi njeriun nga një pikë e ngjitur."** Domethënë: burimi yt i parë dhe origjina jote ishte diçka e dobët dhe e varur. Allahu është Ai që të dha ekzistencën, përsosurinë, nderin dhe dinjitetin.

Prandaj, ndaj Tij duhet të ndjesh gjithmonë robërinë dhe përulësinë; nuk duhet të tregohesh arrogant ndaj të tjerëve, nuk duhet të rebelohesh kundër vlerave hyjnore dhe nuk duhet ta imagjinosh veten sikur je ulur në vendin e fuqisë së Allahut të Madhëruar, duke marrë përsipër drejtimin dhe udhëheqjen e botës njerëzore sipas dëshirave të tua. Kjo është fjala e parë që sjell Surja "El-Alak" pas dy ose tre ajeteve të para të saj, ku Allahu thotë:

﴿كَلَّا إِنَّ الْإِنسَانَ لَيَطْغَى * أَن رَّآهُ اسْتَغْنَى﴾

"Jo! Me të vërtetë njeriu bëhet kryengritës, sepse e sheh veten të pavarur."[2]

Pra, kur njeriu e sheh veten të pasur dhe ndien se nuk ka nevojë për askënd, kjo patjetër e çon atë drejt arrogancës dhe tejkalimit të kufijve.[3]

[1] Sure "El-Alak", ajeti 2.

[2] Sure "El-Alak", ajetet 6–7.

[3] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 6, f. 233–234.

Jeta do të thotë xhihad dhe lëvizje

Në Kur'anin e Shenjtë gjendet një ajet ku Allahu i Madhëruar i drejtohet Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), duke thënë:

﴿لِيُنذِرَ مَن كَانَ حَيًّا﴾

"Që të paralajmërojë atë që është i gjallë."[1]

Domethënë, paralajmërimi dhe këshillimi ndikojnë vetëm te ata që kanë shpirtra dhe zemra të gjalla. Kjo jetë dhe gjallëri nuk arrihet veçse përmes përpjekjes, lëvizjes, ringritjes dhe xhihadit në shoqëri.

Disa komentues të Kur'anit, në shpjegimin e ajetit:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُواْ اسْتَجِيبُواْ لِلّهِ وَلِلرَّسُولِ إِذَا دَعَاكُم لِمَا يُحْيِيكُمْ﴾

"O ju që besuat! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ai ju thërret në atë që ju jep jetë..."[2] thonë, dhe ndoshta ky mendim është i mbështetur në një transmetim, se shprehja: **"në atë që ju jep jetë"** ka për qëllim xhihadin. Sot, falë përpjekjes së përgjithshme dhe shpirtit të xhihadit që është përhapur mes popullit, kjo "jetë" e nderuar ekziston edhe në mesin e popullit tonë.

Pikërisht për këtë arsye shohim se procesi i paralajmërimit dhe i këshillimit ka një ndikim më të madh në zbatim. Nëse kuptimi i shprehjes: "në atë që ju jep jetë..." është Kur'ani, atëherë sot

[1] Sure "Ja-Sin", ajeti 70.

[2] Sure "El-Enfal", ajeti 24.

shohim se Kur'ani është bërë i pranishëm dhe i gjallë në shoqërinë tonë; populli është njohur dhe është afruar, deri në një masë, me Kur'anin e Shenjtë. Për këtë arsye, paralajmërimi dhe udhëzimi do të kenë ndikim më të madh dhe efektivitet më të lartë në praktikë.[1]

Marrja e mësimit dhe reflektimi nga ngjarjet e betejës së Uhudit, në dritën e Kur'anit

Kur'ani i Shenjtë, në lidhje me betejën e Uhudit, na ka dhënë një mësim të madh që përfshin të gjitha periudhat dhe kohët. Përmbledhja e çështjes është se Allahu i Madhëruar u premtoi myslimanëve se do t'i mbështeste dhe do t'i ndihmonte në këtë betejë. Pastaj ky premtim u realizua në të vërtetë gjatë asaj beteje:

﴿وَلَقَدْ صَدَقَكُمُ اللهُ وَعْدَهُ﴾

"Vërtet, Allahu e përmbushi premtimin e Tij ndaj jush."[2]

Po, premtimi u realizua dhe myslimanët arritën fitore e epërsi, ndërsa armiku u detyrua të tërhiqej prapa. Por problemi filloi nga vetë radhët e myslimanëve.

Pikërisht për këtë arsye, Kur'ani na mëson se duhet t'i kërkojmë falje Allahut për mangësitë dhe tejkalimet tona në çështjet tona:

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 6, f. 307.

[2] Sure "Ali Imran", ajeti 152

﴿رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا فِي أَمْرِنَا﴾

"O Zoti ynë, na fal gjynahet tona dhe teprimin tonë në çështjet tona."[1]

Besimtarët gabuan në betejën e Uhudit, pasi Allahu u kishte treguar atyre shenjat e para të fitores:

﴿مِّن بَعْدِ مَا أَرَاكُم مَّا تُحِبُّونَ﴾

"Pasi Ai ju tregoi atë që e dëshironit."[2]

Mirëpo, megjithatë, ata ishin besimtarë në Allahun e Madhëruar dhe nuk e humbën shpresën nga mëshira dhe ndihma e Tij. Për shkak se i donin qëllimet e larta të Islamit dhe sepse ishin të sinqertë në besimin e tyre ndaj Allahut, Allahu u tha:

﴿وَلَقَدْ عَفَا عَنكُمْ﴾

"Dhe Ai ju fali juve."

Domethënë, Ai ju fali, ju kapërceu gabimin tuaj dhe do t'ju mbështesë:

﴿وَاللهُ ذُو فَضْلٍ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ﴾

"Dhe Allahu është plot mirësi ndaj besimtarëve."[3]

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 147.
[2] Sure "Ali Imran", ajeti 152.
[3] Sure "Ali Imran", ajeti 152.

Ky është mësimi i fuqishëm dhe ndikues që na jep beteja e Uhudit.[1]

Çfarë do të thotë falënderimi për mirësinë (begatinë)?

Shikoni se si Kur'ani i Shenjtë i kushton rëndësi të madhe dijes, meditimit, reflektimit dhe marrjes së mësimit nga e kaluara. Po ashtu, vëreni se sa shumë rëndësi i jep Kur'ani falënderimit për mirësitë dhe njohjes së vlerës së tyre.

Por çfarë do të thotë falënderimi për mirësinë? Qëllimi i falënderimit për mirësinë është që së pari ta njohim dhe ta kuptojmë mirësinë me të cilën Allahu na ka begatuar, pastaj ta përdorim dhe ta shfrytëzojmë atë në mënyrën më të mirë, në përputhje me urtësinë dhe qëllimin për të cilin Allahu i Madhëruar e ka caktuar atë.[2][66]

Debati i ithtarëve të së vërtetës me argumente të qarta ndaj prijësve të mohimit dhe ateizmit

Shprehja kur'anore:

﴿إِنَّا إِلَيْكُم مُّرْسَلُونَ﴾

"Ne jemi dërguar tek ju"[3], mbështetet në përmbledhje dhe shkurtësi, sepse profetët nuk sollën diçka tjetër përveç këtij mesazhi: **"Ne jemi dërguar tek ju."**

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 7, f. 249–250.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 8, f. 36.

[3] Sure "Ja-Sin", ajeti 16.

Për shembull, çështja nuk ishte se të tre këta profetë[1] i mblodhën njerëzit në qytetin e Antakias[2], pastaj u mbajtën një fjalim dhe u thanë: "Ne jemi dërguar tek ju." Jo, por kjo shprehje u përcoll në të njëjtën mënyrë siç iu drejtua imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!) botës gjatë dhjetë viteve që jetoi pas fitores së Revolucionit Islamik. Mesazhi i imam Khomeinit (Allahu e mëshiroftë!) nuk ishte gjë tjetër përveç: "Ne jemi dërguar tek ju", domethënë: 'O njerëz të pavëmendshëm dhe të zhytur në harresë! O njeri që je robëruar nga disa familje dhe qarqe të kufizuara politike, ekonomike dhe industriale në botë! O popuj të shtypur dhe të përbuzur! Ne kemi ardhur t'ju shpëtojmë; kemi ardhur të flasim me ju.'

Ky ishte mesazhi i Imam Khomeinit (Allahu e mëshiroftë!, të cilin ai e përsëriste gjatë dhjetë viteve duke thënë: "Ne jemi dërguar tek ju." Ndoshta edhe profetët e përdornin këtë shprehje gjatë gjithë misionit të tyre profetik në këtë kuptim. Pra, nuk ishte thjesht një shprehje kalimtare, por një mesazh i madh dhe i vazhdueshëm.

Kundërshtarët, nga ana tjetër, i përgënjeshtronin, talleshin dhe i përçmonin profetët. Ata i refuzonin fjalët e tyre dhe sillnin justifikime duke thënë:

﴿قَالُوا مَا أَنتُمْ إِلَّا بَشَرٌ مِّثْلُنَا وَمَا أَنزَلَ الرَّحْمَٰنُ مِن شَيْءٍ إِنْ أَنتُمْ إِلَّا تَكْذِبُونَ﴾

[1] Aludim për përmbajtjen e ajetit nr. 14 të sures "Ja-Sin": "Kur Ne u dërguam atyre dy të dërguar, por ata i përgënjeshtruan të dy; atëherë Ne i përforcuam me një të tretë…".

[2] Qytet në Turqinë e sotme, që shtrihet buzë Detit të Rumit; në periudhat e kaluara ka qenë kryeqytet i Seleukidëve (mbretër të Iranit).

"Ata thanë: Ju nuk jeni veçse njerëz si ne; Mëshiruesi nuk ka zbritur asgjë; ju vetëm gënjeni."[1]

Ata pyesnin: 'Cila është fjala juaj e re për njerëzimin?! Ju jeni si gjithë njerëzit e tjerë. Ju po paraqisni vetëm një teori fetare islame që ju përket juve dhe po përsërisni fjalë që janë vetëm tuajat.'

Kjo ishte pikërisht e njëjta mënyrë e të folurit që përdorën gjithmonë prijësit e mohimit dhe të ateizmit të errët e të fatkeq në botë kundër Revolucionit Islamik, imam Khomeinit (Allahu e mëshiroftë!) dhe thirrësve të së vërtetës, të cilët ngritën lart flamujt e së vërtetës.

﴿قَالُوا مَا أَنتُمْ إِلَّا بَشَرٌ مِّثْلُنَا وَمَا أَنزَلَ الرَّحْمَٰنُ مِن شَيْءٍ إِنْ أَنتُمْ إِلَّا تَكْذِبُونَ * قَالُوا رَبُّنَا يَعْلَمُ إِنَّا إِلَيْكُمْ لَمُرْسَلُونَ * وَمَا عَلَيْنَا إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ﴾

"Ata thanë: 'Ju nuk jeni veçse njerëz si ne dhe i Gjithëmëshirshmi nuk ka zbritur asgjë; ju vetëm gënjeni.' Ata thanë: 'Zoti ynë e di se ne jemi dërguar tek ju. Dhe detyra jonë është vetëm të përcjellim qartë mesazhin.'"[2]

Kjo tregon një përpjekje tjetër intelektuale dhe bindëse nga ana e profetëve. Ata thonë: Ne mbështetemi në vlera dhe në gjëra të shenjta dhe ju themi se nuk flasim veçse për dobinë dhe të mirën tuaj. Ne jemi të dërguarit e Allahut të Madhëruar dhe kemi një mesazh e një bisedë me ju. Kthehuni tek ndërgjegjja juaj, shikoni në fetë tuaja të mëparshme dhe pyetni dijetarët tuaj, ata që kanë

[1] Sure "Ja-Sin", ajeti 15.

[2] Sure "Ja-Sin", ajetet 15, 16 dhe 17.

ndërgjegje të gjallë dhe zemra të vetëdijshme, nëse mes jush gjenden njerëz të tillë.[1]

Dijetarët e robëruar – të rëndomtit në tokë

Nëse një dijetar i njohur dhe i vetëDitur është prej atyre që kërkojnë rehati, jetë të begatë dhe ndjekin dëshirat e epshit, atëherë rreziku dhe dëmi i tij do të jenë më të mëdha, ndërsa rrëshqitja dhe devijimi i tij do të jenë më të rënda dhe më të rrezikshme se te njerëzit e tjerë.

Allahu i Madhëruar na ka sjellë në Kur'an shembullin e Bel'am Baura-së, duke thënë:

﴿وَلَكِنَّهُ أَخْلَدَ إِلَى الْأَرْضِ وَاتَّبَعَ هَوَاهُ﴾

"Por ai u lidh pas tokës dhe ndoqi dëshirën e vet."[2]

Ky person ishte i njohur me njohuritë hyjnore, por u lidh pas kësaj bote; domethënë u kap pas kënaqësive të përkohshme të jetës së kësaj bote, pas ushqimeve të shijshme, pas jetës së ulët materiale dhe dëshirave të tij epshore. Përfundimi i kësaj sjelljeje ishte se ai ra në poshtërim, turpërim dhe humbje.[3]

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 8, f. 39–40.

[2] Sure "El-A'raf", ajeti 176.

[3] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 8, f. 137–138.

Në fund, fitorja dhe triumfi i takojnë vlerave hyjnore

Kur'ani i Shenjtë u premton qartë besimtarëve:

﴿لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ كُلِّهِ﴾

"Që ta bëjë atë (fenë e Tij) **mbizotëruese mbi të gjitha fetë."**[1]

Kur'ani e ka theksuar në forma të ndryshme se kjo e vërtetë dhe këto vlera hyjnore në historinë e njerëzimit do të triumfojnë dhe do të fitojnë mbi vlerat e zbehta e të dështuara, ose mbi vlerat negative dhe të degjeneruara.

Për këtë arsye, Kur'ani deklaron:

﴿وَالْعَاقِبَةُ لِلْمُتَّقِينَ﴾

"Përfundimi i mirë u takon të devotshmëve."[2]

Pra, përfundimi i dëshiruar dhe fati i fundit u takon besimtarëve dhe njerëzve të devotshëm.

Atëherë, si mundet Islami, nëse do të ishte i kufizuar në skaj të jetës dhe i izoluar nga realiteti, të fitojë dhe të triumfojë mbi teoritë boshe, bindjet e imponuara dhe vlerat e ulëta që kanë pushtuar me forcë njerëzimin e shtypur?[3]

---

[1] Sure "Et-Teube", ajeti 33.

[2] Sure "El-A'raf", ajeti 128.

[3] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 8, f. 142.

Vepra e mirë pas besimit në Allahun e Madhëruar

Ne duhet ta kënaqim Allahun e Madhëruar përmes veprave tona të mira dhe ta pastrojmë veten tonë me to. Vepra dhe përmirësimi janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën; nuk ka përmirësim pa vepër.

Kur'ani e përmend veprën e mirë pas besimit. Edhe nëse besimi, siç ka ardhur në disa transmetime, është vetë vepra: "Besimi është vepër", atëherë ai është vepër e gjymtyrëve dhe e zemrës; është vullneti dhe vendosmëria që njeriu e vendos mbi zemrën dhe shpirtin e tij.

Në disa raste, madje ndoshta gjithmonë, vullneti dhe vendosmëria janë më të vështira dhe më të rënda se puna me gjymtyrë dhe pjesët e trupit. Shpesh vështirësia e vërtetë qëndron pikërisht këtu: që njeriu duhet të veprojë duke qëndruar i përkushtuar në rrugën e mirësisë, përmirësimit dhe shpëtimit.[1]

Xhihadi dhe sakrifica nuk mund të vazhdojnë pa devotshmërinë ndaj Allahut të Madhëruar

Kur'ani i Shenjtë flet për muxhahidët të cilët janë plagosur në luftëra dhe beteja, dhe kjo është një çështje shumë madhështore. Besimtari shkon në fushën e përballjes, lufton në rrugën e Allahut dhe më pas plagoset; si këta të dashur sakrifikues dhe të plagosur nga lufta e imponuar.

[1] Po aty, f. 37.

Kur'ani thotë:

﴿الَّذِينَ اسْتَجَابُواْ لِلّهِ وَالرَّسُولِ مِن بَعْدِ مَآ أَصَابَهُمُ الْقَرْحُ لِلَّذِينَ أَحْسَنُواْ مِنْهُمْ وَاتَّقَواْ أَجْرٌ عَظِيمٌ﴾

"Ata të cilët iu përgjigjën thirrjes së Allahut dhe të Dërguarit, edhe pasi i goditën plagët; për ata prej tyre që bënë mirë dhe u ruajtën (nga gjynahet), **ka shpërblim të madh."**[1]

Pra, nëse ata vazhdojnë të bëjnë mirë dhe e ruajnë devotshmërinë në vetvete, kjo shpërblim i madh do të mbetet për ta dhe ajo mirësi e madhe do t'u takojë gjithmonë. Por në të kundërtën, nëse supozojmë se njeriu e kryen detyrën e tij në xhihad, arrin ato vlera shpirtërore dhe morale, por, (Allahu mos e bëftë!) nuk punon për t'i ruajtur dhe mbrojtur ato vlera të çmuara, atëherë kjo është humbja e vërtetë.

Cili është faktori dhe nxitësi që mund t'i ruajë për ne këto vlera? Devotshmëria (tekvaja) është faktori kryesor dhe shkaku i vërtetë. Për këtë arsye, shohim se kujtesa për devotshmërinë përmendet vazhdimisht në namazin e xhumasë dhe në çdo sure të Kur'anit, në mënyrë që të mos e harrojmë atë.

Madje, përmendja e devotshmërisë vjen që në fillim të Kur'anit:

﴿ذَلِكَ الْكِتَابُ لاَ رَيْبَ فِيهِ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ﴾

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 172.

"Ky është Libri, në të cilin nuk ka dyshim; është udhëzim për të devotshmit."[1] [2]

Pikëpamja e Kur'anit të Shenjtë ndaj historisë dhe rëndësia e saj

Nëse historia nuk do të ishte një çështje themelore, Kur'ani i Shenjtë, i cili është një libër që programon edukimin e njeriut dhe të njerëzimit, nuk do ta kishte përfshirë atë në përmbajtjen e tij.

Ndërkohë, ju vëreni se çështjet historike janë të pranishme në Kur'an. Natyrisht, ato janë pjesë të zgjedhura nga historia, të cilat janë përdorur për t'u shërbyer qëllimeve të Kur'anit.

Në fund duhet të themi se njeriu i mençur dhe i urtë zgjedh nga gjërat që gjenden përpara tij ato që i sjellin dobi. Po kështu edhe Kur'ani i Shenjtë zgjedh atë që e sheh të dobishme dhe të vlefshme për njerëzimin.

Për këtë arsye, vërejmë se në disa raste ai nuk hyn në hollësi, sepse detajet dhe çështjet dytësore nuk kanë dobi për qëllimin e tij.

Për shembull, në çështjen e gruas së Faraonit, thelbi është se ajo ishte "një grua", madje "gruaja e Faraonit". Për këtë arsye, Kur'ani e përmend atë si gruan e Faraonit dhe thekson se këtë vepër e bëri gruaja e Faraonit dhe këto fjalë i tha gruaja e Faraonit. Pra, Kur'ani i Shenjtë nuk e kalon personalitetin e saj pa vëmendje,

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 2.

[2] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 8, f. 127–128.

megjithëse çështja e emrit dhe hollësive të saj është një çështje dytësore.[1]

Po kështu është edhe çështja e besimtarit që përmendet në Suren "Jasin":

﴿وَجَاء مِنْ أَقْصَى الْمَدِينَةِ رَجُلٌ يَسْعَى﴾

"Dhe nga skaji më i largët i qytetit erdhi një burrë duke nxituar."[2]

Kush ishte ky njeri? Sa vjeç ishte? Nga cili qytet ishte? Në cilën shtresë shoqërore bënte pjesë?

Këto nuk janë aspak të rëndësishme, sepse Kur'ani nuk përqendrohet në to në këtë rast. Ajo që Kur'ani e vë në pah është se një burrë erdhi nga skaji i qytetit duke nxituar, për të arritur te njerëzit e mbledhur në qendër të qytetit dhe për t'u thënë:

﴿يَا قَوْمِ اتَّبِعُوا الْمُرْسَلِينَ﴾

"O populli im! Ndiqni të dërguarit!"[3]

Pra, Kur'ani zgjedh nga historia atë pjesë që i nevojitet, pastaj e përdor atë dhe e paraqet me formën më të bukur dhe me shprehjen më të ëmbël. Por ai nuk merret me hollësitë dhe imtësitë, përveçse kur këto hollësi janë të rëndësishme dhe të dobishme për qëllimin e tij. Prandaj, historia është e rëndësishme dhe nuk mund

[1] Aludim për suren "El-Kasas", ajeti 9, dhe suren "Et-Tahrim", ajeti 11.

[2] Sure "Ja-Sin", ajeti 20.

[3] Sure "Ja-Sin", ajeti 20.

të anashkalohet rëndësia e saj, sepse ajo është burim mësimi dhe këshillimi.[1]

Pionierët e ndërtimit dhe të zhvillimit

Një popull që pajtohet me Allahun e Madhëruar dhe nuk e harron përgjërimin dhe kërkimin e ndihmës prej Tij, do të jetë pionier në rindërtimin dhe zhvillimin e vendit të tij dhe në tokën e vet. Për një popull të tillë, ky ndërtim dhe zhvillim do të jetë më i lehtë:

﴿وَيَا قَوْمِ اسْتَغْفِرُواْ رَبَّكُمْ ثُمَّ تُوبُواْ إِلَيْهِ يُرْسِلِ السَّمَاء عَلَيْكُم مِّدْرَارًا وَيَزِدْكُمْ قُوَّةً إِلَى قُوَّتِكُمْ﴾

"O populli im! Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe pendohuni tek Ai; Ai do t'ju dërgojë shi të bollshëm nga qielli dhe do t'ju shtojë fuqi mbi fuqinë tuaj."[2]

Kështu na mëson Kur'ani. Ai na mëson kërkimin e faljes dhe kthimin tek Allahu i Madhëruar, respektimin e urdhrave dhe ndalesave të Allshut, ruajtjen e dëlirësisë, devotshmërisë dhe sinqeritetit, shpirtin e vëllazërisë dhe barazisë, mirësinë ndaj të dobëtëve dhe të privuarve, përulësinë ndaj vëllezërve dhe motrave myslimanë, ndihmën ndaj nevojtarëve, adhurimin e Krijuesit të Madhëruar, kryerjen e namazeve vullnetare, leximin e Kur'anit, lutjen, kërkimin e ndërmjetësimit dhe përgjërimin ndaj Allahut të Madhëruar.

[1] Cituar nga libri "Hadithul-Uilaje", vëll. 8, f. 219.

[2] Sure "Hud", ajeti 52.

Nëse këto cilësi gjenden në një vend dhe te një popull, dhe nëse shoqërohen edhe me faktorin e dytë, që është përpjekja dhe xhihadi, atëherë asgjë dhe askush në botë nuk do të mund ta pengojë lëvizjen dhe ngritjen e këtij populli në rrugën e lumturisë, të përmirësimit dhe të shpëtimit. Prandaj, kini kujdes dhe dijeni se periudha e rindërtimit dhe e zhvillimit është në të njëjtën kohë me periudhën e xhihadit më të madh. Periudha e ndërtimit të vetvetes, e luftës kundër shejtanit, e përballjes me egon urdhëruese për të keq dhe e pendimit tek Allahu i Madhëruar.[1].

Lëvizja kulturore që ndërmori Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) **kundër hebrenjve**

Nëse ju i kushtoni vëmendje pjesës më të madhe të Sures "El-Bekare" dhe disa sureve të tjera në Kur'anin e Shenjtë, do të vëreni se aty paraqitet një përballje, konflikt dhe luftë kulturore e Profetit të nderuar (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) me hebrenjtë.

Hebrenjtë zotëronin ndikim kulturor dhe kishin disa njohuri, siç kemi përmendur më parë, dhe përmes tyre ndikonin shumë në mendimet dhe bindjet e njerëzve të dobët. Ata thurnin komplote, planifikonin trazira, përhapnin frymën e dëshpërimit dhe dështimit mes njerëzve dhe punonin për të krijuar hipokrizi dhe përçarje mes tyre. Këta ishin kundërshtarë të organizuar.

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik (Allahu e mëshiroftë!) në ditën e parë të vizitës së tij në qytetin Sari, në veri të Iranit; 22/7/1374 sipas kalendarit iranian, përkatësisht 14/9/1995.

Profeti Muhamef (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) sillej me ta me durim dhe tolerancë në masën më të madhe të mundshme. Por kur pa se ata nuk e vlerësonin këtë mirëkuptim dhe këtë sjellje të butë, ai u përball me ta dhe i ndëshkoi.

Megjithatë, Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk u drejtua kundër tyre pa arsye dhe pa paralajmërim paraprak. Përkundrazi, secila prej tri fiseve të njohura hebraike kishte kryer një gabim dhe shkelje të rëndë, dhe për këtë arsye Profeti i trajtoi dhe i ndëshkoi sipas veprës dhe krimit të tyre.[1]

Hipokrizia është gjuha që flet për Islamin, por është edhe zemra e zbrazët prej tij

Armiku më i rrezikshëm dhe "kolona e pestë" është ai armik që strehohet në zemrat e myslimanëve dhe besimtarëve. Ky është armiku që paraqet sfidën më të madhe se të gjithë armiqtë e tjerë, sepse ai banon brenda nesh dhe ushqehet nga dëshirat tona egoiste, vetëdashuria, prirja drejt devijimit, humbjes së udhës dhe rrëshqitjeve morale, të cilat ne vetë ua hapim rrugën.

Për këtë arsye, edhe i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) e luftoi këtë armik.

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit (Allahu e mëshiroftë!) në dy hytbet e namazit të xhumasë në Teheran; 28/2/1380 sipas kalendarit iranian, përkatësisht 17/4/2001.

Mirëpo, lufta kundër tij nuk bëhej me shpatë, por me edukim, pastrim shpirtëror, mësim, këshillë dhe paralajmërim.

Prandaj, Profeti u tha shokëve të tij, pasi u kthyen nga vështirësitë dhe mundimet e një lufte të rëndë: *"Ju u kthyet nga xhihadi i vogël; tani ju mbetet xhihadi i madh."* Ata e pyetën: 'O i Dërguari i Allahut! Si është e mundur? Ne sapo kaluam një luftë të ashpër dhe një xhihad të madh, duke përballuar shumë vështirësi. A ekziston vallë një xhihad edhe më i madh se ky?' Ai u përgjigj: *"Po, ai është lufta kundër vetvetes."*[1]

Kur Kur'ani thotë: "Ata, në zemrat e të cilëve ka sëmundje…", duhet ta dimë se këta nuk janë domosdoshmërisht hipokritë. Edhe pse disa hipokritë përfshihen në këtë ajet, jo të gjithë ata që kanë sëmundje në zemër janë hipokritë. Njeriu mund të jetë besimtar, por njëkohësisht të ketë zemër të sëmurë.

Po çfarë është kjo sëmundje? Ajo është dobësia morale, karakteri i brishtë, marrëzia dhe nxitimi pas epsheve e dëshirave të ndryshme. Nëse njeriu nuk i kundërvihet këtyre prirjeve dhe nuk lufton kundër tyre, ato do t'ia rrëmbejnë besimin dhe do ta lënë të zbrazët nga brenda.

Kur besimi të jetë vjedhur nga zemra, zemra mbetet pa iman, ndërsa pamja e jashtme vazhdon të mbajë ngjyrën e besimit. Pikërisht një njeri i tillë quhet hipokrit (munafik). Nëse (Zoti na ruajtë!) zemrat tona zbrazen nga besimi dhe vetëm pamja jonë e jashtme dëshmon për të, atëherë ne kemi humbur lidhjen dhe përkushtimin tonë të vërtetë ndaj besimit. Megjithatë, gjuha jonë do

[1] Përmbajtja e hadithit.

të vazhdojë të shqiptojë të njëjtat fjalë të besimit që dikur i thoshim me sinqeritet. Kjo është hipokrizia, e cila përbën një rrezik të madh për personalitetin dhe qenien e njeriut.

Kur'ani i Shenjtë thotë:

﴿ثُمَّ كَانَ عَاقِبَةَ الَّذِينَ أَسَاؤُوا السُّوأَى أَن كَذَّبُوا بِآيَاتِ اللَّهِ﴾

"Pastaj përfundimi i atyre që bënë vepra të këqija ishte më e keqja: ata i përgënjeshtruan argumentet e Allahut."[1]

Kush vepron keq, nuk korr veçse një të keqe edhe më të madhe. Cila është kjo "më e keqe"? Ajo është përgënjeshtrimi i ajeteve të Allahut.

Në një vend tjetër, Kur'ani thotë:

﴿فَأَعْقَبَهُمْ نِفَاقًا فِي قُلُوبِهِمْ إِلَى يَوْمِ يَلْقَوْنَهُ بِمَا أَخْلَفُوا اللَّهَ مَا وَعَدُوهُ﴾

"**Si pasojë, Ai bëri që hipokrizia të zërë vend në zemrat e tyre deri në ditën kur do ta takojnë Atë, sepse e shkelën premtimin që i kishin dhënë Allahut."**[2]

Ata që nuk e mbartën këtë përgjegjësi të madhe mbi supet e tyre, nuk shpenzuan në rrugën e Allahut dhe nuk vepruan sipas asaj që u kërkohej, do ta lejojnë hipokrizinë të hyjë në zemrat e tyre, sepse e thyen besëlidhjen dhe premtimin që kishin bërë me Allahun e Madhëruar.

[1] Sure "Err-Rrum", ajeti 10.

[2] Sure "Et-Teube", ajeti 77.

Ky është rreziku dhe kërcënimi më i madh për shoqërinë islame në çdo periudhë të historisë. Sa herë që e shihni shoqërinë islame të devijojë nga rruga e drejtë, dijeni se shkaku kryesor i këtij devijimi është pikërisht ky.

Armiku i jashtëm mund ta sulmojë shoqërinë, t'i shtypë, t'i shkatërrojë, t'i mposhtë dhe t'i shpërndajë myslimanët, por ai nuk mund t'i zhdukë përfundimisht. Besimi do të mbetet gjithmonë i gjallë. Ai do të ngrejë kokën diku dhe do të rilindë përsëri në një vend tjetër. Por, kur pushtuesi është armiku i brendshëm i vetë njeriut, ai e sulmon nga brenda dhe e zbraz zemrën e tij nga besimi. Atëherë njeriu humbet, devijon nga rruga e drejtë, dhe kudo që të shfaqen humbja dhe devijimi, ato e kanë zanafillën pikërisht në këtë pikë. Prandaj shohim se të gjithë profetët (Paqja qoftë mbi ta!) e luftuan me vendosmëri këtë armik të brendshëm dhe tejet të rrezikshëm.[1]

Marrja e mësimit dhe këshillimi nga ngjarjet dhe ndikimi i tyre në përmirësimin dhe lumturinë e popujve dhe të shoqërive

Në Kur'anin e Shenjtë gjenden shumë ajete që theksojnë rëndësinë e nxjerrjes së mësimeve nga ngjarjet. Allahu i Madhëruar thotë: **"Me të vërtetë, në këtë ka mësim."**

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik (Allahu e mëshirotë!) në dy hytbet e namazit të xhumasë në Teheran; 28/2/1380 sipas kalendarit iranian, 18/5/2000.

Po ashtu thotë:

﴿فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِي الْأَبْصَارِ﴾

"Prandaj merrni mësim, o ju që keni largpamësi!"[1]

Ky mësim dhe kjo këshillë nuk nënkuptojnë vetëm që njeriu, përmes përvojave të jetës, të përmirësojë dhe të rregullojë jetën e tij të shkurtër në këtë botë. Përkundrazi, ky mësim është në gjendje ta rregullojë dhe ta garantojë jetën e kësaj bote, ndërsa në një shkallë edhe më të lartë, ai siguron edhe jetën e Botës Tjetër.

Jeta e vërtetë është ajo e Ahiretit. Kjo jetë kalon shumë shpejt, sikur të mbyllej në një çast. Prandaj, jeta tjetër është themeli dhe realiteti i përhershëm. Menjëherë pas largimit të njeriut nga kjo botë e deri në Ditën e Madhe të Kijametit, ai do të jetojë një jetë të mbushur ose me lumturi, qetësi dhe shpëtim, ose me vuajtje dhe mjerim.

Sa shumë përpiqet dhe lodhet njeriu në këtë botë për të fituar vetëm një çast gëzimi e kënaqësie! Atëherë ai duhet të jetë edhe më i gatshëm të bëjë përpjekje dhe sakrifica më të mëdha për të arritur lumturinë dhe gëzimin e përjetshëm. E gjithë kjo mund të sigurohet përmes marrjes së mësimit (*ibretit*). Pikërisht për këtë arsye, Kur'ani i Shenjtë e thekson kaq shumë rëndësinë e nxjerrjes së mësimeve nga ngjarjet e kësaj bote.

Në këtë drejtim është shumë domethënëse edhe fjala e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!) në "Nehxhul Belaga", ku thotë: *"Ai të cilit*

[1] Sure "El-Hashr", ajeti 2.

mësimet e historisë dhe fatkeqësive që ka përpara ia zbulojnë të vërtetën, devotshmëria (tekvaja) do ta pengojë të hidhet në gjërat e dyshimta."[1]

Pra, njeriu që i sheh fatkeqësitë, sprovat, ngjarjet e mëdha dhe vështirësitë e jetës me sy mësimi dhe reflektimi, do të fitojë një devotshmëri që e mbron nga veprat e këqija, nga sjelljet e shëmtuara dhe nga çdo gjë që e çon drejt mjerimit dhe humbjes në jetë. Madje, ai do të shmangë edhe gjërat e dyshimta, qoftë në fjalë apo në vepra.

Mosbërja e kompromisit me armiqtë – një shtyllë e fortë e qeverisjes dhe e udhëheqjes islame

Të gjitha temat që i përmendëm, madje edhe shumëfish më tepër se kaq, janë përmbledhur nga Allahu i Madhëruar në një fjali të vetme në Kur'anin Famëlartë:

﴿وَلَا تَهِنُوا وَلَا تَحْزَنُوا وَأَنتُمُ الْأَعْلَوْنَ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ﴾

"Mos u ligështoni dhe mos u trishtoni, sepse ju do të jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë."[2]

Ndërsa në një ajet tjetër thotë:

[1] Fjalimi i Udhëheqësit (Allahu e ruajtë!) në takimin e tij me komandantët dhe përgjegjësit e Gardës së Revolucionit Islamik; 29/6/1374 sipas kalendarit iranian, 20/9/1995.

[2] Sure "Ali Imran", ajeti 139.

﴿فَلَا تَهِنُوا وَتَدْعُوا إِلَى السَّلْمِ﴾

"Prandaj mos u dobësoni e të kërkoni paqe (nga dobësia)."[1]

Kur'ani i paralajmëron myslimanët të mos bien në plogështi, dobësi dhe të mos kërkojnë pajtim apo kompromis me armiqtë, as t'i përgjigjen thirrjeve për kompromise me armikun e betuar dhe kundërshtarin e pamëshirshëm. Ndërkaq, pajtimi dhe shmangia e armiqësisë me njerëzit e zakonshëm e të mirë, madje edhe me ata që nuk ju duan, por nuk ju janë armiq, është i pranueshëm. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿لَا يَنْهَاكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقَاتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُم مِّن دِيَارِكُمْ أَن تَبَرُّوهُمْ وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ﴾

"Allahu nuk ju ndalon të silleni me mirësi dhe drejtësi ndaj atyre që nuk ju kanë luftuar për shkak të fesë dhe nuk ju kanë dëbuar nga shtëpitë tuaja."[2]

Nuk lejohet të bëhen kompromise me ata që në thelb e mohojnë ekzistencën tuaj, kundërshtojnë besimin tuaj, qeverisjen tuaj islame dhe udhëheqjen tuaj hyjnore. Pikërisht për këtë arsye Kur'ani përsërit: **"Mos u dobësoni dhe mos kërkoni kompromis nga pozita e dobësisë."** Mos u mbështetni në kompromis e lëshime ndaj një armiku të tillë, por tregohuni vigjilentë dhe të kujdesshëm.

[1] Sure "Muhammed", ajeti 35.

[2] Sure "El-Mumtehine", ajeti 8.

Vallë, cili mjedis, cila shkollë apo cila ligjëratë mund t'i japë njeriut një mësim dhe këshillë më të madhe e më të vlefshme se kjo?[1]

Duhet të meditojmë dhe të thellohemi gjithnjë e më shumë në shembujt e Kur'anit

Ne duhet të reflektojmë me kujdes të madh mbi shembujt që Allahu i Madhëruar sjell në Kur'an. Ai thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ لَا يَسْتَحْيِي أَن يَضْرِبَ مَثَلًا مَّا بَعُوضَةً فَمَا فَوْقَهَا﴾

"Allahu nuk ngurron të sjellë si shembull qoftë edhe një mushkonjë ose diçka edhe më të vogël apo më të madhe se ajo."[2]

Kur'ani i Shenjtë, përmes shembujve të tillë, na paraqet të vërteta të mëdha dhe të përjetshme duke përdorur shembuj të prekshëm dhe të kuptueshëm. Nëse jemi njerëz të mendjes dhe të urtësisë, atëherë duhet t'i kuptojmë dhe t'i përvetësojmë këto mësime.

Për shembull, ju mbillni një pemë të zakonshme në një tokë pjellore, kujdeseni për të, e mbroni nga dëmtuesit dhe sëmundjet. Pas kësaj nuk shqetësoheni më për të, sepse ajo:

[1] I njëjti burim i mëparshëm (Fjalimi i Udhëheqësit).

[2] Sure "El-Bekare", ajeti 26.

﴿تُؤْتِي أُكُلَهَا كُلَّ حِينٍ بِإِذْنِ رَبِّهَا﴾

"Jep frytet e saj në çdo kohë, me lejen e Zotit të saj."[1]

Kur të vijë stina e frutave, ju merrni shportën dhe shkoni për t'i mbledhur frytet e saj. Po, ky është një shembull simbolik. Edhe fjala e mirë (*el-kelimetu et-tajjibeh*) është si kjo pemë. Të gjitha të vërtetat e mëdha në këtë botë janë "fjala e mirë", dhe ato janë prej fjalëve të Allahut të Madhëruar. Secili prej nesh e gjen "fjalën e mirë" në fushën që i përket dhe ku vepron. Në këtë kontekst, dëshiroj të them se Ushtria e Republikës Islamike është një "fjalë e mirë".[2]

Çfarë nënkupton Kur'ani me "kënaqësinë e jetës së kësaj bote"?

Kur'ani, kur përdor shprehjen **"kënaqësia e jetës së kësaj bote"**, nuk ka për qëllim të thotë se kënaqësia ose të mirat e kësaj bote është diçka e keqe apo e qortueshme. Jo. Përkundrazi, ajo është një mirësi që Allahu i Madhëruar e ka krijuar për ju. Mirëpo, nëse, (Zoti na ruajtë!) njeriu lidhet aq shumë pas këtyre kënaqësive dhe dëshirave të kësaj bote, saqë nuk është më në gjendje të shkëputet

[1] Sure "Ibrahim", ajeti 25.

[2] Fjalimi i Udhëheqësit (Allahu e mëshiroftë!) në takimin e tij me një numër komandantësh ushtarakë dhe pjesëtarësh të Ushtrisë së Republikës Islamike, me rastin e Javës së Mbrojtjes së Shenjtë; 5/7/1374 sipas kalendarit irania, 27/10/1995.

prej tyre kur përballet me detyra dhe përgjegjësi të vështira, atëherë çështja ndryshon. Në këtë rast, vështrimi ndaj këtyre kënaqësive bëhet negativ.

Përndryshe, ju mund t'i shfrytëzoni të mirat e kësaj bote dhe të përfitoni prej tyre. Por nëse një ditë ju duhet të zgjidhni midis ruajtjes së këtyre të mirave dhe përballimit të një sprove të rëndë në rrugën e së vërtetës, duhet të jeni në gjendje të hiqni dorë prej tyre lehtësisht dhe pa vuajtje.

Përkrahësit e së vërtetës ndahen në dy grupe. Kushtojini vëmendje kësaj çështjeje, sepse ajo kërkon mendim të thellë, largpamësi, saktësi dhe studim. Nuk mund të ndërtohet një jetë e denjë për njeriun, shoqërinë, sistemin dhe revolucionin vetëm me emocione, kjo kërkon hulumtim, analizë dhe racionalitet.

Në çdo shoqëri ekzistojnë dy kategori njerëzish, e po kështu edhe dy kategori përkrahësish të së vërtetës.

Nëse grupi më i mirë i përkrahësve të së vërtetës, ata që janë në gjendje të heqin dorë nga kënaqësitë e kësaj bote kur e kërkon nevoja, është shumicë në shoqëri, atëherë ajo shoqëri nuk do të përballet me kriza si ato me të cilat u përball imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!). Jini të sigurt se një tragjedi e tillë nuk do të ndodhë dhe mbrojtja e garancia hyjnore do ta shoqërojnë atë shoqëri deri në fund.

Por nëse ky grup është pakicë, ndërsa shumica përbëhet nga ata që e njohin të vërtetën, madje e mbështesin atë, por janë bërë robër të kësaj bote dhe vullneti i tyre është thyer përballë joshjeve të saj, atëherë lind pyetja: Çfarë është në të vërtetë kjo botë

(Dynjaja)? Dynjaja janë pasuria, paratë, shtëpitë, pallatet, fama, reputacioni, postet, pozitat drejtuese, kujdesi i tepruar për veten dhe ruajtja e interesave personale.

Mbi këtë bazë, njerëzit duhet ta thonë të vërtetën, por nuk e thonë, sepse kanë frikë se do të rrezikojnë jetën e tyre. Nuk e shprehin të vërtetën për të ruajtur postin, përgjegjësinë, pasurinë, apo nga dashuria e tepruar për fëmijët, familjen, të afërmit dhe miqtë e tyre. Për këtë arsye, ata e lënë mënjanë rrugën e Allahut.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿قُلْ إِن كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَأَمْوَالٌ اقْتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِنُ تَرْضَوْنَهَا أَحَبَّ إِلَيْكُم مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي سَبِيلِهِ فَتَرَبَّصُوا حَتَّى يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ﴾

“Thuaj: Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që keni fituar, tregtia për të cilën frikësoheni se do të pësojë rënie dhe banesat që i pëlqeni janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë prisni derisa Allahu të sjellë urdhrin e Tij. Allahu nuk e udhëzon popullin e shthurur.”[1]

Nëse njerëz të tillë përbëjnë shumicën e një shoqërie, atëherë ndodh fatkeqësia. Atëherë imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) dhe njerëz si ai do të çohen drejt masakrës së Kerbelasë dhe do të rrethohen në fushën e betejës.

[1] Sure “Et-Teube”, ajeti 24.

Atëherë do të sundojë Jezidi ibn Muavije dhe njerëz të ngjashëm me të mbi popullin, ndërsa Dinastia Emevite do të përvetësojë pushtetin dhe qeverisjen, pikërisht atë shtet dhe atë sistem që e themeloi i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ky sundim do të zgjasë për një periudhë të gjatë, të cilën Kur'ani e përshkruan si "një mijë muaj", dhe gjatë kësaj kohe vilajeti, imameti dhe khilafeti do të shndërrohen nga një udhëheqje hyjnore në një pushtet mbretëror, një dinasti familjare dhe një monarki trashëgimore.[1]

Çfarë do të thotë "*istikbar*" (arroganca sunduese) sipas këndvështrimit të Kur'anit?

Koncepti i *istikbarit* ka një kuptim të gjerë. Kur'ani i Shenjtë e ka përdorur në mënyrë të përsëritur këtë term, si edhe format e ndryshme të prejardhura prej tij.

Duket se fjala istikbar nuk është e njëjtë me *kibrin* (mendjemadhësinë) ose *tekebburin* (arrogancën). Kibri dhe tekebburi janë, në shumicën e rasteve, gjendje të brendshme shpirtërore; pra, njeriu mendjemadh e konsideron veten më të mirë dhe më të lartë se të tjerët.

I*stikbari* është shfaqja praktike e kësaj mendjemadhësie. Ai që e sheh veten më të lartë se të tjerët, fillon të sillet me arrogancë ndaj tyre, i ndërton marrëdhëniet me njerëzit mbi bazën e kësaj

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit (Allahu e mëshiroftë!) në mbledhjen e komandantëve të Korpusit 27 "Muhammed Resulullah", pjesë e Gardës së Revolucionit Islamik; 20/3/1375 sipas kalendarit iranian, 10/6/1996.

epërsie të rreme dhe këtë e shfaq në praktikë. Ai i përçmon të tjerët, i nënvlerëson njerëzit, ndërhyn në punët e tyre dhe sillet në shoqëri sikur vendimi i parë dhe i fundit t'i takojë vetëm atij.

Ky është kuptimi i *istikbarit*. Pikërisht në këtë kuptim vjen edhe fjala e Allahut të Madhëruar:

﴿فَلَمَّا جَاءهُمْ نَذِيرٌ مَّا زَادَهُمْ إِلَّا نُفُورًا ۝ اسْتِكْبَارًا فِي الْأَرْضِ وَمَكْرَ السَّيِّئِ﴾

"Kur u erdhi një paralajmërues, kjo vetëm sa ua shtoi largimin; duke u sjellë me arrogancë në tokë dhe duke kurdisur plane të këqija."[1]

Këta njerëz tregonin arrogancë ndaj profetëve (Paqja qoftë mbi ta!) dhe ndaj së vërtetës. Ata nuk dilnin e të thoshin hapur se ishin më të mëdhenj ose më të mirë se të tjerët, por këtë epërsi dhe arrogancë të rreme, që e imagjinonin për veten, e shfaqnin në sjelljet dhe veprimet e tyre. Ata përvetësonin pjesën më të madhe të përfitimeve për interesat e tyre personale, duke lënë të tjerët pa të drejtat e tyre. Kjo është ajo që nënkupton *istikbari*. Ai përfaqëson vazhdimësinë e përhershme të përballjes ndërmjet frontit të mohimit, kokëfortësisë dhe tiranisë, nga njëra anë, dhe frontit të së vërtetës, spiritualitetit, dritës dhe udhëzimit hyjnor, nga ana tjetër. Po, ky është kuptimi i vërtetë i *istikbarit*.[2]

[1] Sure "Fatir", ajetet 42–43.

[2] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit (Allahu e mëshiroftë!), me rastin e Ditës së Luftës kundër Arrogancës Botërore; 9/8/1375 sipas kalendarit iranian, 31/1/1996.

Kur'ani e konsideron tekvanë të kundërtën e pakujdesisë (*gafletit*)

Kur dijetarët e etikës islame dhe të irfanit shpirtëror përshkruajnë etapat e udhëtimit shpirtëror dhe të pastrimit të vetvetes, ata arrijnë në një stad ku njeriu përpiqet të dalë nga gjendja e pakujdesisë (gafletit). Kjo etapë quhet "zgjimi" (jekdhatun).

Në terminologjinë kur'anore, shohim se tekvaja është e kundërta e gafletit. Ajo nënkupton zgjim, vetëdije të vazhdueshme, vigjilencë dhe vetëmbikëqyrje të përhershme.

Nëse njeriu është i pakujdesshëm dhe i pavëmendshëm, ai mund të kryejë dhjetëra gjynahe pa e kuptuar fare se ka rënë në to.

Ndërsa njeriu i devotshëm (*muttekij*) është krejtësisht në anën e kundërt. Ai është e kundërta e njeriut të shkujdesur. Nëse i ndodh qoftë edhe një gabim i vogël ose një mëkat i lehtë, ai e kupton menjëherë, zgjohet dhe merr mësim pa vonesë, sepse e ndien se ka gabuar. Prandaj përpiqet me gjithë forcën ta korrigjojë veten. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا إِذَا مَسَّهُمْ طَائِفٌ مِّنَ الشَّيْطَانِ تَذَكَّرُوا﴾

"Me të vërtetë, ata që kanë takva, kur i prek një nxitje nga shejtani, kujtohen menjëherë…"[1]

[1] Sure "El-A'raf" ajeti 201.

Kjo do të thotë se sapo shejtani i afrohet dhe e prek me një frymëzim ose tundim, ai e kupton menjëherë se ka rënë në kurthin e shejtanit, ka bërë një gabim dhe është prekur nga pakujdesia.

Prandaj ai e vëren menjëherë këtë rrëshqitje, zgjohet nga pakujdesia dhe nga "gjumi" shpirtëror.

Kur'ani vazhdon: **"…dhe menjëherë ata shohin qartë."** Pra, sytë e zemrës së tyre hapen falë kësaj vetëdijeje dhe këtij zgjimi shpirtëror. Ky është njeriu i devotshëm (muttekij).[1][

Lufta e profetëve kundër arrogantëve zë një vend të veçantë dhe shumë tërheqës në Kur'anin e Shenjtë

Kur Allahu i Madhëruar dërgoi profetët dhe të dërguarit e Tij (Paqja qoftë mbi ta!) gjatë gjithë historisë, ata u përballën me një realitet të pandryshueshëm: përpara tyre gjithmonë qëndronin arrogantët (mustekbirët).

Po të meditoni me kujdes në Kur'anin e Shenjtë, do të shihni se ai përmban pjesë jashtëzakonisht të bukura dhe mbresëlënëse rreth luftës së profetëve kundër arrogantëve. Në fund të kësaj përballjeje, fitorja dhe triumfi u takojnë gjithmonë profetëve. Ky është një ligj hyjnor që nuk bën përjashtim.

Natyrisht, mund të ndodhë që një profet të bjerë dëshmor gjatë rrugës ose të ndahet nga kjo botë para se ta shohë fitoren me

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit (Allahu e mëshiroftë!) në dy hytbet e namazit të xhumasë në Teheran; 28/10/1375 sipas kalendarit iranian, 18/1/1996.

sytë e tij. Megjithatë, fronti i Profetit triumfon gjithmonë mbi frontin e armiqve të tij.

Sa herë që ta shikoni historinë, do ta gjeni këtë rregull të pandryshueshëm, të cilin Allahu e shpreh me fjalët: **"Pa dyshim, Ne do t'i ndihmojmë të dërguarit Tanë."** Pra, fitorja është një premtim i sigurt për profetët.

Një nga mënyrat kryesore me të cilat arrogantët përballeshin me profetët ishte përçmimi dhe tallja me ta. Allahu i Madhëruar i thotë Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!):

﴿وَلَقَدِ اسْتُهْزِئَ بِرُسُلٍ مِّن قَبْلِكَ فَحَاقَ بِالَّذِينَ سَخِرُوا مِنْهُم مَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِؤُون﴾

"Edhe para teje janë përqeshur të dërguar të tjerë, por ata që i tallnin u goditën pikërisht nga ajo me të cilën talleshin."[1]

Kështu, Allahu i Madhëruar e ngushëllon dhe e qetëson të Dashurin e Tij, duke i treguar se tallja dhe përqeshja nga udhëheqësit e arrogancës ka qenë gjithmonë një metodë e zakonshme dhe e vazhdueshme kundër profetëve.

Natyrisht, ky ajet nuk ka për qëllim të përfshijë të gjithë profetët. Duket se ekziston një ajet tjetër në Kur'anin e Shenjtë që tregon për talljen ndaj të gjithë profetëve (Paqja qoftë mbi ta!), ndërsa ky ajet i drejtohet Profetit tonë (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), duke i thënë se profetët që erdhën para teje u përballën me tallje nga ana e arrogantëve. Pra,

[1] Sure "El-En'am", ajeti 10.

shumë profetë, ndër ta edhe profetët e mëdhenj si Profeti Isa, Profeti Musa, Profeti Ibrahim dhe Profeti Nuh (Paqja qoftë mbi ta!), u përqeshën para teje. Dhe kjo nuk është aspak diçka e çuditshme. Megjithatë, të gjithë ata që talleshin me fenë e Allahut, në fund u përballën me dështim; ata u thyen dhe u shembën përpara kësaj feje. E njëjta çështje ndodh edhe sot. Edhe kjo lëvizje dhe ky revolucion janë të ngjashëm me lëvizjen e profetëve. Po ashtu, lëvizja që krijoi imam Ruhullah Khomeini (Zoti e mëshiroftë!) në këtë vend, ka ngjashmëri të madhe me lëvizjet e profetëve.[1]

E vërteta e Gadijr Khumit dhe kuptimi i vilajetit (udhëheqjes)

Ajo që mund të mbetet e qëndrueshme dhe e përjetshme si një rrymë e vazhdueshme gjatë ditëve dhe viteve, dhe që njerëzit mund ta marrin si një dritë udhëzuese për veten e tyre dhe ta ndërtojnë jetën e ardhshme mbi bazën e saj, është pikërisht përmbajtja dhe mesazhi që gjendet në ngjarjen e Gadijr Khumit.

Vetë kjo çështje është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ajo përbën një mësim të madh dhe përfshin një pjesë të rëndësishme të Islamit. Allahu i Madhëruar aty dha një urdhër të veçantë dhe mbi bazën e tij, Profeti i nderuar (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) caktoi një person të veçantë për të marrë përsipër pozitën e vilajetit (udhëheqjes), veçanërisht kur bëhet fjalë për një person si imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!).

[1] Fjalimi i Udhëheqësit (Allahu e mëshiroftë!) në dy hytbet e namazit të xhumasë në Teheran; 12/11/1375 sipas kalendarit iranian, 31/1/1996.

Ndoshta themeli dhe shtylla e vërtetë e Islamit mishërohet pikërisht në këtë çështje. Për këtë arsye, pozita e Gadijr Khumit është aq e rëndësishme sa Kur'ani thotë:

﴿وَإِن لَّمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَّغْتَ رِسَالَتَهُ﴾

"E nëse nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij."[1]

Atëherë, cila është e vërteta e Gadijr Khumit dhe cila është e vërteta e kësaj pozite që ka marrë një rëndësi kaq të madhe në Kur'an dhe tek Allahu i Madhëruar? Kjo çështje ka dimensione të ndryshme. Njëri prej tyre është se drejtimi dhe administrimi i çështjeve të njerëzimit duhet të bazohet në urdhrat dhe ndalesat hyjnore dhe nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm në ligjet njerëzore. Kjo çështje ndryshon nga shumë çështje të tjera të jetës së njeriut.

Disa njerëz mund ta keqpërdorin këtë aspekt pa të drejtë, duke ia atribuar shumicën e veprimeve të tyre të këqija dhe sjelljeve të devijuara lidhjes dhe afërsisë së tyre me Allahun e Madhëruar.

Natyrisht, një keqpërdorim i tillë mund të ndodhë në çdo të vërtetë të madhe të kësaj bote. Madje, disa njerëz e kanë keqpërdorur edhe çështjen e profetësisë, duke pretenduar se ishin profetë dhe duke çuar shumë njerëz në humbje. Por ne nuk duhet t'i trajtojmë këto çështje në një mënyrë që qëndrimi ynë ndaj kësaj madhështie dhe rëndësie të bëhet i dobët, i lëkundur ose naiv. Kjo është një pikë shumë e rëndësishme: çështja e drejtimit të shoqërisë, e rrugëtimit të saj, e fatit të saj dhe e asaj që lidhet me ndërtimin e

[1] Sure "El-Maide", ajeti 67.

jetës së njerëzve, është një çështje që buron nga vetë thelbi i vullnetit hyjnor dhe lidhet me marrëdhënien e njeriut me Allahun. Ky është njëri prej dimensioneve të kësaj çështjeje.

Kuptimi i fjalës vilajet (الولاية)

Dimensioni i dytë, të cilin dëshiroj ta theksoj pak më shumë, është sqarimi i fjalës *"vilajetun"* dhe i konceptit të saj. Kjo fjalë është përsëritur në ngjarjen e Gadijr Khumit, ku Profeti i nderuar (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: *"Për atë që unë i jam udhëheqës (meula), edhe Aliu është udhëheqësi i tij."* Pra, në këtë ngjarje historike dhe në këtë caktim madhështor, Profeti Muhamed e shprehu konceptin e qeverisjes me fjalën "vilajetu".

Në gjuhën arabe dhe në gjuhë të tjera ekzistojnë shprehje të ndryshme për fenomenin e qeverisjes, marrjes së drejtimit të çështjeve dhe zotërimit të pushtetit, domethënë, kur një person ose një grup drejton një shoqëri dhe nxjerr urdhra e ndalesa për të. Çdo njëra prej këtyre shprehjeve tregon një aspekt dhe një dimension të veçantë.

Për shembull, fjala "qeverisje" (*hukymetun*) tregon se një person ose një grup ka marrë drejtimin e pushtetit dhe janë ata që sundojnë njerëzit. Për këtë arsye, nga ana e tyre, shoqëria dhe individët u binden dhe i nënshtrohen vendimeve të qeverisë. Po ashtu ekziston edhe një shprehje tjetër, "*sulltanat*" ose "*mbretëri*", e cila nënkupton zotërimin, fuqinë dhe kontrollin mbi çështjet. Duhet të përmendet se edhe në gjuhën perse ekzistojnë këto dallime

gjuhësore; çdo fjalë dhe shprehje simbolizon një anë ose këndvështrim të veçantë të konceptit të qeverisjes.

Islami i kushton më shumë rëndësi fjalës "*vilajet*" sesa çdo shprehjeje tjetër. Siç e përmendëm më parë, fjala vilajet erdhi nga goja e Profetit të Madhërishëm (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) me kuptimin e qeverisjes dhe udhëheqjes. Po ashtu, edhe në këtë ajet fisnik, qeverisja është shprehur me termin vilajet:

﴿إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ..﴾

"Me të vërtetë, udhëheqësi juaj është vetëm Allahu, i Dërguari i Tij…"[1]

Pra, në terminologjinë islame, koncepti i drejtimit të shoqërisë nuk shprehet thjesht si pushtet apo sundim, por si vilajet, që përmban kuptimin e lidhjes, kujdesit, udhëheqjes dhe përgjegjësisë hyjnore ndaj njerëzve.

Kuptimi i fjalës *vilajetu* (ولاية) dhe filozofia e saj në qeverisjen islame

Fjala "*vilajetu*" ka kuptime të mahnitshme dhe të bukura. Origjina e këtij koncepti në gjuhë është afërsia dhe lidhja ndërmjet dy gjërave. Për shembull, imagjinoni se kemi dy litarë dhe i thurim së bashku në një mënyrë që bëhet shumë e vështirë t'i ndajmë nga

[1] Sure "El-Maide", ajeti 55.

njëri-tjetri. Në gjuhën arabe kjo quhet vilajet. Pra, *vilajeti* nënkupton lidhjen, bashkimin dhe afrimin e dy gjërave, ku njëra prek tjetrën dhe lidhet me të në mënyrë të fortë.

Të gjitha kuptimet që përmenden për fjalën *vilajet* në fjalorët gjuhësorë, si dashuria, kujdesi, përgjegjësia, udhëheqja dhe kuptime të tjera, të cilat arrijnë deri në shtatë apo tetë kuptime në gjuhën arabe, në një mënyrë ose në një tjetër, tregojnë një aspekt të këtij afrimi dhe lidhjeje ndërmjet dy palëve të *vilajetit*.

Për shembull, *vilajeti* do të thotë dashuri, sepse ndërmjet atij që dashuron dhe atij që dashurohet ekziston një lidhje dhe afërsi shpirtërore e kuptimore, dhe ata nuk mund të ndahen lehtë nga njëri-tjetri.

Islami e përdor fjalën *vilajet* për të shprehur konceptin e qeverisjes. Për këtë arsye, personi i parë dhe udhëheqësi në shoqërinë islame quhet vali (*uali*), veli (*ueli*) ose meula (*meula*), të cilat janë prejardhje të së njëjtës fjalë vilajet.

Atëherë, çfarë kuptimi kanë këto shprehje? Kuptimi i tyre është se ai që mban përgjegjësinë e fuqisë, qeverisjes dhe autoritetit, si dhe të gjitha strukturat e tjera që kanë në dorë drejtimin e çështjeve, sipas sistemit politik islam, duhet të jetë i lidhur, i bashkuar dhe i afërt me popullin dhe masat, në atë mënyrë që të mos ketë ndarje ndërmjet tyre.

Nga ky këndvështrim kuptojmë filozofinë politike të Islamit në fushën e qeverisjes. Po ashtu kuptojmë se qeveritë që nuk kanë këtë lidhje dhe afërsi me popullin, nuk e meritojnë cilësimin *vilajet*.

Pra, ato nuk përputhen me kriteret që Islami ka vendosur për qeverisjen.

Nëse supozojmë se një grup sundon mbi njerëzit, por nuk ka lidhje dhe afërsi me popullin, kjo nuk është *vilajet*. Nëse kjo lidhje ndërtohet mbi frikën, terrorin dhe ndjekjen, larg dashurisë, harmonisë dhe bashkimit, edhe kjo nuk është *vilajet*.

Nëse një grup merr pushtetin përmes një grushti shteti, ose një person arrin në fronin e pushtetit dhe sundimit përmes trashëgimisë, trashëgimisë familjare apo delegimit, pa pasur cilësitë dhe meritat e nevojshme për qeverisje, gjë që është një çështje shumë e rëndësishme në qeverisje, edhe kjo nuk është *vilajet*.

Vilajeti nuk realizohet dhe nuk merr formën e tij të vërtetë, përveçse kur ekziston një lidhje e fortë, e çmuar dhe miqësore ndërmjet qeverisë dhe popullit mbi të cilin ajo qeveris.

Kjo ishte edhe gjendja e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), për të cilin Kur'ani thotë se ishte: **"U dërgua prej tyre"** dhe: **"U dërgua nga vetë mesi i tyre."** Domethënë, udhëheqësi dhe veliu duhet të dalë nga vetë shoqëria e tyre, nga mesi i njerëzve të saj, dhe pastaj të marrë përsipër përgjegjësinë e vilajetit dhe qeverisjes. Ky është themeli i sistemit të qeverisjes islame.[1]

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik në takimin e tij me përgjegjësit dhe burrat e shtetit të sistemit të Republikës Islamike të Iranit, me rastin e festës së bekuar të Ghadirit; 6/2/1376 sipas kalendarit iranian, 25/4/1997.

E vërteta e falënderimit për mirësitë dhe njohja e begative

Pika e rëndësishme këtu është se robi e pranon mirësinë nga Zoti i tij. Prandaj duhet të mendojë me kujdes se si duhet të sillet ndaj kësaj mirësie.

Ne lexojmë në suren "El-Fatiha":

﴿صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ﴾

"Në rrugën e atyre të cilët i ke begatuar, jo në rrugën e atyre që kanë merituar zemërimin Tënd dhe as të atyre që kanë humbur."

Kjo do të thotë se edhe ata që e marrin një mirësi nga Allahu mund të shndërrohen në "ata që kanë merituar zemërimin e Allahut" (*el-magdub alejhim*) ose në "të humburit (*ed-dallin*)".

Një shembull për këtë janë bijtë e Izraelit. Allahu i Madhëruar ua përsëriti atyre shumë herë:

﴿اذْكُرُواْ نِعْمَتِيَ الَّتِي أَنْعَمْتُ عَلَيْكُمْ

"Kujtoni mirësinë Time që jua dhashë juve."[1]

Allahu u kishte dhënë atyre shumë begati, por megjithatë ata devijuan. Në suren "El-Fatiha", me shprehjen "ata që kanë merituar zemërimin e Allahut" nënkuptohen bijtë e Izraelit.

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 40.

Prandaj duhet të jemi të kujdesshëm dhe ta marrim seriozisht këtë çështje. Nëse Allahu i Madhëruar na dhuron një mirësi, ne duhet të jemi falënderues për atë mirësi, në mënyrë që të mos bëhemi prej atyre që kanë merituar zemërimin e Allahut ose prej të humburve.

Zgjidhja është që ta falënderojmë Allahun e Madhëruar për begatitë dhe mirësitë që na ka dhënë.

O bijtë e mi të dashur! E vërteta e falënderimit është që njeriu ta shohë mirësinë si diçka që vjen nga Allahu i Madhëruar. Kjo nuk do të thotë që ai të mjaftohet vetëm duke e përmendur falënderimin me gjuhë. Përkundrazi, duhet që të gjitha gjymtyrët dhe pjesët e qenies së tij ta vërtetojnë këtë dhe ta falënderojë Allahun me të gjithë qenien e tij.

Ai duhet të besojë se mirësitë që gëzon janë nga Allahu dhe nuk duhet ta lejojë veten të mendojë se është ai vetë që i ka siguruar këto mirësi. Ky mendim dhe kjo bindje e gabuar mund të çojnë në zemërimin e Allahut të Madhëruar dhe në privimin nga begatitë e Allahut, siç thotë Allahu në Kur'an:

﴿إِنَّمَا أُوتِيتُهُ عَلَى عِلْمٍ﴾

"Mua më është dhënë kjo vetëm për shkak të dijes që kam."[1]

Nëse pretendojmë se jemi ne ata që kemi arritur dijen, aftësitë dhe mundësitë që posedojmë, kjo është padyshim një gabim. Kur'ani i Shenjtë thotë:

[1] Sure "El-Kasas", ajeti 78.

﴿مَّا أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ اللهِ﴾

"Çdo e mirë që të godet, është nga Allahu."[1] Pra, të gjitha mirësitë dhe begatitë që ju arrijnë janë nga Allahu i Madhëruar. Po ashtu, Allahu thotë: **"Çdo mirësi që ju keni, është nga Allahu."** Na kanë mësuar që në lutje të përsërisim: *Çdo mirësi që kemi është prej Teje. Nuk ka zot tjetër përveç Teje, vetëm Ti je i Vetmi, nuk ke ortak.*

Pra, të gjitha mirësitë që posedojmë janë nga Allahu i Madhëruar. Maksimumi që mund të themi është se ne mund të jemi të denjë për ta pranuar dhe për ta ruajtur atë mirësi hyjnore. Për këtë arsye, falënderimi është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme.

Ndjenja se mirësitë vijnë nga Allahu do të ndihmojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe vështirësive, dhe do t'ia largojë njeriut mendjemadhësinë, arrogancën, tiraninë dhe krenarinë e tepruar për shkak të mirësive që posedon.

Njeriu do ta kuptojë se ai nuk është pronari i vërtetë i kësaj mirësie dhe se ajo nuk ka ardhur vetëm si rezultat i përpjekjeve dhe aftësive të tij të pavarura. Përkundrazi, gjithçka që ekziston është e lidhur me qenien e Allahut të Madhëruar. Dhënësi i vërtetë është vetëm Allahu. Kërkesa duhet të bëhet prej Tij dhe vazhdimësia e begative duhet të kërkohet prej Tij. Ne duhet t'i drejtohemi Atij, të

[1] Sure "En-Nisa", ajeti 79.

kërkojmë ndihmën e Tij, t'i lutemi dhe të përulemi para Tij. Ky është drejtimi i drejtë dhe rruga e saktë.[1]

Nuk ka drejtim të botës pa devotshmëri

Devotshmëria, ky faktor dhe shkak i madh, ndikon në të gjitha fushat e jetës. Shikoni sa shumë e ka trajtuar Kur'ani i Shenjtë çështjen e devotshmërisë. Çështja nuk kufizohet vetëm në atë se kur të largoheni nga kjo botë dhe të kaloni në botën tjetër, Allahu i Madhëruar do t'ju shpërblejë me shpërblim të mirë për shkak të devotshmërisë dhe përmbajtjes suaj nga gjynahet. Jo, nuk është vetëm kaq.

Përkundrazi, tekvaja është ajo që e drejton edhe jetën e kësaj bote, dhe drejtimi i drejtë i kësaj bote është ai që ndërton jetën e Ahiretit. Mungesa e devotshmërisë e çon njeriun drejt pakujdesisë (*gafletit*), dhe kjo pakujdesi e rrëzon atë përtokë, e përmbys dhe e humb drejtimin e tij.

Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) e krahason devotshmërinë me një mjet të shpejtë udhëtimi dhe një kalë të zgjedhur, i cili nuk trembet dhe nuk rebelohet. Kalorësi hipën mbi të dhe e drejton aty ku dëshiron, ndërsa ky kalë e çon pronarin e tij në vendin e caktuar dhe të synuar, pa frikë dhe pa dyshim. Ndërsa gabimin dhe gjynahun imam Aliu (Paqja qoftë!) i krahason dhe mosbindjen me një kalë të egër dhe të pakontrollueshëm, i cili është i dobët në themel dhe pengohet gjatë ecjes. Ai ia merr njeriut frerin dhe

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik në takimin e tij me deputetët e Mexhlisit të Këshillit Islamik; 7/3/1376 sipas kalendarit, 27/6/1997.

kontrollin nga dora dhe e çon drejt një vendi të panjohur, të cilin ai nuk e dëshiron, pastaj e rrëzon përtokë.[1]

Dorëzimi ndaj të padrejtit nuk është më pak i keq sesa kryerja e padrejtësisë dhe e shtypjes

Ai që beson në Islam dhe i përmbahet fesë, edhe nëse kjo është në një nivel të thjeshtë dhe të kufizuar, nuk mund t'i nënshtrohet sundimit të padrejtë dhe të pranojë padrejtësinë e shtypjen. Ai nuk mund ta justifikojë një gjë të tillë. Sepse, Islami e konsideron padrejtësinë, shkeljen e të drejtave dhe tejkalimin e kufijve si një çështje të refuzuar dhe të shëmtuar, po aq sa e konsideron edhe dorëzimin dhe nënshtrimin ndaj padrejtësisë si diçka të papranueshme dhe të refuzuar.

Ju mund të shihni se imam Ali ibn Hysejni (imam Sexhadi), në lutjen "Mekarimul-Akhlak" (Fisnikëria e moralit), thotë: "*O Allah, mos më lejo të bëj padrejtësi kur Ti ke mundësi të më ndalosh prej saj, dhe mos më lejo të pranoj padrejtësinë kur Ti ke fuqi të më mbrosh prej saj.*"

Pra, një person nuk mund të jetë mysliman dhe besimtar në Islam, ndërkohë që në të njëjtën kohë t'i nënshtrohet padrejtësisë dhe shtypjes së dikujt.

E si mund të jetë e pranueshme kjo, kur kjo padrejtësi dhe kjo padrejtësi e rëndë vjen nga një armik i vjetër i popullit iranian,

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik në takimin e tij me komandantët dhe pjesëtarët e Gardës së Revolucionit Islamik; 26/6/1376 sipas kalendarit iranian, 16/9/1997.

domethënë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila, sipas këtij këndvështrimi, ka kërkuar vazhdimisht ta godasë këtë popull me sulme të padrejta. Kjo nuk ishte e pranueshme dhe ata e dinin shumë mirë këtë.

Pikërisht për këtë arsye, sipas këtij teksti, ata e kundërshtojnë dhe e armiqësojnë sistemin e Republikës Islamike me të gjithë qenien e tyre, duke pritur momentet e përshtatshme dhe duke shfrytëzuar mundësitë për ta kundërshtuar dhe luftuar atë. Sepse, sipas këtij vlerësimi, ata e dinë se populli iranian dhe sistemi i Republikës Islamike nuk do t'u nënshtrohen padrejtësive dhe imponimeve të tyre.[1]

Pikat e rëndësishme të misionit të shenjtë profetik

Ne mund ta kuptojmë mesazhin që na drejton misioni i shenjtë i Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) drejtpërdrejt nga Kur'ani i Shenjtë. Në këtë rast do të përmend dy aspekte të këtij mesazhi të përjetshëm, në mënyrë që të kuptoni rëndësinë e madhe që ka ky mision për ne, myslimanët, dhe se si misioni profetik vendos përpara nesh rrugën dhe metodën më të përsosur.

Aspekti i parë i këtij mesazhi, të cilit Kur'ani i është referuar në disa ajete, është edhe ky ajet:

[1] Takimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik me një grup të rinjsh, me rastin e Javës së Rinisë; 7/2/1377 sipas kalendarit iranian, 26/4/1998.

﴿بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ ۝ الَر كِتَابٌ أَنزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ﴾

"Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Elif, Lam, Ra. Ky është një Libër që Ne ta kemi zbritur ty, që t'i nxjerrësh njerëzit nga errësirat në dritë."[1]

Pra, mesazhi këtu është dalja nga errësira dhe hyrja në dritë. Drita dhe errësira nuk janë çështje të ndërlikuara në fusha të ndryshme, që të krijohet paqartësi apo konfuzion. Islami dhe mesazhi i misionit profetik synojnë ta nxjerrin njeriun nga: errësira e injorancës; zakonet dhe traditat e këqija; moralet e ulëta dhe sjelljet e qortuara; trazirat dhe përçarjet e përhapura ndërmjet njerëzve; bestytnitë që pushtojnë mendjet e njerëzve dhe i largojnë ata nga rruga e drejtë; errësira e padrejtësisë dhe tiranisë. Të gjitha këto janë forma të errësirës.

Islami erdhi për ta nxjerrë njeriun prej këtyre errësirave dhe për ta udhëzuar drejt dritës, e cila ndriçon dhe shkëlqen përpara tij.[2] Njerëzit e devotshmërisë janë ata që marrin vendimet në formësimin e të gjitha lëvizjeve dhe planeve të së ardhmes

Në Kur'an ekziston një pikë themelore dhe jashtëzakonisht e rëndësishme, dhe nuk ka problem t'jua përmend juve, o të rinj të dashur, e ajo është theksimi mbi devotshmërinë (*tekvanë*). Kur një person dëshiron ta mishërojë *takvanë* në veten e tij, zakonisht i shfaqen në mendje namazi, agjërimi, adhurimi, përmendja e

[1] Sure "Ibrahim", ajetet 1–2.

[2] Takimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik me një numër të madh nxënësish dhe studentësh, me rastin e Ditës së Studentit; 13/8/1376 sipas kalendarit iranian, 3/11/1997.

Allahut (*dhikri*) dhe lutjet. Të gjitha këto vepra mund të jenë të lidhura me *takvanë*, por ato nuk e përshkruajnë dhe nuk e shpjegojnë plotësisht kuptimin e saj.

Takvaja do të thotë që njeriu të jetë i vetëDitur dhe mbikëqyrës ndaj vetes. Ajo do të thotë gjithashtu që njeriu të dijë se çfarë po bën, çfarë vepron dhe çfarë thotë, pastaj çdo lëvizje të tij ta zgjedhë nën drejtimin e vullnetit, mendimit dhe planifikimit të tij. Ajo është si një njeri që ka hipur mbi një kalë të shpejtë, ka kapur frerin e tij dhe e di se ku dëshiron të shkojë. Ky është kuptimi i takvasë.

Ai që nuk posedon takva, lëvizjet e tij, vendimet e tij dhe e ardhmja e tij nuk janë më nën kontrollin dhe zgjedhjen e tij. Siç ka ardhur në fjalët e Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) në një prej fjalimeve të tij në "Nahxhul Belaga", ai është si një person që e kanë ulur mbi një kalë të egër, jo si dikush që ka hipur vetë mbi të. Edhe nëse ka hipur vetë mbi të, por nuk di të kalërojë, ai e kap frerin e kalit, por nuk di si të veprojë dhe nuk e di se ku do ta çojë kali apo në cilin drejtim do ta marrë. Ai do të detyrohet të shkojë kudo që ta çojë kali dhe nuk do të mund të shpëtojë nga kjo gjendje. Edhe ky kalë, që është nefsi urdhërues për të keqen (en-nefs el-emmaretu), është i egër dhe rebel, dhe nuk mund të kontrollohet përveçse përmes tekvasë, devotshmërisë.[1]

[1] Takimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik me burrat e shtetit, me rastin e festës së bekuar të Dërgesës Profetike (Mab'ath); 7/9/1376 sipas kalendarit iranian, 27/11/1997.

Qëllimi i përsëritjes së emrit të shejtanit dhe konceptit të shejtanizmit në Kur'an

Që Islami të mund t'u sigurojë njerëzve lumturinë, ai duhet të luftojë dhe të përballet me faktorët dhe elementët që qëndrojnë kundër njerëzimit dhe njeriut, dhe që e marrin fuqinë e tyre nga kjo kundërshtim. Për këtë arsye, në Islam ekziston xhihadi dhe një përpjekje e vështirë kundër së keqes. Emri i shejtanit dhe koncepti i shejtanizmit janë përmendur në pjesë të ndryshme të Kur'anit më shumë se shumë koncepte dhe shprehje të tjera, në mënyrë që njerëzit të mos e harrojnë shejtanin dhe praninë e tij në jetën njerëzore.[1]

Kush janë hipokritët (*munafikët*)?

Kur'ani flet për disa njerëz, në fillimet e Islamit, në kohën e shfaqjes së tij, dhe i përshkruan ata si hipokritë (munafikë): **"Në zemrat e tyre ka një sëmundje."** Këta janë njerëz neutralë, të cilët nuk ndërmarrin asnjë veprim. Janë frikacakë, të tërhequr nga përballja me jetën dhe prej atyre që kërkojnë një jetë të rehatshme në kohë të vështira dhe në rrethana të rënda.

Kur përballen me armiqtë dhe kur krizat forcohen e problemet në shoqëri shtohen, ata zhduken nga skena. Kur'ani thotë:

﴿فَإِذَا جَاء الْخَوْفُ رَأَيْتَهُمْ يَنظُرُونَ إِلَيْكَ﴾

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm para një tubimi të madh popullor në qytetin Amol, në veri të Iranit; 21/3/1377 sipas kalendarit iranian, 10/6/1998.

"Kur vjen frika, ti i sheh ata duke të shikuar ty…"[1] Domethënë, ata i ngulin sytë te ti sikur vdekja të jetë para tyre. Pse ndodh kjo? Sepse ata kanë frikë nga vdekja dhe ndiejnë rrezikun që u afrohet. Por, sapo të kalojë alarmi i rrezikut dhe kur fusha nuk është më një vend ku shfaqet vlera e vërtetë e njeriut, atëherë ata ndryshojnë sjellje. Kur fusha bëhet një mundësi për përfitime personale, Kur'ani thotë:

﴿فَإِذَا ذَهَبَ الْخَوْفُ سَلَقُوكُم بِأَلْسِنَةٍ حِدَادٍ أَشِحَّةً عَلَى الْخَيْرِ﴾

"…E kur largohet frika, ata ju godasin me gjuhë të mprehta, duke qenë koprracë ndaj së mirës." Këta janë njerëzit që mungojnë dhe fshihen nga fushat e burrërisë dhe trimërisë; ata ikin nga arenat e xhihadit, rezistencës dhe sakrificës.

Në skena dhe situata ku, në dukje, nuk përballen me rrezik, ata shfaqen dhe me gjuhët e tyre sulmojnë besimtarët, të rinjtë e angazhuar në mbrojtje dhe familjet e dëshmorëve. Këto qëndrime nuk ishin momente krenarie dhe nderi, që Kur'ani t'i shikonte me admirim dhe miratim.[2]

[1] Sure "El-Ahzab", ajeti 19.

[2] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm para një tubimi të madh popullor në qytetin Amol, në veri të Iranit; 21/3/1377 sipas kalendarit iranian, 10/6/1998.

Çlirimi nga detyrimet dhe aleancat e imponuara, kufizimet dhe traditat e gabuara shoqërore

Çështja e lirisë është një koncept që është përmendur në Kur'an dhe në fjalët e Imamëve të pagabueshëm (Paqja qoftë mbi ta!) në mënyrë të theksuar dhe të përsëritur.

Natyrisht, ajo që nënkuptojmë këtu me lirinë nuk është liria absolute dhe e pakufizuar, të cilën askush në botë nuk e mbështet dhe nuk e ndjek si metodë. Nuk mendoj se ekziston ndonjë njeri në botë që të thërrasë për një liri tërësisht pa kufij.

Gjithashtu, nuk kemi për qëllim as atë liri shpirtërore dhe morale që ekziston në Islam, e cila është ndër nivelet më të larta të njohurive dhe mësimeve islame, sepse ajo nuk është pjesë e temës sonë në këtë rast. Liria shpirtërore është diçka që pranohet nga të gjithë ata që besojnë në vlera dhe kuptime shpirtërore dhe nuk është objekt kundërshtimi apo dyshimi.

Por, liria për të cilën flasim këtu është liria shoqërore, pra një e drejtë njerëzore që i lejon njeriut të mendojë, të shprehë mendimin e tij, të zgjedhë dhe të kryejë veprime të ngjashme me këto. Kjo çështje është vlerësuar dhe theksuar në Kur'an dhe në traditën profetike. Ajeti 157 i sures "El-A'raf" thotë:

﴿الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الرَّسُولَ النَّبِيَّ الأُمِّيَّ الَّذِي يَجِدُونَهُ مَكْتُوبًا عِندَهُمْ فِي التَّوْرَاةِ وَالإِنْجِيلِ يَأْمُرُهُم بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَاهُمْ عَنِ الْمُنكَرِ وَيُحِلُّ لَهُمُ الطَّيِّبَاتِ وَيُحَرِّمُ عَلَيْهِمُ الْخَبَآئِثَ وَيَضَعُ عَنْهُمْ إِصْرَهُمْ وَالأَغْلاَلَ الَّتِي كَانَتْ عَلَيْهِمْ﴾

"Ata që ndjekin të Dërguarin, Profetin analfabet, të cilin e gjejnë të shkruar tek ata në Teurat dhe Ungjill; ai i urdhëron për të mirë, i ndalon nga e keqja, ua lejon të mirat dhe ua ndalon të këqijat, dhe ua heq barrët e tyre dhe prangat që ishin mbi ta."

Allahu i Madhëruar e ka vendosur si një prej veçorive të profetëve (Paqja qoftë mbi ta!) që ata t'u heqin njerëzve prangat dhe kufizimet dhe t'i largojnë prej tyre "isrin" (إصر), domethënë detyrimet e padrejta dhe të imponuara mbi njerëzit. Kjo shprehje ka një kuptim shumë të gjerë dhe të mahnitshëm. Nëse përfytyrojmë gjendjen e shoqërive fetare dhe jo-fetare të asaj kohe, siç e dini, fjala "*isr*", që nënkupton zotimet, marrëveshjet dhe detyrimet e imponuara mbi njerëzit, përfshinte shumë bindje dhe besime të kota e të pavërteta, si dhe shumë kufizime të gabuara shoqërore që u ishin imponuar njerëzve përmes tiranisë, shtrembërimit të së vërtetës ose mashtrimit të mendjeve. Ndërsa kuptimi i fjalës "pranga" (اغلال) është, gjithashtu, i qartë.[1]

Liria shoqërore në Kur'anin e Shenjtë është në shërbim të vlerave, moralit dhe përparimit të shoqërisë

Liria shoqërore, për të cilën thërret Kur'ani dhe të cilën Islami e vlerëson, nëse përdoret për të shkatërruar dhe për të asgjësuar arritjet e çmuara materiale ose shpirtërore të një populli,

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit në ceremoninë e diplomimit të disa studentëve të Universitetit "Tarbiat Modares"; 12/6/1377 sipas kalendarit iranian, 2/9/1998.

dhe nëse shfrytëzohet në mënyrë negative, atëherë ajo bëhet e dëmshme dhe shkatërruese për jetën e njeriut. Kur'ani thotë:

﴿مَن قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ النَّاسَ جَمِيعًا﴾

"Kush vret një njeri pa qenë ai vrasës i dikujt tjetër ose pa bërë shkatërrim në tokë, është sikur të ketë vrarë mbarë njerëzimin."[1]

Sipas logjikës së Kur'anit të Shenjtë, vrasja e një njeriu të vetëm është e barabartë me vrasjen e të gjithë njerëzve. Ky është një koncept jashtëzakonisht i thellë. Ai që ngre dorën për të vrarë një njeri të vetëm, është sikur ka vrarë tërë njerëzimin, sepse ky veprim përbën shkelje të shenjtërisë dhe dinjitetit të gjithë njerëzimit. Megjithatë, Kur'ani përmend edhe disa përjashtime**: "Pa qenë për hakmarrje ndaj një vrasjeje ose për shkak të përhapjes së shkatërrimit në tokë."** Natyrisht, kjo nuk përbën kufizim të lirisë dhe as kufizim të së drejtës për jetë, sepse vlerat dhe të vërtetat themelore janë të pandryshueshme dhe të vetëkuptueshme. Prandaj, liria shoqërore në këndvështrimin kur'anor nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet për të mbrojtur vlerat njerëzore, për të ruajtur dinjitetin e njeriut dhe për ta ngritur shoqërinë drejt një jete më të mirë, më të drejtë dhe më të ndershme.[2]

Kufijtë dhe caqet e lirisë

Liria nuk është një gënjeshtër apo mashtrim. Liria nuk do të thotë përhapje e thashethemeve, lajmeve të rreme dhe

[1] Sure "El-Maide", ajeti 32.

[2] Po aty (fjalimi i Udhëheqësit i përmendur më sipër).

informacioneve shqetësuese që mbjellin frikë te njerëzit. Në këtë drejtim, kam një vërejtje për vëllezërit intelektualë dhe studiues: përse nuk u kthehen burimeve dhe mësimeve islame kur flasin për çështjen e lirisë?

Kur'ani i Shenjtë thotë:

﴿لَئِن لَّمْ يَنتَهِ الْمُنَافِقُونَ وَالَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٌ وَالْمُرْجِفُونَ فِي الْمَدِينَةِ لَنُغْرِيَنَّكَ بِهِمْ﴾

"Nëse hipokritët, ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre dhe përhapësit e panikut në Medinë nuk ndalen, Ne do të të nxisim kundër tyre."[1]

Vërejmë se Kur'ani i vendos hipokritët, ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre dhe përhapësit e panikut e të thashethemeve në të njëjtin front, pra si tri grupe që veprojnë së bashku. Me fjalën "*murxhifun*" (المرجفون) nënkuptohen ata që vazhdimisht përhapin frikë dhe pasiguri te njerëzit.

Përpara nesh qëndron një shoqëri e re, e cila sapo ka filluar të forcohet, ndërsa armiqtë e saj janë të shumtë. Ata që janë besnikë ndaj Kur'anit dhe ndjekin rrugën e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) duhet të jenë të përgatitur shpirtërisht për të mbrojtur atdheun dhe këtë sistem popullor.

Ekziston një grup njerëzish që sulmojnë shpresën e njerëzve si një sëmundje ngjitëse, duke ua marrë optimizmin, duke ua

[1] Sure "El-Ahzab", ajeti 60.

dobësuar vendosmërinë dhe duke ua thyer forcën morale. Këta janë pikërisht përhapësit e panikut.

Kur'ani thotë se nëse ata që përhapin thashetheme, frikë dhe dëshpërim te populli nuk ndalen, nëse vazhdojnë t'ua vrasin shpresën njerëzve dhe t'i pengojnë ata të marrin pjesë në skenat e përballjes dhe të sakrificës, atëherë: **"Ne do të të nxisim kundër tyre."** Pra, sipas këtij këndvështrimi, këtu gjenden kufijtë e lirisë. Mbi këtë bazë thuhet se liria, sipas logjikës islame, ndryshon nga format e tjera të lirisë, sepse ajo vepron brenda kufijve të vlerave dhe normave morale.

Një dallim tjetër ndërmjet lirisë islame dhe lirisë sipas teorisë liberale perëndimore është marrëdhënia e saj me detyrimin (përgjegjësinë). Sipas këtij këndvështrimi, liria perëndimore nënkupton çlirimin nga detyrimi dhe përgjegjësia, ndërsa liria islame është ana tjetër e së njëjtës medalje me detyrimin.

Njeriu është i lirë pikërisht sepse është i ngarkuar me përgjegjësi dhe detyrime. Nëse nuk do të kishte përgjegjësi, liria nuk do të kishte kuptim dhe ne do të ishim si melekët, të cilët nuk përballen me zgjedhje dhe sprova.[1]

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit në ceremoninë e diplomimit të disa studentëve të Universitetit "Tarbiat Modares"; 12/6/1377 sipas kalendarit iranian, 2/9/1998.

Martirizimi është një dhuratë dhe mirësi nga Allahu

Shprehja që Allahu i Madhëruar përdor për martirizimin është një shprehje e veçantë. Nga këndvështrimi i Kur'anit, vrasja në rrugën e Allahut nuk është thjesht vdekje e zakonshme. Kur'ani thotë: **"A nëse ai vdes ose vritet…"**

Kur'ani nuk e konsideron të barabartë vrasjen në rrugën e Allahut me vdekjen e zakonshme. Përkundrazi, sipas standardit hyjnor dhe nga këndvështrimi i Islamit dhe i Kur'anit, rënia dëshmor në rrugën e Allahut mbart një kuptim tjetër, një domethënie më të lartë dhe më fisnike se vdekja e zakonshme.

Prandaj, ai që përfshihet nga kjo dhuratë, nga ky udhëzim hyjnor dhe nga kjo përkujdesje e veçantë e Zotit, duke u bërë dëshmor në rrugën e Allahut, duhet të jetë falënderues ndaj Allahut të Madhëruar për këtë mirësi dhe begati.[1]

Kultura është identiteti kolektiv i një populli

Kultura është një tërësi e gjallë dhe dinamike që lidhet drejtpërdrejt me njeriun. Ajo është rezultat i zakoneve, traditave dhe bindjeve që i përkasin një shoqërie.

Pa dyshim, disa prej këtyre zakoneve dhe bindjeve janë trashëguar natyrshëm nga brezat e kaluar te brezi i tanishëm,

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik para një numri të madh familjesh të dëshmorëve të Forcave të Armatosura dhe të Institucionit të "Xhihadit të Ndërtimit dhe Rindërtimit"; 5/7/1377 sipas kalendarit iranian, 26/9/1998.

ndërsa disa të tjera janë fituar dhe formuar nga përpjekjet dhe veprimtaria e vetë brezit aktual.

Në të vërtetë, kultura është identiteti dhe kombësia kolektive e një populli. Është ai identitet i përbashkët që i detyron të gjithë ta ruajnë, ta mbrojnë dhe të kujdesen për të. Këto kuptime mund t'i shohim edhe në Kur'anin e Shenjtë, ku Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَدَّ الَّذِينَ كَفَرُواْ لَوْ تَغْفُلُونَ عَنْ أَسْلِحَتِكُمْ وَأَمْتِعَتِكُمْ فَيَمِيلُونَ عَلَيْكُم مَّيْلَةً وَاحِدَةً﴾

"Ata që mohojnë, dëshirojnë që ju të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve dhe pajisjeve tuaja, që pastaj të sulen kundër jush me një sulm të vetëm."[1] Pra, armiku juaj dëshiron që të bëheni të pakujdesshëm ndaj dy gjërave:

1- (armëve tuaja), të cilat simbolizojnë mbrojtjen dhe gatishmërinë ushtarake;

2- (pasurisë dhe mjeteve tuaja), të cilat në të vërtetë përfaqësojnë të gjitha kapitalet, mundësitë dhe asetet që zotëroni.

Prandaj, nëse tregoheni të pakujdesshëm ndaj realitetit të mbrojtjes dhe ndaj vlerës së kapitalit dhe pasurisë suaj, atëherë do të realizohet ajo që thotë Kur'ani: **"Dhe ata do të vërsulen kundër jush me një sulm të vetëm."** Sulmi do të jetë i papritur dhe armiku do të përfitojë nga mungesa e përgatitjes. Kur nuk ekzistojnë mbrojtja, fortifikimi dhe njerëz të gatshëm për të mbrojtur kufijtë, vendin dhe qytetet, atëherë depërtimi dhe sulmi i armikut bëhen të

[1] Sure "En-Nisa", ajeti 102.

lehta dhe të mundshme. Në këtë kuptim, ruajtja e kulturës, ashtu si ruajtja e sigurisë dhe e pasurisë së një populli, është pjesë e mbrojtjes së identitetit dhe ekzistencës së tij kolektive.[1]

Kur'ani jep zgjidhje për krizat familjare

Ne shohim në historinë e Islamit se dëshmorja e parë ndër myslimanët ishte një grua. Gjithashtu, vërejmë shumë kujdes, vëmendje dhe respekt që feja islame i kushton gruas. Kur brenda familjes lindin kriza të rënda dhe probleme serioze që prekin gratë, feja ndërhyn me urtësi dhe butësi përmes Kur'anit të Shenjtë, duke paraqitur një zgjidhje për kapërcimin e krizës. Kjo zgjidhje është përmendur në forma të ndryshme dhe në mënyrë të përsëritur në Kur'an:

﴿فَإِمْسَاكٌ بِمَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحٌ بِإِحْسَانٍ﴾

"Ose mbajtje (e martesës) **me mirësi, ose ndarje me bamirësi e dinjitet."**[2]

Kur'ani thekson se jeta familjare duhet të ndërtohet mbi këtë parim dhe këtë metodë. Feja nuk pranon diçka tjetër përveç kësaj rruge: Ose jeta bashkëshortore vazhdon mbi bazën e sjelljes së mirë, respektit të ndërsjellë, lumturisë dhe qetësisë; ose, nëse vazhdimi i saj nuk është më i mundur, atëherë vjen ndarja dhe divorci. Por

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm në takimin me një grup grash, me rastin e përvjetorit të lindjes së zonjës Fatime ez-Zehra (Paqja e Allahut qoftë mbi të!); 18/7/1377 sipas kalendarit iranian, 9/10/1998.

[2] Sure "El-Bekare", ajeti 229.

edhe divorci duhet të kryhet me drejtësi, fisnikëri dhe mirësi, larg padrejtësisë, hakmarrjes dhe fyerjeve. Kjo është qasja kur'anore për zgjidhjen e krizave familjare: ose bashkëjetesë me dinjitet, ose ndarje me dinjitet.[1]

Përkushtimi ndaj fesë sjell qetësi dhe siguri shpirtërore

Një nga detyrat dhe përgjegjësitë e dijetarëve dhe predikuesve fetarë, dhe kjo përgjegjësi konsiderohet, gjithashtu, pjesë e misionit të kumtimit të fesë, është që të mbjellin qetësi dhe siguri në zemrat e besimtarëve.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿هُوَ الَّذِي أَنزَلَ السَّكِينَةَ فِي قُلُوبِ الْمُؤْمِنِينَ﴾

"Ai është që zbriti qetësinë në zemrat e besimtarëve."[2]

Es-Sakinetu (qetësia) nënkupton stabilitetin shpirtëror dhe intelektual. E kundërta e saj është shqetësimi mendor, trazimi psikologjik dhe pamundësia për të kontrolluar mendimet dhe ndjenjat, gjë që e shtyn njeriun drejt llojeve të ndryshme të mjerimit individual dhe çrregullimeve shoqërore. Nëse sot do të vështronit gjendjen e botës së zhvilluar, të mbushur me teknologji, shkencë, industri të përparuara dhe arritje shkencore, veçanërisht në vendet që pretendojnë udhëheqjen e botës, si Evropa dhe Amerika, do të kuptonit se një nga problemet më të mëdha me të cilat përballet

[1] Po aty (fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm, i përmendur më sipër).

[2] Sure "El-Fet'h", ajeti 4.

Perëndimi është pikërisht kriza e mungesës së qetësisë dhe sigurisë së brendshme.

Duhet theksuar se qetësia dhe siguria për të cilat na mëson dhe na porosit Kur'ani janë krejtësisht të ndryshme nga gjendja e dikujt që është në gjumë, apo që është i mpirë dhe i pavetëDitur. Ato nuk kanë të bëjnë as me gjendjen e narkozës apo të humbjes së vetëdijes. Feja e vërtetë dhe e shëndoshë nuk vepron si një narkotik që i mpin njerëzit. Përkundrazi, ajo i çliron ata nga mpirja mendore dhe shpirtërore që mund t'i ketë kapluar për shkak të rrethanave dhe faktorëve të ndryshëm. Ajo largon pakujdesinë dhe zgjon vetëdijen, duke i kthyer njerëzit te vetja e tyre dhe, njëkohësisht, duke i shpëtuar nga hutimi dhe konfuzioni intelektual.

Feja e drejtë dhe e shëndoshë sjell te njeriu qetësi, siguri, qartësi, vetëbesim, mbështetje tek Allahu dhe shpresë për të ardhmen. Prandaj, përhapja dhe mbjellja e kësaj gjendjeje te besimtarët, te dëgjuesit dhe te njerëzit në përgjithësi, është një nga detyrat më të rëndësishme të predikuesve dhe thirrësve në rrugën e fesë.[1][136]

Marikët dhe ata që ikin nga detyrimet fetare

Fjala "*marik*" (المارق) do të thotë ai që largohet dhe arratiset. Ky emërtim është përdorur për khavarixhët, sepse thuhej se ata

[1] Takimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik me një grup dijetarësh fetarë dhe predikuesish, në prag të ardhjes së muajit të bekuar të Ramazanit; 23/9/1377 sipas kalendarit iranian, 29/11/1998.

largoheshin nga feja ashtu siç del shigjeta nga harku. Kur vendoset shigjeta në hark dhe lëshohet, ajo largohet me shpejtësi nga vendi i saj, fluturon përpara dhe ndahet nga pika e nisjes. Në të njëjtën mënyrë, edhe këta njerëz u larguan nga feja.

Natyrisht, ata kapeshin fort pas formave dhe dukjeve të jashtme të fesë dhe e përmendnin vazhdimisht fenë me gjuhë. Këta ishin havarixhët, një grup që i ndërtoi parimet dhe veprimet e veta mbi një kuptim dhe interpretim të devijuar të fesë.

Kjo ishte një çështje shumë e rrezikshme, sepse ata nuk e mësuan fenë nga imam Ali ibn Ebi Talibi (Paqja qoftë mbi të!), i cili ishte komentuesi i Kur'anit dhe njohësi i Dijes së Librit. Ndërkohë, organizimi dhe drejtimi i tyre kishte nevojë për politika të veçanta, dhe këto politika u vinin nga burime të tjera.

Pika e rëndësishme është se anëtarët e këtij grupi ishin gjithmonë të gatshëm t'i përgjigjeshin çdo çështjeje me ndonjë ajet të Kur'anit. Ata merrnin pjesë edhe në namazin e imam Aliut (Paqja qoftë mbi të!), por më pas lexonin ajete që synonin të cenonin pozitën dhe nderin e Prijësit të besimtarëve.

Po ashtu, kur imam Aliu mbante fjalime, ata ngriheshin në mes të tubimit dhe lexonin ajete që përdoreshin për të sulmuar dhe lënduar pozitën e tij. Ata këmbëngulnin në parullën: *"Nuk ka gjykim dhe sundim veçse për Allahun."*

Me këtë ata synonin të thoshin: 'Ne nuk e pranojmë qeverisjen tënde; ne njohim vetëm qeverisjen e Allahut.' Kështu, ata përdornin slogane fetare dhe ajete kur'anore, por për shkak të

kuptimit të gabuar dhe interpretimit të devijuar, kishin marrë rrugë larg nga thelbi i vërtetë i fesë.[1]

Përmendja dhe karakteristikat e forcave të liga në Kur'an

Shejtani në Kur'an përfaqëson pasqyrimin e forcave të liga, korruptuese dhe të degjeneruara, të cilat qëndrojnë përballë profetëve (Paqja qoftë mbi ta!). Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَكَذَلِكَ جَعَلْنَا لِكُلِّ نَبِيٍّ عَدُوًّا شَيَاطِينَ الإِنسِ وَالْجِنِّ﴾

"Kështu, Ne i kemi caktuar çdo profeti armiq prej shejtanëve të njerëzve dhe të xhinëve."[2]

Përmendja e shejtanëve dhe përshkrimi i cilësive të tyre është përsëritur shumë herë në Kur'anin e Shenjtë. Ata janë përmendur gjatë gjithë periudhës së zbritjes së shpalljes mbi zemrën e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Kjo tregon se nuk duhet ta harrojmë dhe as të bëhemi të pakujdesshëm ndaj këtij armiku në shoqëritë islame.

Kur'ani, duke e përmendur vazhdimisht shejtanin dhe forcat shejtanore, synon të mbajë të gjallë te besimtarët vetëdijen për rrezikun e tyre, në mënyrë që ata të jenë gjithmonë vigjilentë

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik në namazin e xhumasë në Teheran; 18/10/1377 sipas kalendarit iranian, 7/1/1988.
[2] Sure "El-En'am", ajeti 112.

ndaj çdo force që përhap devijim, shkatërrim dhe armiqësi ndaj rrugës së Allahut dhe të profetëve të Tij.[1]

Devotshmëria- vigjilencë, vetëkontroll dhe mosdevijim nga rruga

Gjëja më e rëndësishme për njeriun është që jeta e tij të ndërtohet mbi vetëdijen, vigjilencën dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të vetes, në mënyrë që të mos humbasë rrugën, të mos largohet nga qëllimi dhe të mos devijojë nga udha e drejtë. Po ashtu, njeriu duhet të ketë vendosmëri dhe vullnet të fortë për të arritur synimet dhe idealet që i ka caktuar vetes. Kjo vigjilencë e brendshme, e cila e drejton njeriun drejt lëvizjes së drejtë dhe ecjes së sigurt në jetë, është ajo gjendje që në terminologjinë islame dhe në kulturën kur'anore quhet devotshmëri (*tekva*).

Nëse meditojmë mbi Kur'anin e Shenjtë, do të shohim se të gjitha të mirat dhe begatitë janë të lidhura me devotshmërinë. Nga njëra anë janë të mirat shpirtërore, morale dhe të Botës Tjetër, ndërsa nga ana tjetër janë të mirat materiale dhe shoqërore të kësaj bote; të gjitha ato janë të lidhura me devotshmërinë. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ الْقُرَى آمَنُواْ وَاتَّقَواْ لَفَتَحْنَا عَلَيْهِم بَرَكَاتٍ مِّنَ السَّمَاء وَالأَرْضِ﴾

[1] Cituar nga mesazhi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik drejtuar haxhinjve të Shtëpisë së Shenjtë të Allahut; 12/1/1377 sipas kalendarit iranian, 31/3/1998.

"Sikur banorët e vendbanimeve të kishin besuar dhe të kishin pasur takva, Ne do t'u hapnim atyre begatitë e qiellit dhe të tokës."[1]

Po, devotshmëria e bën jetën të ëmbël, të bukur dhe të begatë. Ajo përfundon me nder, dinjitet dhe krenari për besimtarët, ndërsa për armiqtë e së vërtetës sjell zhgënjim dhe dështim. Prandaj, ajo vigjilencë dhe vetëmbikëqyrje për të cilën flitet në Kur'an dhe në hadithet e Profetit dhe Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), është pikërisht devotshmëria.[2]

Pasojat dhe frytet e takvasë në jetën e njeriut

Një nga frytet dhe rezultatet e devotshmërisë është se Allahu i Madhëruar vendos bereqet në veprat dhe përpjekjet tona. Nëse njeriu vëren efektet që Kur'ani përmend si rezultat i takvasë, ai do të gjejë përgjigje të mjaftueshme për shumë pyetje, dyshime dhe shqetësime që mund t'i lindin në mendje. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿مَن يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَل لَّهُ فُرْقَانًا﴾

"**Kush është i devotshëm ndaj Allahut, Ai do t'i japë atij furkan** (aftësinë për të dalluar)."[3]

---

[1] Sure "El-A'raf", ajeti 96.

[2] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik në takimin e tij me forcat e rregullta ushtarake, me rastin e Ditës së Ushtrisë; 25/1/1378 sipas kalendarit iranian, 13/4/1999.

[3] Sure "El-Enfal", ajeti 29.

Kjo do të thotë se Allahu u jep njerëzve të devotshëm gjendjen e dallimit, pra një largpamësi dhe mprehtësi shpirtërore me të cilën ata dallojnë të vërtetën nga e kota. Falë kësaj, rruga e së vërtetës nuk ngatërrohet me rrugën e së pavërtetës. Përkundrazi, udha bëhet e qartë dhe e hapur, sepse kur njeriu e njeh të vërtetën dhe të kotën, ai ecën drejt qëllimit me moral të lartë, vendosmëri dhe guxim.

Po ashtu, Kur'ani thotë:

﴿وَمَن يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَل لَّهُ مَخْرَجًا﴾

"Kush është i devotshëm ndaj Allahut, Ai do t'i hapë një rrugëdalje."[1]

Kjo gjendje e çliron njeriun nga vështirësitë, ngushticat dhe situatat e vështira, duke i përgatitur atij rrugën e shpëtimit dhe të lehtësimit.

Më tej Allahu thotë:

﴿وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ﴾

"Dhe do ta furnizojë nga aty ku ai as nuk e pret."[2]

Domethënë, Allahu i Madhëruar do t'i sjellë furnizim dhe mirësi nga rrugë që ai nuk i kishte llogaritur dhe nuk i kishte parashikuar. Kështu, devotshmëria nuk sjell vetëm shpërblime në

[1] Sure "Et-Talak", ajeti 2.

[2] Sure "Et-Talak", ajeti 3.

Botën Tjetër, por edhe udhëzim, qartësi, zgjidhje të vështirësive dhe bereqet në jetën e kësaj bote.[1]

Zemrat e vulosura dhe zemrat e mbyllura

Allahu i Madhëruar u drejtohet bijve të Izraelit në një prej ajeteve të Kur'anit duke thënë:

﴿فَمَا زِلْتُمْ فِي شَكٍّ مِّمَّا جَاءَكُم بِهِ﴾

"Ju vazhduat të jeni në dyshim për atë që ai ju solli."[2]

Madje edhe kur Profeti Jusuf (Paqja qoftë mbi të!) ishte në kulmin e fuqisë dhe autoritetit të tij, dhe e vërteta hyjnore ndriçonte nga fytyra e tij e bekuar, ndërsa sistemi i tij i drejtë dhe i qëndrueshëm shkëlqente si dielli, përsëri kishte njerëz nga Beni Israilët që nuk e kuptonin dhe nuk e pranonin atë.

Kur Jusufi (Paqja qoftë mbi të!) ndërroi jetë dhe u largua nga kjo botë, ata thanë: "Pas Jusufit nuk do të vijë më asnjë profet!" Kjo tregon se disa zemra bëhen aq të mbyllura dhe të vulosura, saqë nuk e pranojnë të vërtetën, edhe kur ajo është e qartë dhe e dukshme.

Më pas ajeti vazhdon:

---

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik në takimin e tij me Presidentin e Republikës dhe Këshillin e Ministrave, me rastin e Javës së Qeverisë; 2/6/1378 sipas kalendarit iranian, 23/8/1999.

[2] Sure "El-Mu'min", ajeti 34.

﴿كَذَلِكَ يَطْبَعُ اللَّهُ عَلَى كُلِّ قَلْبِ مُتَكَبِّرٍ جَبَّارٍ﴾

"Kështu Allahu vulos çdo zemër të mendjemadhit dhe tiranit."[1]

Po ashtu, në një ajet tjetër thuhet:

﴿مِّن كُلِّ مُتَكَبِّرٍ لَّا يُؤْمِنُ بِيَوْمِ الْحِسَابِ﴾

"Të çdo mendjemadhi që nuk beson në Ditën e Llogarisë."[2]

Prandaj, një nga shkaqet kryesore të mbylljes së zemrës është mendjemadhësia dhe refuzimi i së vërtetës. Kur njeriu e lë veten të pushtohet nga arroganca dhe kryelartësia, ai gradualisht humbet aftësinë për ta parë dhe pranuar të vërtetën, derisa zemra e tij vuloset dhe mbetet e mbyllur ndaj udhëzimit të Allahut.[3]

Të vërtetat kur'anore

Një nga problemet me të cilat përballen popujt sot është se ata ndihen të dobët dhe të pafuqishëm kur përballë tyre qëndrojnë armiq të fuqishëm.

Shikoni rendin e sigurisë dhe marrëdhëniet diplomatike në gjeografinë politike të botës. Vëreni me kujdes ato fuqi që sillen

[1] Sure "El-Mu'min", ajeti 35.

[2] Sure "El-Mu'min", ajeti 27.

[3] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik në takimin e tij me komandantët dhe me një numër të madh anëtarësh të Gardës së Revolucionit Islamik, me rastin e përvjetorit të lindjes së Imam Hysejn ibn Aliut – 3 Sha'ban, Dita e Gardës; 22/8/1378 sipas kalendarit iranian, 12/11/1999.

sikur çdo gjë në botë u përket atyre, ndërsa popujt e tjerë nuk kanë asnjë peshë në llogaritjet e tyre. Ata kanë përvetësuar dhe uzurpuar burimet njerëzore dhe materiale, duke i monopolizuar ato për vete. Kjo ndodh nëpërmjet fuqive arrogante dhe hegjemoniste.

Mendoni thellë: Mbi çfarë mbështeten këto fuqi botërore? Një nga mjetet më të rëndësishme mbi të cilat ato mbështeten është krijimi i bindjes te popujt se fuqia e tyre është e pathyeshme dhe se askush nuk mund t'u kundërvihet apo t'u rezistojë.

Nëse flisni me intelektualët e vendeve të botës së tretë, përfshirë edhe vendet islame, apo me politikanët dhe njerëzit e thjeshtë, dhe i pyesni: "Pse nuk ngriheni për të rimarrë të drejtat tuaja të humbura?", shpesh do të dëgjoni këtë përgjigje: 'Ne nuk mundemi. Nuk kemi fuqi të mjaftueshme për ta bërë këtë. Fuqitë e mëdha na kanë marrë gjithçka dhe ne nuk jemi në gjendje të përballemi me to.' Ky është logjika e atyre që bien prê e ndjenjës së dobësisë dhe dorëzimit.

Por e vërteta kur'anore paraqet një pamje krejt tjetër. Ajo thotë se kur njerëzit mbështeten në potencialet e tyre, në besimin, vullnetin, unitetin dhe gatishmërinë për sakrificë, atëherë asnjë fuqi nuk mund t'u rezistojë.

Gjatë periudhës së *tagutit* (regjimit të Shahut në Iran), ne, bijtë e popullit iranian, bëmë një gabim të madh. Nëse dikush na pyeste në atë kohë: Regjimi ka grabitur naftën dhe pasuritë e vendit, ka nënshtruar Iranin ndaj Amerikës, ka cenuar vlerat dhe ka dëmtuar historinë e këtij populli, pse nuk ngriheni kundër kësaj?

Përgjigjja që dëgjohej nga shumë intelektualë dhe politikanë ishte: 'Ne nuk mund të bëjmë asgjë.'

Lëvizja e Imam Khomeinit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe mësimi i madh që ai dha, madje shërbimi më i madh që ai i bëri popullit iranian dhe popujve të tjerë, ishte se ai e përgënjeshtroi këtë mentalitet të dështuar. Ai iu drejtua popullit duke thënë: "Ju mundeni. Ju keni aftësinë për ta bërë këtë. Duhet të merrni vendim, të forconi vullnetin tuaj dhe të veproni me vendosmëri. Elitat, figurat udhëheqëse dhe ata që ndikojnë te njerëzit duhet të dalin në skenë. Populli duhet të jetë i gatshëm për sakrificë dhe vetëmohim."

Kur këto kushte plotësohen, çdo gjë bëhet e mundur dhe njeriu arrin lloje të ndryshme suksesi dhe fitoreje. Vetë Imami ishte personi i parë që doli në skenë dhe hyri në këtë përballje.[1]

Mirësia dhe përmirësimi pas pendimit

Disa vepra kanë nevojë për pendim (*teube*), ndërsa disa të tjera nuk mjafton vetëm pendimi për to, sepse përmirësimi dhe korrigjimi i pasojave të tyre mund të jetë i pamundur. Vëreni se si Kur'ani i Shenjtë, pas përmendjes së pendimit, shpesh shton edhe shprehjen "dhe u përmirësuan":

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm në tubimin e madh të kortezheve të zisë në oborrin e shenjtë të mauzoleut të Imam Khomeinit (r.a.), me rastin e përvjetorit të ndarjes së tij të dhimbshme nga kjo jetë; 14/3/1379 sipas kalendarit iranian, 3/6/2000.

﴿إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا وَأَصْلَحُوا﴾

"Përveç atyre që pendohen dhe përmirësohen."[1]

Nganjëherë pendimi lidhet me veprat tona personale. Për shembull, kur bëjmë gabime ose gjynahe në çështje individuale, i drejtohemi Allahut të Madhëruar dhe themi:

﴿رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِن نَّسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا ... وَاعْفُ عَنَّا وَاغْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا﴾

"Zoti ynë! Mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë... Na fal, na mbulo me faljen Tënde dhe na mëshiro."[2]

Në raste të tilla, çështja përfundon dhe dosja mbyllet mes njeriut dhe Zotit të tij. Por ka disa gjynahe që ndikojnë drejtpërdrejt në shoqëri. Ato krijojnë gjendje të reja, ose shkatërrojnë gjendje të mira që ekzistonin më parë. Në këto raste, pendimi i vërtetë kërkon që të shfaqet edhe përmirësimi (islah), pra korrigjimi i pasojave të atyre sjelljeve të gabuara. Megjithatë, a është e mundur gjithmonë të korrigjohen pasojat? A mund t'i kthejmë gjithnjë gjërat në gjendjen e tyre normale? Pikërisht për këtë arsye njeriu duhet të jetë sa më i kujdesshëm dhe vigjilent në veprimet e tij, duke menduar për pasojat e tyre para se t'i kryejë.[3]

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 160.

[2] Sure "El-Bekare", ajeti 286.

[3] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm në takimin e tij me përgjegjësit e Pushtetit Gjyqësor dhe familjet e dëshmorëve të tragjedisë së 7 Tirit – përvjetori i martirizimit të doktor Beheshtiut dhe 72 të tjerëve nga drejtuesit e lartë dhe deputetët e Mexhlisit; 7/4/1379 sipas kalendarit iranian, 27/6/2000.

Perëndimorët janë më shumë se 13 shekuj prapa Islamit në moral dhe vlera shpirtërore

Gratë janë pararojë në lëvizjet shpirtërore, shoqërore dhe njerëzore drejt përparimit dhe përsosjes. Prandaj, kur Kur'ani i Shenjtë dëshiron të paraqesë një shembull të besimtarit të vërtetë, ai thotë:

﴿وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا لِّلَّذِينَ آمَنُوا اِمْرَأَةَ فِرْعَوْنَ﴾

"Allahu u sjell si shembull besimtarëve gruan e Faraonit."[1]

Këtu shembulli i besimit paraqitet përmes një gruaje. Kur vjen fjala te besimi, Islami, durimi, sinqeriteti, xhihadi në rrugën e Allahut dhe fitimi i vlerave njerëzore, islame dhe shpirtërore, Kur'ani thotë:

﴿إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْقَانِتِينَ وَالْقَانِتَاتِ وَالصَّادِقِينَ وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ...﴾

"Me të vërtetë, myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtaret, të përkushtuarit dhe të përkushtuarat, të sinqertët dhe të sinqertat, durimtarët dhe durimtaret..."[2]

Në këtë ajet përmenden dhjetëra vlera shpirtërore, si: Islami, besimi, përkushtimi ndaj Allahut, sinqeriteti, durimi, përulësia dhe

[1] Sure "Et-Tahrim", ajeti 11.

[2] Sure "El-Ahzab", ajeti 35.

të tjera. Në të gjitha këto fusha, gruaja dhe burri paraqiten krah për krah, duke ecur së bashku drejt përsosjes dhe së ardhmes.

Kur'ani i përmend të dy në mënyrë të barabartë dhe kështu shkatërron mentalitetin e epokës së injorancës (*xhahilijes*), i cili i jepte përparësi absolute burrit. Ky mentalitet jo vetëm që mbështetej nga burrat, por shpesh pranohej edhe nga vetë gratë. Islami erdhi dhe e rrëzoi këtë mendësi përmes këtyre ajeteve. Po ashtu, edhe në çështjet shoqërore dhe politike, Islami e konsideroi të domosdoshëm dhe praktik pjesëmarrjen e grave, duke vendosur edhe bejatin (besëlidhjen) e grave si një element të rëndësishëm të jetës shoqërore.

Shikoni gjendjen shoqërore në botën perëndimore dhe në ato vende evropiane që pretendojnë se mbrojnë të drejtat e grave, pretendime që, sipas këtij këndvështrimi, janë në masë të madhe të pavërteta. Deri në dekadat e para të shekullit të kaluar, gratë në shumë prej këtyre vendeve nuk gëzonin të drejtën e votës, të zgjedhjes, të shprehjes së mendimit dhe as të drejtën e pronësisë së pavarur. Madje, gruaja nuk kishte të drejtë të zotëronte pasurinë e saj personale, por burri konsiderohej pronari i gjithçkaje që lidhej me të. Ndërkohë, në Islam, çështje të tilla si bejati (besëlidhja), pronësia dhe pjesëmarrja e gruas në çështje të rëndësishme shoqërore dhe politike janë përcaktuar qartë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِذَا جَاءَكَ الْمُؤْمِنَاتُ يُبَايِعْنَكَ عَلَى أَن لَّا يُشْرِكْنَ بِاللَّهِ﴾

"Kur të vijnë te ti gratë besimtare për të të dhënë besën se nuk do t'i shoqërojnë Allahut asgjë…"[1]

Gratë vinin te Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe i jepnin besën e tyre. I Dërguari i Allahut nuk e kundërshtoi këtë dhe nuk tha se vetëm burrat kanë të drejtë të japin besën, ndërsa gratë duhet thjesht të ndjekin rrugën që zgjedhin burrat, duke pranuar ose refuzuar atë që ata pranojnë apo refuzojnë. Jo, përkundrazi, ai pranoi që edhe gratë të merrnin pjesë në këtë proces. Kjo do të thotë se ato kishin rol në pranimin e qeverisjes dhe të rendit shoqëror e politik. Nga kjo kuptohet se, në shumë prej këtyre çështjeve, Perëndimi arriti te disa të drejta të grave shumë shekuj pas Islamit. Megjithatë, pavarësisht kësaj historie, vazhdon të paraqitet si pionier absolut në këtë fushë. Edhe në çështjet e pronësisë dhe në fusha të tjera shoqërore e politike që lidhen me gruan, realiteti historik dëshmon se Islami i ka njohur këto të drejta shumë më herët.[2]

[1] Sure "El-Mumtehine", ajeti 12.

[2] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm në takimin e tij me një numër të madh motrash; 30/6/1379 sipas kalendarit iranian, 20/9/2000.

Nëse besimi në Allahun nuk do të ekzistonte mes njerëzve, çështjet nuk do të rregulloheshin

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë:

﴿إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا * لِتُؤْمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَتُعَزِّرُوهُ وَتُوَقِّرُوهُ وَتُسَبِّحُوهُ بُكْرَةً وَأَصِيلًا﴾

"Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, përgëzues dhe paralajmërues, që ju të besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, ta përkrahni dhe ta nderoni atë, dhe ta madhëroni Atë (Allahun) **mëngjes e mbrëmje."**[1]

Kuptimi i këtij ajeti është se, nëse besimi në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk do të ekzistonte mes njerëzve, çështjet nuk do të ecnin në rrugën e tyre të natyrshme dhe të drejtë.

Duhet ta mbani parasysh këtë pikë dhe të mendoni me kujdes për ata që përpiqen të depërtojnë dhe të ndikojnë në besimin e shoqërisë, gjë të cilën vazhdimisht përpiqen ta bëjnë, në mënyrë që të kuptoni qëllimet dhe synimet e tyre. Duhet ta dini se shtylla më e fortë e lumturisë dhe e krenarisë së këtij populli është besimi.

Prandaj themi se çdo individ dhe çdo thirrës që përpiqet t'i dobësojë themelet e këtij besimi, në çfarëdo forme dhe me çfarëdo metode qoftë, qoftë përmes mbjelljes së dyshimeve, përsëritjes së paqartësive dhe vesveseve të shejtanit, apo duke e çuar shoqërinë drejt mungesës së përkushtimit, pakujdesisë dhe shtyrjes së

[1] Sure "El-Fet'h", ajetet 8–9.

detyrimeve, në të vërtetë është duke ndjekur atë rrugë të ulët dhe të devijuar të shejtanit. Pra, ai po përballet dhe po lufton kundër krenarisë kombëtare, vlerave të larta të një populli dhe lumturisë së shoqërisë.[1]

Humanizmi i njeriut nga këndvështrimi i Islamit

Humanizmi i njeriut në Islam nuk është e njëjtë me humanizmin evropian (Humanism), por ndryshon rrënjësisht prej tij. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿أَلَمْ تَرَوْا أَنَّ اللَّهَ سَخَّرَ لَكُم مَّا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ﴾

"A nuk e shihni se Allahu ka vënë në shërbimin tuaj gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë?"[2]

Ai që e studion me vëmendje Kur'anin e Shenjtë, Nahxhul-Belagën dhe librat e tjerë fetarë, arrin në përfundimin se Islami e sheh krijimin e gjithësisë të lidhur me pozitën dhe rolin e njeriut. Kjo është ajo që nënkuptohet me qendërsinë e njeriut në Islam. Ka shumë ajete që tregojnë se dielli, hëna, detet dhe elementë të tjerë të universit janë vënë në shërbim të njeriut. Madje Kur'ani thekson në mënyrë të përgjithshme:

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm në takimin e tij me një numër të madh komandantësh të Gardës, sakrifikuesish, nxënësish dhe studentësh, me rastin e Ditës së Gardës, Ditës së Sakrifikuesit dhe Ditës së Studentit; 11/8/1379 sipas kalendarit iranian, 1/11/2000.

[2] Sure "Lukman", ajeti 20.

﴿سَخَّرَ لَكُم مَّا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ﴾

"Ka vënë në shërbimin tuaj gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë." Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se të gjitha krijesat dhe forcat e universit janë krijuar me potencialin që, në fund, të mund të përdoren dhe të shfrytëzohen nga njeriu. Edhe pse në shumë raste njeriu ende nuk ka arritur t'i zotërojë plotësisht ato, realiteti i fshehur në natyrën e njeriut dhe të universit është se ato janë krijuar në mënyrë që një ditë të jenë në shërbim të tij.

Çfarë do të thotë "të jenë të nënshtruara për ju"? Do të thotë se ato mund të vihen nën kontrollin dhe përdorimin e njeriut, në mënyrë që ai të përfitojë prej tyre sa më mirë. Kjo tregon se njeriu gëzon një pozitë shumë të lartë dhe është tepër i nderuar në sistemin e krijimit hyjnor, sepse është një qenie e aftë të njohë, të përdorë dhe të vërë në shërbim të vetes tokën, qiellin, yjet, diellin dhe hënën.

Ky nderim dhe kjo pozitë e veçantë e njeriut përmendet qartë në Kur'an:

﴿وَلَقَدْ كَرَّمْنَا بَنِي آدَمَ﴾

"Ne, me të vërtetë, i kemi nderuar bijtë e Ademit."[1] Ky nderim është njëkohësisht krijues (*tekvinij*) dhe ligjor (*teshri'*ij). Ai mbështetet mbi parimet njerëzore dhe morale që Islami dhe sistemi islam synojnë t'i realizojnë në jetën e njeriut.[2]

[1] Sure "El-Isra", ajeti 70.

[2] Po aty (fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm, i përmendur më sipër).

Çfarë do të thotë "sëmundja e zemrave"?

Muxhahidinët besimtarë u kthyen nga një luftë e ashpër dhe nga vështirësi të mëdha. Atëherë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u tha: "Ju u kthyet nga xhihadi i vogël, ndërsa tani duhet të përkushtoheni në xhihadin e madh." Besimtarët u habitën shumë dhe thanë: 'O i Dërguari i Allahut! Ne zhvilluam këtë luftë të madhe dhe të vështirë. A ka ndonjë xhihad më të madh se ky?' Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: "Po, xhihadi me veten tuaj." Prandaj, kur shihni se Kur'ani thotë:

﴿الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٌ﴾

"Ata, në zemrat e të cilëve ka sëmundje…", dijeni se këta nuk janë domosdoshmërisht hipokritë (munafikë). Natyrisht, disa prej hipokritëve përfshihen në këtë ajet, por nuk mund të themi se të gjithë ata që përmenden si "ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre" janë hipokritë. Madje, ndonjëherë mund të jenë edhe besimtarë në zemrat e të cilëve ekziston një lloj sëmundjeje.

Çfarë është kjo sëmundje? Ajo është prania e disa mangësive morale, dobësive personale, prirjeve epshore dhe dëshirave egoiste. Nëse njeriu nuk përballet me to dhe nuk lufton kundër tyre, ato mund t'ia marrin besimin, ndërkohë që pamja e tij e jashtme mund të vazhdojë të duket e mbushur me shenja besimi.

Pikërisht për këtë arsye një person i tillë mund të quhet hipokrit. Nëse, (Allahu na ruajtë!), zemra jonë zbrazet nga besimi,

ndërsa pamja jonë e jashtme vazhdon të duket fetare, atëherë ne kemi humbur lidhjen e vërtetë të besimit dhe dëshirat shpirtërore, por gjuha jonë ende vazhdon të flasë për besimin.

Ky është *nifaku* (hipokrizia), dhe ai përbën një rrezik të madh për njeriun dhe shoqërinë. Prandaj Kur'ani thotë:

﴿ثُمَّ كَانَ عَاقِبَةَ الَّذِينَ أَسَاؤُوا السُّوأَى أَن كَذَّبُوا بِآيَاتِ اللَّهِ﴾

"Pastaj përfundimi i atyre që bënë të këqija ishte më i keqi: ata i përgënjeshtruan ajetet e Allahut."[1]

Cila është kjo e keqe më e madhe? Ajo është përgënjeshtrimi i shenjave dhe ajeteve të Allahut. Në një vend tjetër, Kur'ani thotë:

﴿فَأَعْقَبَهُمْ نِفَاقًا فِي قُلُوبِهِمْ إِلَى يَوْمِ يَلْقَوْنَهُ بِمَا أَخْلَفُواْ اللّهَ مَا وَعَدُوهُ﴾

"Dhe si pasojë, Ai vendosi në zemrat e tyre hipokrizi deri në ditën kur do ta takojnë Atë, për shkak se e thyen premtimin që ia kishin dhënë Allahut."[2]

Pse ndodhi kjo? Ata e shkelën premtimin e tyre ndaj Allahut dhe nuk e përmbushën përgjegjësinë e madhe që kishin, dhënien e pasurisë në rrugën e Allahut. Për këtë arsye hipokrizia hyri në zemrat e tyre. Ky është rreziku i madh për shoqëritë islame. Sa herë që në historinë e Islamit shohim devijim dhe largim nga rruga e drejtë, ai ka ardhur pikërisht nga kjo pikë.

[1] Sure "Err-Rrum", ajeti 10.

[2] Sure "Et-Teube", ajeti 77.

Armiku i jashtëm mund t'i sulmojë besimtarët, t'i mposhtë, t'i shpërndajë dhe t'u shkaktojë humbje, por ai nuk mund t'i zhdukë plotësisht, sepse besimi do të mbetet dhe besimtari do të ringrihet përsëri me jetë, gjallëri dhe zhvillim në një vend tjetër. Por, kur njeriu sulmohet nga "ushtria e brendshme", e cila ia zbraz shpirtin nga vlerat dhe ndërgjegjen nga besimi, atëherë ndodh devijimi nga rruga. Kudo që ekziston devijimi, ai buron pikërisht nga kjo pikë. Prandaj edhe Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) luftoi kundër këtij armiku të rrezikshëm të brendshëm.[1]

Rëndësia e vlerave dhe e çështjeve shpirtërore në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe atdhetar

Puna për vendosjen e sundimit të vlerave dhe çështjeve shpirtërore, si dhe pengimi i shfaqjeve të shkatërrimit, përhapjes së prishjes morale dhe mohimit të fesë, veçanërisht kur këto paraqiten me krenari dhe mburrje, është një çështje e domosdoshme dhe e nevojshme. Allahu i Madhëruar thotë në Librin e Tij të Shenjtë:

﴿وَإِذَا أَرَدْنَا أَن نُّهْلِكَ قَرْيَةً أَمَرْنَا مُتْرَفِيهَا فَفَسَقُواْ فِيهَا﴾

"Kur Ne dëshirojmë të shkatërrojmë një vendbanim, i urdhërojmë të pasurit dhe të privilegjuarit e tij, por ata bëjnë shthurje në të…"[2] Domethënë, nëse një shoqëri do të shkojë drejt shkatërrimit, sipas ligjeve dhe rregullave hyjnore, një nga rrugët që

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik në namazin e xhumasë në Teheran; 28/2/1380 sipas kalendarit iranian, 17/5/2001.

[2] Sure "El-Isra", ajeti 16.

çon në këtë është krijimi i kushteve ku shtresa e pasur dhe e privilegjuar zhytet në gjynahe dhe shkatërrim:

﴿فَحَقَّ عَلَيْهَا الْقَوْلُ فَدَمَّرْنَاهَا تَدْمِيرًا﴾

"Atëherë përmbushet fjala ndaj saj dhe Ne e shkatërrojmë atë plotësisht."[1]

Pra, dënimi i Allahut vjen pas shthurjes dhe prishjes së tyre. Ky është një ligj i pandryshueshëm dhe zbatohet për të gjitha shoqëritë.

Megjithatë, çështja varet nga shkalla e ekzistencës së faktorëve mbrojtës në atë shoqëri. Disa shoqëri mbartin brenda tyre faktorët e shkatërrimit, dobësimit dhe zhdukjes, por në të njëjtën kohë kanë edhe faktorë mbrojtës që i ruajnë nga rënia dhe zhdukja, si: dija e gjerë, pasuritë e mëdha, politikanët me përvojë dhe pozita e përshtatshme gjeografike ose historike.

Për këtë arsye, në këto shoqëri mund të ndodhë një proces i ngadaltë i rënies dhe dobësimit. Nëse sot e shikoni me kujdes shoqërinë amerikane, do të shihni, sipas këtij këndvështrimi, se ajo po përballet me një drejtim drejt dobësimit dhe rënies, për shkak të shthurjes morale dhe shumë faktorëve të tjerë.

Nga ana tjetër, ekzistojnë disa shoqëri që u mungojnë faktorët mbrojtës; domethënë nuk kanë dije, pasuri apo politikë të mençur, ndërsa në të njëjtën kohë mbartin faktorët shkatërrues që në fund çojnë në rënien dhe dobësimin e tyre. Kur këto shoqëri të

[1] Sure "El-Isra", ajeti 16.

pafata bien në këtë moçal, zhdukja e tyre ndodh më shpejt. Natyrisht, kjo zhdukje nuk do të thotë domosdoshmërisht vdekjen e miliona njerëzve në mënyrë të menjëhershme; por do të thotë se një popull humbet identitetin e tij kombëtar dhe atdhetar. Ai ecën drejt zhdukjes së pozitës së tij, duke u bërë i dobët, i nënshtruar dhe i varur ndaj këtij apo atij tjetri, në mënyrë që askush në botë të mos e marrë më seriozisht. Atëherë ai përballet me shumë fatkeqësi dhe vuajtje. Nga këtu kuptojmë se çështjet shpirtërore dhe morale kanë një rëndësi shumë të madhe në jetën e njeriut.[1]

Duhet të kthehemi te Kur'ani i Shenjtë dhe të punojmë sipas tij

Është detyrë e myslimanëve në botë që të kthehen gjithnjë e më shumë te Kur'ani i Shenjtë, veçanërisht në një kohë kur armiqësitë dhe armiqtë shtohen nga çdo anë, sepse Kur'ani është ai që na shëron nga të gjitha sëmundjet. Nëse në botën islame ekzistojnë mangësi që tregojnë dobësi, nënshtrim dhe prapambetje, kjo është si rezultat i largimit dhe shkëputjes sonë nga Kur'ani i Shenjtë. Prandaj ne, si në Iran ashtu edhe në të gjitha vendet islame, duhet të afrohemi gjithnjë e më shumë me Kur'anin.

Urdhërimi i parë i Kur'anit është tevhidi (Njësimi i Allahut), kthimi tek Allahu i Madhëruar dhe thyerja e idhujve të pasurisë dhe fuqisë, të cilët shfaqen në forma të ndryshme. Pastaj urdhërimi

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik në takimin e tij me Presidentin e Republikës dhe Këshillin e Ministrave; 5/6/1380 sipas kalendarit iranian, 26/8/2001.

i dytë që Kur'ani ua jep të gjithë myslimanëve është uniteti dhe solidariteti.

Nëse ne nuk i kushtojmë rëndësi ndalimit dhe paralajmërimit të Kur'anit që thotë: **"Dhe mos u përçani"**, por përkundrazi e zgjerojmë ndarjen dhe përçarjen mes nesh, me justifikime të ndryshme dhe arsye të sajuara, dhe përqendrohemi në copëtimin e trupit të ymetit islam, atëherë këto veprime do të sjellin atë që shohim sot mes nesh. Armiku sulmon një pjesë të çmuar të trupit islam, ndërsa pjesët e tjera nuk kujdesen për të, sikur të jenë të zhytura në një ëndërr të bukur! Kjo është përçarja, kjo është ndarja dhe copëtimi. Prandaj duhet të kthehemi te Kur'ani i Shenjtë.

Sigurisht, kthimi te Kur'ani nuk kufizohet vetëm në leximin, recitimin dhe memorizimin e tij; këto duhet të jenë vetëm një hyrje dhe një përgatitje për ta kuptuar Kur'anin dhe për të vepruar sipas tij. Këto lexime të bukura dhe të mrekullueshme të Kur'anit që ju i paraqisni, janë padyshim tërheqëse dhe me vlerë. Ato zgjojnë dëshirën dhe dashurinë për Kur'anin dhe i drejtojnë të rinjtë drejt tij. Për këtë arsye ne i mbështesim programe dhe konkurse të tilla kur'anore dhe përpiqemi që këto tubime dhe mexhlise të Kur'anit të zhvillohen seriozisht, me entuziazëm dhe me gjallëri. E lusim Allahun e Madhëruar që të përmirësojë gjendjen e ymetit islam, të na bëjë prej atyre që kapen fort pas Kur'anit të Shenjtë, t'i ndriçojë zemrat tona me dritën e Kur'anit dhe të mos na ndajë, me lejen e

Tij, nga Kur'ani, as në jetën tonë e as në vdekjen tonë, as në këtë botë e as në Botën Tjetër![1]

Nën hijen e një ajeti nga ajetet e sures së bekuar "Ali Imran"

Zgjodha për ju një ajet nga surja e bekuar "Ali Imran", që ta studiojmë së bashku me ju, të nderuar, dhe të ecim pak nën hijen e këtij ajeti fisnik. Ajeti është:

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

﴿رَبَّنَا إِنَّنَا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ آمِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا ۖ رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَفَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ﴾

"Zoti ynë! Ne dëgjuam një thirrës që thërriste për besim: 'Besoni në Zotin tuaj!' dhe ne besuam. Zoti ynë, na i fal gjynahet tona, na i shlyej veprat tona të këqija dhe na merr shpirtin së bashku me të mirët."[2]

Ndoshta të nderuarit e pranishëm në këtë mexhlis janë pikërisht prej shembujve të këtij ajeti fisnik. Përmbajtja e këtij ajeti është fjala e një grupi njerëzish me mendje të shëndoshë, njerëzve të urtësisë dhe të arsyes. Këta janë ata që i drejtohen Allahut të Madhëruar dhe thonë: **"O Zoti dhe Krijuesi ynë! Ne e kemi**

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm në ceremoninë përmbyllëse të edicionit të tetëmbëdhjetë të Garave të Kur'anit të Shenjtë; 26/7/1380 sipas kalendarit iranian, 17/10/2001.

[2] Sure "Ali Imran", ajeti 193.

dëgjuar zërin e atij thirrësi që na ftoi në besim dhe ne iu përgjigjëm atij dhe besuam."

Nga ky ajet mund të kuptojmë se besimi nuk është vetëm një besim i zemrës, por është besim me zemër, me gjuhë, me gjymtyrë dhe me vepra. Natyrisht, ky lloj besimi ka shkallë dhe nivele; ai mund të bëhet i plotë ose edhe më i përsosur, por mund të jetë edhe i mangët dhe i dëmtuar në një farë mase. Kjo varet nga fakti nëse ne e kemi pranuar çështjen vetëm në aspektin teorik, apo nëse kemi filluar realisht të ecim në rrugën e besimit.

Cilat janë kërkesat dhe lutjet e këtij grupi pasi paraqitën gjendjen e tyre para Allahut? Ata thonë:

﴿رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا﴾

"O Zoti ynë, na i fal gjynahet tona."

Pra, në fillim duhet të përfshihemi nga falja e Allahut të Madhëruar. Nuk duhet të themi: "Për cilin mëkat po kërkojmë falje nga Allahu?" Sepse ne jemi të zhytur në gabime dhe gjynahe.

Kur Allahu i Madhëruar thotë për Profetin e Tij:

﴿لِيَغْفِرَ لَكَ اللَّهُ مَا تَقَدَّمَ مِن ذَنبِكَ وَمَا تَأَخَّرَ﴾

"Që Allahu të të falë ty atë që ka kaluar nga mëkati yt dhe atë që do të vijë."[1], dhe, kur Kur'ani i Shenjtë, si dhe lutjet e transmetuara

[1] Sure "El-Fet'h", ajeti 2.

në "Sahife Es-Sexhadije"[1] dhe në librat e tjera të besueshme, theksojnë kërkimin e faljes dhe istigfarin për Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe robtë e zgjedhur të Allahut, atëherë ne jemi edhe më shumë të përfshirë në nevojën për të kërkuar falje për shkak të gjynaheve tona.

Prandaj, në fillim duhet të jetë pendimi dhe kërkimi i faljes:

﴿رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا﴾

"O Zoti ynë, na i fal gjynahet tona dhe na i shlyej të këqijat tona."

Kjo shlyerje (*tekfijr*) do të thotë korrigjim dhe riparim i gabimeve dhe gjynaheve, sepse disa gabime dhe gjynahe mund të kenë dalë prej nesh gjatë ecjes sonë në rrugën e jetës.

Pastaj vjen faza e dytë:

﴿وَتَوَفَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ﴾

"Dhe na merr shpirtin së bashku me të mirët."

Domethënë: bëje vdekjen tonë dhe kalimin tonë nga kjo botë drejt botës së lartë (mbretërisë hyjnore) së bashku me njerëzit e mirë. Na bëj të vdesim ashtu siç vdesin ata, në të njëjtën rrugë dhe në të njëjtin drejtim. Përfundimi dhe rezultati i fundit janë prej çështjeve më të rëndësishme në jetën e njeriut.

[1] "Es-Sahife" përmban një përmbledhje lutjesh, udhëzimesh morale dhe porosish me vlerë të Imam Ali ibn Hysejnit, Es-Sexhxhadit.

Një prej mirësive dhe suksesëve më të mëdha që mund të arrijë një individ apo një shoqëri është që ta shfaqë këtë besim në vepra, sjellje dhe jetë në mënyrë të sinqertë dhe të qartë, pastaj t'ia paraqesë këtë kërkesë Allahut të Madhëruar. Kjo duhet të bëhet me sinqeritet të plotë dhe me qëllim të vërtetë.

Pastaj ne ngremë duart dhe themi:

﴿رَّبَّنَا إِنَّنَا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ آمِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا﴾

"O Zoti ynë! Ne dëgjuam një thirrës që thërriste për besim: 'Besoni në Zotin tuaj!' dhe ne besuam." Me lejen e Allahut, kjo përfshin edhe të pranishmit në këtë mexhlis.

Në të kaluarën, rruga jonë nuk ishte drejt besimit. Po, ne ishim besimtarë në zemrat tona dhe këtë besim e zbatonim në kufijtë e jetës sonë personale dhe në sjelljet tona individuale, por drejtimi i jetës sonë, në aspekte të ndryshme të saj, nuk ishte një drejtim i plotë dhe i saktë i besimit; përkundrazi, ishte një drejtim i ndikuar nga mosbesimi, padituria, tirania dhe prirjet e sistemeve tirane.

Zakonisht kështu janë sistemet laike, jofetare dhe të larguara nga besimi. Në mes të këtyre sistemeve pa fe dhe pa besim, nëse njeriu arrin t'i ruajë detyrimet e tij individuale dhe veprat fetare në mënyrë personale, atëherë ai do të jetë prej njerëzve me fat. Por këto detyra dhe detyrime fetare, në kushte të tilla, nuk ndikojnë ashtu siç duhet në ngritjen e personalitetit. Domethënë ato nuk sjellin gradat e larta të përsosurisë dhe të dritës shpirtërore që janë të nevojshme. Përkundrazi, pjesa më e madhe e ndikimit të tyre shpërndahet dhe humbet, dhe kjo është diçka e natyrshme, sepse

atmosfera mbizotëruese dhe mjedisi rrethues i njeriut bien ndesh me atë që përmban mendja dhe besimi i tij.

Ajo që mbetet prej dobisë së saj është e vogël dhe e kufizuar. Kjo është gjëja më e madhe që njeriu mund të arrijë në hijen e sistemeve ku feja nuk udhëheq dhe ku drejtimi i çështjeve nuk është në duart e fesë hyjnore dhe ligjit fetar. Nëse fusha e jetës do të ishte nën drejtimin e fesë, atëherë të gjitha aftësitë dhe energjitë e njeriut do të mund të drejtoheshin drejt përsosurisë dhe ngritjes, sepse atmosfera do të ishte e përshtatshme dhe e përgatitur për këtë lëvizje në rritje.

Sigurisht, unë nuk them se kjo ngritje shpirtërore do të ndodhë patjetër për çdo individ. Nëse ne neglizhojmë detyrat tona, shpërdorojmë përgjegjësitë tona, kënaqemi me pak dhe të dobëtën, dhe pengesat na ndalojnë nga përparimi përpara, atëherë në një gjendje të tillë nuk do të arrijmë as ato rezultate të pakta pozitive. Sepse kjo rrugë kërkon qëndrueshmëri, rezistencë dhe vendosmëri.[1]

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm në takimin e tij me burrat e qeverisë dhe përgjegjësit e sistemit të Republikës Islamike; 21/9/1380 sipas kalendarit iranian, 11/12/2001.

Një vështrim mbi konceptet e qëndrueshmërisë (istikamet), harresës, devijimit dhe përkujtimit në Kur'anin e Shenjtë

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا تَتَنَزَّلُ عَلَيْهِمُ الْمَلَائِكَةُ أَلَّا تَخَافُوا وَلَا تَحْزَنُوا﴾

"Me të vërtetë, ata që thanë: 'Zoti ynë është Allahu', e pastaj qëndruan të palëkundur, tek ata zbresin melekët (duke u thënë)**: 'Mos kini frikë dhe mos u pikëlloni!'"**[1]

Domethënë, melekët zbresin tek ata në këtë jetë të kësaj bote dhe, gjatë jetës së tyre të zakonshme, ata lidhen me Botën Tjetër. Ata arrijnë një thesar të pashtershëm në aspektin shpirtëror, mendor dhe psikologjik. Mbi ta nuk do të rëndojë asnjë lloj frike, tmerri apo pikëllimi. Sigurisht, mund të ekzistojnë disa shqetësime dhe kujdesje, por ato lidhen vetëm me rreziqet që e kërcënojnë njeriun në këtë rrugë.

Kur frika largohet nga ndërgjegjja e njeriut, ai e përshkon këtë rrugë me më shumë guxim, me vendosmëri më të madhe dhe me moral më të lartë, duke iu afruar pak nga pak qëllimit të synuar.

Gjithashtu, njeriu nuk përfshihet nga dëshpërimi dhe pikëllimi, sepse në këtë rrugë ai nuk humbet asgjë. Së pari, ai do të ketë sukses dhe do të arrijë begatinë në këtë rrugëtim. Së dyti, edhe nëse njeriu humbet diçka për hir të kryerjes së detyrës dhe zbatimit të përgjegjësive hyjnore, ndërgjegjja e tij do të jetë e qetë. Ashtu si familjet e dëshmorëve që i kanë ofruar fëmijët e tyre kurban për hir të Allahut të Madhëruar dhe janë pikëlluar për humbjen e tyre, por

[1] Sure "Fussilet", ajeti 30.

në të njëjtën kohë zemrat e tyre janë të mbushura me gëzim dhe kënaqësi shpirtërore. Këta njerëz dallojnë krejtësisht dhe janë shumë të ndryshëm nga ata që përjetojnë të njëjtën humbje në rrethana të tjera, jo në rrugën e dëshmisë dhe sakrificës.

Një koncept tjetër që gjendet në Kur'anin e Shenjtë është "harresa" (*nisjan*), e cila është përmendur në forma të ndryshme. Lloji më i rëndë i harresës është harresa e vetvetes. Allahu thotë:

﴿وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ نَسُوا اللَّهَ فَأَنسَاهُمْ أَنفُسَهُمْ﴾

"Dhe mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harrojnë vetveten."[1]

Këtu duhet të kujtojmë se harresa e vetes në terminologjinë e letërsisë politike nënkupton humbjen e identitetit, dhe kjo është një gjë shumë e keqe. Do të thotë që një popull të harrojë identitetin, historinë, kulturën dhe gjuhën e tij. Si rezultat, ky popull përfundimisht do të përballet me poshtërim, mjerim dhe fatkeqësi. Por në literaturën morale, kuptimi i këtij koncepti është krejtësisht ndryshe nga kuptimi politik. Përqendrimi mbi harresën e vetvetes në aspektin moral është edhe më i thellë dhe më i rrezikshëm sesa në aspektin politik.

Kuptimi i saj është që njeriu të jetë i pavetëditur për identitetin e tij të vërtetë, qëllimin e ekzistencës së tij, brendësinë, zemrën dhe shpirtin e tij. Ai goditet nga harresa dhe pastaj dorëzohet para një rryme materiale dhe të prishur, e cila e çon atje ku dëshiron, derisa në fund e hedh në një moçal të ndyrë, ku ai nuk

[1] Sure "El-Hashr", ajeti 19.

ka më fuqi të kundërshtojë apo të përballet me asnjë lëvizje negative, të ulët, të prishur dhe të keqe.

﴿فَأَنسَاهُمْ أَنفُسَهُمْ﴾

"Dhe Ai i bëri të harrojnë vetveten."

Domethënë, njeriu bëhet i pakujdesshëm ndaj të gjitha vlerave dhe kritereve, dhe nuk e di më përse ka ardhur në këtë botë. Prandaj ai e kalon jetën e tij si një fëmijë i vogël, i cili nuk mendon për fatin e tij përfundimtar, por kujdeset vetëm për çastin që po jeton. Pas gjithë kësaj, jeta do të përfundojë pas gjashtëdhjetë apo shtatëdhjetë vitesh dhe nuk ka shpëtim nga përballja me vdekjen.

Pyetja që shtrohet këtu është: Çfarë do të ndodhë pas kësaj jete? Cili është qëllimi i kësaj jete? Cila është arsyeja e kësaj ardhjeje dhe ikjeje dhe e qëndrimit tonë këtu?

Mosmendimi për këtë çështje dhe shmangia e reflektimit mbi të është një rrezik shumë i madh. Allahu thotë: **"Pikërisht ata janë të pabindurit** (fasikët)."

Domethënë, ata janë fasikë. Ky është kuptimi i fjalës fisk, pra, dalja nga diçka për shkak të prishjes dhe kalbjes së saj. Për këtë arsye, kur lëkura ndahet nga hurma e prishur, në gjuhën arabe thuhet: "fesekat et-temra", hurma doli nga gjendja e saj. Prej kësaj fjale dhe këtij kuptimi vjen edhe termi fiskun. Pra, aroma dhe kënaqësia shpirtërore që njeriu përjeton si rezultat i besimit, ndahen nga ekzistenca e tij për shkak të procesit të fiskut. Prandaj themi se një prej sëmundjeve të qëndrueshmërisë në rrugën e drejtë (istikametu) është harresa.

Një tjetër term që gjendet në Kur'anin e Shenjtë dhe që ndonjëherë më prek shumë është fjala "devijimi i zemrës" (*ez-zejg*).

Allahu thotë:

﴿رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِن لَّدُنكَ رَحْمَةً إِنَّكَ أَنتَ الْوَهَّابُ﴾

"O Zoti ynë! Mos i largo zemrat tona nga e vërteta pasi na udhëzove dhe na dhuro mëshirë nga ana Jote. Me të vërtetë, Ti je Dhuruesi i Madh."[1]

Domethënë: 'O Zoti ynë, mos i bëj zemrat tona të devijuara; mos i kthe dhe mos i shtrembëro zemrat tona, mos lejo që ato të largohen nga rruga e së vërtetës drejt rrugës së së pavërtetës.' Kjo është lutja e robve të Allahut, të cilën Kur'ani na e transmeton.

Gjithashtu Allahu thotë:

﴿وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِ يَا قَوْمِ لِمَ تُؤْذُونَنِي وَقَد تَّعْلَمُونَ أَنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ ۖ فَلَمَّا زَاغُوا أَزَاغَ اللَّهُ قُلُوبَهُمْ﴾

"Dhe kur Musai i tha popullit të tij: 'O populli im! Përse më lëndoni, kur e dini se unë jam i dërguari i Allahut tek ju?' E kur ata devijuan, Allahu ua devijoi zemrat."[2]

Nëse e analizojmë me kujdes këtë çështje, do të shohim se ekziston një ndërveprim mes dy anëve të kësaj çështjeje. Ekziston një veprim i përbashkët nga të dyja anët. Siç duket, fillimi është nga

[1] Sure "Ali Imran", ajeti 8.

[2] Sure "Es-Saff", ajeti 5.

vetë njeriu, ndërsa rezultatet dhe pasojat vijnë nga ana e Allahut të Madhëruar. Domethënë: **"Kur ata devijuan..."**, pra, kur ata u larguan dhe i bënë zemrat e tyre të gatshme për devijim dhe largim nga rruga e së vërtetës, atëherë erdhi reagimi: **"Allahu ua devijoi zemrat."** Pra, Ai i nxori nga rruga e drejtë. Por si e nxjerr Allahu njeriun nga rruga? Do të thotë se Ai ua heq atyre sukseset dhe ndihmën hyjnore (*teufikun*).

Sa i përket bijve të Izraelit, ky ajet lidhet me atë që u ndodhi atyre. Ata, kur panë Faraonin, e kuptuan drejtësinë e Musait (Paqja qoftë mbi të!). Ata e panë me sytë e tyre se si Allahu i Madhëruar kreu atë mrekulli të madhe përmes robit të Tij të zgjedhur, Musait, birit të Imranit (Paqja qoftë mbi të!). Ata panë detin e trazuar dhe të frikshëm, ushtrinë e Faraonit dhe ngjarjet e jashtëzakonshme. Por më pas iu dorëzuan dëshirave të tyre egoiste, neglizhencës dhe harresës për të cilën folëm më parë, dhe ranë në atë humnerë të thellë. Pra, ata devijuan (*zaguu*).

Në të njëjtin ajet shohim se Musai (Paqja qoftë mbi të!) u thotë: **"Përse më lëndoni?"**

Dhe Allahu thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ آذَوْا مُوسَىٰ فَبَرَّأَهُ اللَّهُ مِمَّا قَالُوا وَكَانَ عِندَ اللَّهِ وَجِيهًا﴾

"O ju që keni besuar! Mos u bëni si ata që e lënduan Musain, por Allahu e pastroi atë nga ajo që thanë dhe ai ishte i nderuar tek Allahu."[1]

[1] Sure "El-Ahzab", ajeti 69.

Edhe pse kjo fjalë u drejtohet bijve të Izraelit për shkak të dëmit dhe sjelljes së tyre të keqe ndaj profetit të tyre Musait (Paqja qoftë mbi të!), në të njëjtën kohë ajo është një mesazh edhe për ne.

Devijimi nga anan e tyre do të thotë: dorëzim ndaj dëshirave trupore, epsheve, prirjeve materiale dhe financiare dhe gjërave të ngjashme që e pengojnë ngritjen e tyre drejt përsosurisë. Devijimi nga ana e Allahut të Madhëruar do të thotë: Heqja e mëshirës dhe ndihmës hyjnore, e cila bën që njeriu të zhytet në gjynahe.

Çdo lëvizje e gabuar që bëjmë, çdo veprim i padrejtë dhe i pavlefshëm, çdo punë që buron nga dëshirat tona egoiste, na afron një hap më shumë drejt thellësive të moçalit të korrupsionit dhe na çon drejt gjendjes: **"Allahu ua devijoi zemrat."**

Këto gabime na sulmojnë njëri pas tjetrit dhe për këtë arsye janë shumë të rrezikshme. Pastaj rezultati që vjen nga këto gjynahe dhe rrëshqitje është se, para së gjithash, veprat e njeriut bëhen të mangëta. Më pas shfaqet çrregullim dhe paqartësi në moralin dhe sjelljen tonë, dhe personaliteti ynë mbetet i ndikuar nga këto sjellje të gabuara. Kështu shohim një njeri të sinqertë dhe besnik, me vullnet të lartë dhe ndjenjë përgjegjësie, që gradualisht shndërrohet në një person të lëkundur, i cili nuk i përmbahet premtimeve dhe nuk merr përsipër përgjegjësi.

Pas kësaj ndryshojnë edhe morali dhe cilësitë e tij, dhe pas kësaj faze vjen radha e bindjeve dhe besimeve, të cilat edhe ato fillojnë të ndryshojnë.

Kjo është prishja në vepra, të cilën dikur e përçmonim dhe e konsideronim të vogël, por ajo gradualisht e ndryshon identitetin

tonë dhe çon në prishjen e bindjeve dhe vlerave tona. Kur'ani i Shenjtë ka një ndërhyrje të bukur në këtë çështje:

﴿فَأَعْقَبَهُمْ نِفَاقًا فِي قُلُوبِهِمْ إِلَىٰ يَوْمِ يَلْقَوْنَهُ بِمَا أَخْلَفُوا اللَّهَ مَا وَعَدُوهُ﴾

"Si pasojë, Ai u vendosi hipokrizi në zemrat e tyre deri në ditën kur do ta takojnë Atë, për shkak se ata e shkelën premtimin që ia kishin dhënë Allahut."[1]

Pra, Allahu i sprovoi disa njerëz me hipokrizi, sepse ata nuk ishin besnikë ndaj besës dhe premtimit të tyre përpara Allahut të Madhëruar. Po, kjo është mënyra se si funksionon ligji i Allahut në marrëdhënien me njeriun; çështja në të vërtetë lidhet me mënyrën se si njeriu vepron dhe sillet. Ne, përmes veprave dhe sjelljeve tona, mund ta bëjmë veten të privuar nga mëshira dhe kujdesi hyjnor. Dhe kur humbasim këtë mëshirë, ecim gjithnjë e më shumë drejt prishjes dhe rënies shpirtërore.

Prandaj, në disa lutje është transmetuar kjo përmbajtje: "O Allah! Të kërkoj prej Teje shkaqet dhe veprat që sjellin mëshirën Tënde." Pra, njeriu i kërkon Allahut që t'i mundësojë atij ato shkaqe që e bëjnë të meritojë mëshirën hyjnore. Kur këto shkaqe mungojnë në veprat e njeriut, atëherë mëshira hyjnore largohet prej tij.

Dhe ky është një lloj tjetër i devijimit (زيغ), pra, largimi gradual i zemrës nga rruga e drejtë për shkak të veprave të gabuara,

[1] Sure "Et-Teube", ajeti 77.

derisa njeriu humbet dritën e udhëzimit dhe mbetet i ekspozuar ndaj dobësive dhe gjynaheve.[1]

Veprat më të rëndësishme të profetëve të mëdhenj (Paqja qoftë mbi ta!)

Gjatë gjithë historisë, njeriu ka shfaqur gjynahet e tij më të mëdha dhe gabimet më të rënda, si dhe mungesën e përkushtimit ndaj devotshmërisë dhe frikërespektit ndaj Allahut në fushën e pushtetit dhe qeverisjes. Këto gjynahe janë kryer nga sundimtarët, udhëheqësit dhe ata që kanë marrë në duart e tyre fatet e popujve; dhe ato nuk mund të maten apo të krahasohen me gjynahet dhe krimet e njerëzve të zakonshëm.

Pikërisht në këtë fushë, njeriu ka treguar shumë pak racionalitet, moral dhe urtësi. Në këtë drejtim, logjika nuk ka udhëhequr mendimet dhe veprimet e tij veçse në një masë shumë të vogël, krahasuar me fusha të tjera. Ata që kanë pësuar humbjen nga kjo pakujdesi, marrëzi, prishje morale dhe zhytje në mëkat e padrejtësi, kanë qenë të gjithë njerëzit. Ndonjëherë humbësit kanë qenë popujt ose shoqëri të ndryshme.

Këto qeverisje në fillim ishin diktatura individuale, por më vonë, me zhvillimin dhe ndryshimin e shoqërive njerëzore, u shndërruan në diktatura kolektive dhe të organizuara.

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik në Universitetin e Oficerëve "Imam Ali"; 3/9/1380 sipas kalendarit iranian, 23/11/2001.

Prandaj, një nga veprat më të rëndësishme të profetëve të mëdhenj (Paqja qoftë mbi ta!) ka qenë përballja dhe lufta kundër tagutëve (tiranëve) dhe atyre që shpërdoronin dhe tepronin me begatitë e Allahut të Madhëruar:

﴿وَإِذَا تَوَلَّى سَعَى فِي الأَرْضِ لِيُفْسِدَ فِيهَا وَيُهْلِكَ الْحَرْثَ وَالنَّسْلَ﴾

"Kur largohet (nga ti), **ai përpiqet të përhapë shkatërrim në tokë dhe të zhdukë të mbjellat dhe pasardhësit."**[1]

Në ajete të tilla kur'anore gjenden kuptime që e prekin thellë ndërgjegjen e njeriut përballë qeverive të korruptuara, sepse ato përpiqeshin ta përhapnin dhe ta shtrinin prishjen në çdo vend:

﴿أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ بَدَّلُواْ نِعْمَةَ اللهِ كُفْرًا وَأَحَلُّواْ قَوْمَهُمْ دَارَ الْبَوَارِ* جَهَنَّمَ يَصْلَوْنَهَا وَبِئْسَ الْقَرَارُ﴾

"A nuk i ke parë ata që e ndërruan begatinë e Allahut me mohim dhe e çuan popullin e tyre në vendin e shkatërrimit? Ata do të hyjnë në Xhehenem; sa vend i keq është ai!"[2]

Domethënë, këta njerëz i shndërruan begatitë hyjnore, njerëzore dhe natyrore në mohim dhe mosmirënjohje. Ata i dogjën njerëzit, të cilët duhej t'i gëzonin këto mirësi, me zjarrin shkatërrues që vetë e krijuan për shkak të mohimit dhe keqpërdorimit të begative.

[1] Sure "El-Bekare", ajeti 20.

[2] Sure "Ibrahim", ajetet 28–29.

Prandaj, profetët qëndruan përballë tyre dhe u kundërvunë atyre. Sikur profetët të mos i kishin kundërshtuar dhe përballur këta tiranë e tagutë të historisë, nuk do të kishte pasur nevojë për ato përplasje dhe konflikte të mëdha.

Prandaj Kur'ani Famëlartë përmend përballjen e ashpër mes dy palëve:

﴿وَكَأَيِّن مِّن نَّبِيٍّ قَاتَلَ مَعَهُ رِبِّيُّونَ كَثِيرٌ﴾

"Sa shumë profetë ka pasur me të cilët luftuan shumë njerëz të devotshëm!"[1]

Me kë ishte kjo luftë? Lufta e profetëve ishte kundër qeverive të korruptuara, pushteteve shkatërruese dhe tiranëve të historisë, të cilët i sollën njerëzimit mjerim dhe shkatërrim. Profetët janë ata që e kanë shpëtuar njerëzimin. Për këtë arsye, Kur'ani i Shenjtë e përmend qëllimin e madh dhe synimin më të lartë të profetëve dhe të dërguarve të Allahut, i cili është vendosja e drejtësisë:

﴿لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ﴾

"Ne i dërguam të dërguarit Tanë me argumente të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librin dhe peshoren (e drejtësisë), **që njerëzit të vendosin drejtësinë."**[2]

Zbritja e librave hyjnorë dhe dërgimi i të dërguarve të Allahut, të gjitha kanë për qëllim vendosjen e drejtësisë dhe

[1] Sure "Ali Imran" ajeti 146.

[2] Sure "El-Hadid", ajeti 25.

barazisë në shoqëritë njerëzore. Domethënë, heqjen e shenjave dhe simboleve të padrejtësisë, shtypjes, kontrollit tiranik dhe korrupsionit.

Lëvizja e imam Hysejn ibn Aliut (Paqja qoftë mbi të!) ishte pikërisht në këtë rrugë. Për këtë arsye ai ka thënë: "*Unë nuk dola për asgjë tjetër përveçse për të kërkuar reformimin e ymetit të gjyshit tim.*"[1]

Gjithashtu, Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë*:* "*Kush sheh një sundimtar tiran, i cili i konsideron të lejuara ato që Allahu i ka bërë haram, që e ka thyer besën e Allahut, që kundërshton sunetin e të Dërguarit të Allahut (Paaja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), dhe sillet ndaj robëve të Allahut me mëkat dhe armiqësi, pastaj nuk përpiqet ta ndryshojë atë me fjalë apo me vepër, Allahu e ka hak që ta vendosë atë në vendin ku do të vendosë atë tiran.*"[2]

Domethënë, ai që sheh qendrën e korrupsionit dhe burimin e padrejtësisë, pastaj nuk interesohet për çështjet, qëndron mënjanë dhe nuk hyn në skenë për të kundërshtuar, Allahu i Madhëruar do ta ringjallë atë bashkë me atë tiran dhe të padrejtë në të njëjtin fat dhe përfundim.

Imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "*Unë nuk dola për shkak të kokëfortësisë, rebelimit apo mendjemadhësisë.*" Përkundrazi, kishte një thirrje që i ishte dërguar Imamit, ku i kërkohej të shkonte në Irak dhe të merrte përsipër krijimin e një qeverie të drejtë atje.

Mbi këtë bazë, imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) shkoi tek ata duke iu përgjigjur thirrjes së tyre. Pra, nuk duhet ta kuptojmë

[1] "Biharul-Enuar", vëll. 44, f. 329.

[2] "Rixhal En-Nexhashi", f. 144.

sikur imam Hysejni (Paqja qoftë mbi të!) nuk kishte synim marrjen e pushtetit dhe drejtimin e qeverisë; përkundrazi, ai mendonte dhe planifikonte të shkatërronte forcat e tagutit dhe të padrejtësisë, edhe nëse kjo do të çonte në marrjen e qeverisjes ose në sakrifikimin e gjakut të tij të pastër dhe rënien dëshmor në rrugën e këtij qëllimi të lartë.[1]

Shembulli i së ardhmes së ndritur të popullit palestinez nga këndvështrimi i Kur'anit Famëlartë

Këta sionistë uzurpues dhe pushtues janë të prekur nga nxitimi, frika dhe paniku, dhe veprimet e fjalët e tyre e tregojnë këtë. Nëse këto fatkeqësi dhe ngjarje janë të hidhura dhe të dhimbshme për popullin palestinez, ato janë edhe më të hidhura dhe më të mundimshme për armiqtë e tyre.

Shikoni këtë ajet, sa qartë e shpreh këtë kuptim:

﴿إِن تَكُونُواْ تَأۡلَمُونَ فَإِنَّهُمۡ يَأۡلَمُونَ كَمَا تَأۡلَمُونَ وَتَرۡجُونَ مِنَ اللهِ مَا لاَ يَرۡجُونَ﴾

"Nëse ju vuani, edhe ata vuajnë ashtu siç vuani ju, por ju shpresoni nga Allahu atë që ata nuk shpresojnë."[2]

Domethënë, nëse ju përballeni me vështirësi dhe dhimbje në përballjen me armikun, edhe armiku vuan nga këto vështirësi,

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Madhërishëm të Revolucionit Islamik para tubimit të madh në oborrin e shenjtë të Imam Ali ibn Musa Err-Rridait (a.s.), me rastin e festës së Ghadirit; 12/12/1380 sipas kalendarit iranian, 2/3/2001.

[2] Sure "En-Nisa", 104.

madje edhe më shumë se ju. Dallimi është se përpara popullit palestinez ekzistojnë horizonte të ndritshme dhe shpresa për një të ardhme të mirë, ndërsa pushtuesit sionistë nuk gëzojnë horizonte të tilla të ndritshme dhe një të ardhme të qartë.

Populli palestinez ka një të ardhme të begatë dhe mundet, përmes përpjekjes, punës së palodhur dhe rezistencës, të arrijë tek ai qëllim i lartë dhe synimi më i përsosur.[1]

[1] Fjalimi i Udhëheqësit të Revolucionit Islamik para një tubimi të madh me dhjetëra mijëra luftëtarë dhe shtresa të ndryshme të popullit në kampin "Dokuhe"; 9/1/1381 sipas kalendarit iranian, 28/3/2002.

Përmbajtja

1 - Zyrtarët shtetërorë dhe institucionet e sistemit të Republikës Islamike 88

2 - Dijetarët e hauzave shkencore, klerikët dhe predikuesit ... 88

3 - Recituesit e Kur'anit dhe mësuesit në këtë fushë 93

4 – Studiuesit, shkrimtarët, predikuesit dhe mediat publike . 96

5 – Populli dhe rinia 97

Cilat janë këto mjete? 104

Marrëdhënia shpirtërore mes njerëzve është nga Allahu i Madhëruar 126

Imam Khomeini (Allahu e mëshiroftë!), mishërim i plotë i ajetit kur'anor 127

Shpërblimi i veprës në përpjekjen për dynjanë ose për Ahiretin 127

Surja "El-Ahzab" përshkrim i armiqësisë së njerëzve të ligj 128

Invalidët e luftës dhe ata që sakrifikuan jetën e tyre në Kur'anin e Shenjtë 130

Ruajtja e mirësisë dhe e begatisë është më e rëndësishme sesa fitimi i saj 131

Metodologjia e edukimit dhe e formimit në Kur'anin e Shenjtë 132

Çështja e "Ifk-ut" (Shpifjes së madhe) në Kur'anin e Shenjtë 133

Dinjiteti dhe krenaria i përkasin Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve 137

Koncepti i vilajetit dhe i teuhidit në shoqërinë islame 138

Parimi i urdhërimit për të mirë dhe i ndalimit nga e keqja në sistemin islamik 139

Sqarimi dhe përcaktimi i pozitës së gruas nga këndvështrimi i Kur'anit 141

Ndikimi i devotshmërisë (*tekvasë*) në zemrën dhe jetën e njeriut 144

Surja "En-Neml", një skenë që pasqyron njëkohësisht mendjemadhësinë dhe përulësinë 145

Buzëqeshja e Sulejmanit (Paqja qoftë mbi të!) ndaj fjalës së milingonës dhe falënderimi i tij ndaj Zotit për këtë mirësi .. 147

Mendjemadhësia dhe arroganca – ndër fatkeqësitë më të mëdha dhe më të rrezikshme 149

Edukimi dhe pastrimi i vetvetes – pika kyçe për reformimin e botës 150

Mishërimi i ajeteve të xhihadit në Revolucionin Islamik 151

Themelimi i shtetit dhe zbatimi i drejtësisë – qëllimi i synuar i feve hyjnore 152

E gjithë bota është skenë dhe prani para Allahut të Madhëruar 153

Përgatitja dhe vigjilenca në shkallën më të lartë të mundshme 155

Ndjenja e mospasjes nevojë për Allahun – vuajtja dhe tragjedia më e madhe e njerëzimit 156

Jeta do të thotë xhihad dhe lëvizje 158

Marrja e mësimit dhe reflektimi nga ngjarjet e betejës së Uhudit, në dritën e Kur'anit 159

Çfarë do të thotë falënderimi për mirësinë (begatinë)? 161

Debati i ithtarëve të së vërtetës me argumente të qarta ndaj prijësve të mohimit dhe ateizmit 161

Dijetarët e robëruar – të rëndomtit në tokë 164

Në fund, fitorja dhe triumfi i takojnë vlerave hyjnore 165

Vepra e mirë pas besimit në Allahun e Madhëruar 166

Xhihadi dhe sakrifica nuk mund të vazhdojnë pa devotshmërinë ndaj Allahut të Madhëruar 166

Pikëpamja e Kur'anit të Shenjtë ndaj historisë dhe rëndësia e saj 168

Pionierët e ndërtimit dhe të zhvillimit 170

Lëvizja kulturore që ndërmori Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) kundër hebrenjve 171

Hipokrizia është gjuha që flet për Islamin, por është edhe zemra e zbrazët prej tij 172

Marrja e mësimit dhe këshillimi nga ngjarjet dhe ndikimi i tyre në përmirësimin dhe lumturinë e popujve dhe të shoqërive 175

Mosbërja e kompromisit me armiqtë – një shtyllë e fortë e qeverisjes dhe e udhëheqjes islame 177

Duhet të meditojmë dhe të thellohemi gjithnjë e më shumë në shembujt e Kur'anit 179

Çfarë nënkupton Kur'ani me "kënaqësinë e jetës së kësaj bote"? 180

Çfarë do të thotë "*istikbar*" (arroganca sunduese) sipas këndvështrimit të Kur'anit? 183

Kur'ani e konsideron tekvanë të kundërtën e pakujdesisë (*gafletit*) 185

Lufta e profetëve kundër arrogantëve zë një vend të veçantë dhe shumë tërheqës në Kur'anin e Shenjtë 186

E vërteta e Gadijr Khumit dhe kuptimi i vilajetit (udhëheqjes) 188

Kuptimi i fjalës vilajet (الولاية) 190

Kuptimi i fjalës *vilajetu* (ولاية) dhe filozofia e saj në qeverisjen islame 191

E vërteta e falënderimit për mirësitë dhe njohja e begative . 194

Nuk ka drejtim të botës pa devotshmëri 197

Dorëzimi ndaj të padrejtit nuk është më pak i keq sesa kryerja e padrejtësisë dhe e shtypjes 198

Pikat e rëndësishme të misionit të shenjtë profetik 199

Qëllimi i përsëritjes së emrit të shejtanit dhe konceptit të shejtanizmit në Kur'an 202

Kush janë hipokritët (*munafikët*)? 202

Çlirimi nga detyrimet dhe aleancat e imponuara, kufizimet dhe traditat e gabuara shoqërore..... 204

Liria shoqërore në Kur'anin e Shenjtë është në shërbim të vlerave, moralit dhe përparimit të shoqërisë..... 205

Kufijtë dhe caqet e lirisë..... 206

Martirizimi është një dhuratë dhe mirësi nga Allahu 209

Kultura është identiteti kolektiv i një populli..... 209

Kur'ani jep zgjidhje për krizat familjare..... 211

Përkushtimi ndaj fesë sjell qetësi dhe siguri shpirtërore 212

Marikët dhe ata që ikin nga detyrimet fetare 213

Përmendja dhe karakteristikat e forcave të liga në Kur'an... 215

Devotshmëria- vigjilencë, vetëkontroll dhe mosdevijim nga rruga 216

Pasojat dhe frytet e takvasë në jetën e njeriut..... 217

Zemrat e vulosura dhe zemrat e mbyllura 219

Të vërtetat kur'anore..... 220

Mirësia dhe përmirësimi pas pendimit 222

Nëse besimi në Allahun nuk do të ekzistonte mes njerëzve, çështjet nuk do të rregulloheshin 227

Humanizmi i njeriut nga këndvështrimi i Islamit 228

Çfarë do të thotë "sëmundja e zemrave"?..... 230

Rëndësia e vlerave dhe e çështjeve shpirtërore në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe atdhetar 232

Duhet të kthehemi te Kur'ani i Shenjtë dhe të punojmë sipas tij..... 234

Nën hijen e një ajeti nga ajetet e sures së bekuar "Ali Imran" 236

Një vështrim mbi konceptet e qëndrueshmërisë (istikamet), harresës, devijimit dhe përkujtimit në Kur'anin e Shenjtë ... 241

Veprat më të rëndësishme të profetëve të mëdhenj (Paqja qoftë mbi ta!) 248

Shembulli i së ardhmes së ndritur të popullit palestinez nga këndvështrimi i Kur'anit Famëlartë 252

Përmbajtja 254

إسم الكتاب: **القرآن كتاب الحياة**

المؤلف: **الامام الشهيد السيد على الخامنئى (رضون الله عليه)**

المترجم: **إسراء مريا**

التصحيح الادبي: **ليسدا راماى**

التصحيح اللغوى: **الحاج الشيخ ولنت (عباس) مريا**

الإخراج النهائي: **صربيه فزا**

الغلاف: **صربيه فزا**

الناشر: **مؤسسة القرآن الكريم**

تيرانا– البانيا- 2026